7. Të përpiqen për rrjedhjen e vazhdueshëm të informatave të sakta.
8. Menaxherët duhet të vlerësojnë dhe të kuptojnë aftësinë dhe backgroundin e punonjësve dhe të mbajnë në mend gjuhën dhe nivelin e tyre të perceptimit në mënyrë që të zgjedhin mjetet e përshtatshme për të komunikuar më ta.

9. Ndërmarrjet e sektorit tregtar e në veçanti kompania “ETC” duhet të rrisë investimet në teknologjinë informatike.
10. Të mbahen mbledhje më të shpeshta dhe kontakte ballë për ballë.
11. Të inkurajohet një komunikim i hapur nga menaxherët e kompanisë “ETC”.

7. Literatura

1. Hayward Sh, (1996): Applying Psychology To Organizations, 1ed, Lawrence Erlbaum
2. Cleland J, (2003): Business Writing for Results, McGraw-Hill, USA
3. Schermerhorn Jr. J, Hunt J, Osborn R, 2002, Organizational Behaviour ed.7, John Wiley & Sons Inc. USA.
4. Koxhaj, A & Tomini, F. (2006): Menaxhimi i Komunikimit, UFO, Tiranë
5. Kondaklar. V, (2007): Organizational Behavior, New Age International (P) Limited, Publishers, New Delhi
6. Llaci, Sh (2006): Manaxhimi, Tiranë
7. Bratton J., and Gold J., (2000): Human Resource Management: Theory and Practice, 2nd ed, Lawrence Erlbaum Associates, Inc., Publishers, Mahwah, New Jersey
8. Thomas N, (2004): Handbook of Management and Leadership, Thorogood, London

=====

KUD 331.56 (497.7)

ANALIZË E POLITIKAVE TË TREGUT TË PUNËS DHE KARAKTERISTIKAVE TË PAPUNËSISË NË MAQEDONI

Mr.Sc.Artan Haziri

Abstrakt

Çështja e papunësisë është një problem jo vetëm i shteteve të pazhvilluara dhe atyre në tranzicion, por edhe i atyre me ekonomi shumë të zhvilluar. Në përgjithësi, papunësia shfaqet kur një person është në gjendje dhe ka vullnet të punoj por është i papunë. Rëndësia e një çështjeje të tillë është aq e madhe dhe me aq konsekuenca të mundshme sa që ka bërë që çdo individ apo grup që mëton ta qeverisë një vend duhet që në ofertën e tij parazgjedhore ta ketë të mirëdefinuar këtë problem dhe që njerëzve t'u prezantojnë zgjidhje të logjikshme dhe të pranueshme. Shpenzimet e pakontrolluara si dhe investimet e mundshme kapitale jashtë vendit të disa shteteve të zhvilluara si psh SHBA etj. – kanë sjellë deri tek prishja e ekuilibrave ekonomik në vend gjë që kanë pasë për pasojë edhe rritjen e shkallës së papunësisë. Pra, me problemin e papunësisë janë të përballura të gjitha ekonomitë, si ato të zhvilluara edhe ato me zhvillim më të ulët.

1.Hyrje

Çështja e papunësisë është një problem jo vetëm i shteteve të pazhvilluara dhe atyre në tranzicion, por edhe i atyre me ekonomi shumë të zhvilluar. Në përgjithësi, papunësia shfaqet kur një person është në gjendje dhe ka vullnet të punoj por është i papunë. Rëndësia e një çështjeje të tillë është aq e madhe dhe me aq konsekuenca të mundshme sa që ka bërë që çdo individ apo grup që mëton ta qeverisë një vend duhet që në ofertën e tij parazgjedhore ta ketë të mirëdefinuar këtë problem dhe që njerëzve t'u prezantojnë zgjidhje të logjikshme dhe të pranueshme. Shpenzimet e pakontrolluara si dhe investimet e mundshme kapitale jashtë vendit të disa shteteve të zhvilluara si psh SHBA etj. – kanë sjellë deri tek prishja e ekuilibrave ekonomik në vend gjë që kanë pasë për pasojë edhe rritjen e shkallës së papunësisë. Pra, me problemin e papunësisë janë të përballura të gjitha ekonomitë, si ato të zhvilluara edhe ato me zhvillim më të ulët.

Analiza e këtij problemi duhet të ketë çasje të ndryshme në kontekste të ndryshme. Psh, në vendet post-socialiste, një fenomen i tillë është paraqitur për arsye tjera. Vendi ynë Kosova si dhe ai fqinj Maqedonia, që të dyja kanë qenë njësi federale të ish Jugosllavisë. Jugosllavia socialiste që bënte pjesë në shtetet e “painkuadruara”, është njohur për një ekonomi të

=====

zhvilluar dhe si rezultat edhe popujt e saj kan jetuar në një mirëqenie ekonomike. Pas viteve 80-a, për shkak të ideve dominuese to njërës republikë brenda Jugosllavisë dhe ideve separatiste të njësive tjera, filluan çarjet e brenshme gjë që qoi deri tek luftërat ndërmjet njësive federative. Nga kjo luftë, ndonjëra njësi pësoi më pak e ndonjëra më shumë, por të gjitha u dobësuan ekonomikisht. Maqedonia ka patur fatin të fitoj pavarësinë pa luftë ndërsa Kosovës, e cila kishte një status më të pafavorshëm në krahasim me Maqedoninë, iu desh një dekadë më shumë për ta fituar pavarësinë. Të gjitha këto që u përmendën për të dy shtetet kan ndikuar në moszhvillimin ekonomik të tyre. Fakti që Maqedonia është pavarësuar më herët dhe pa luftë, nuk e ka bërë të ketë ndonjë përparësi të shquar kundruall Kosovës për shkak të kontesteve të saj me shtetin e saj fqinj – Greqinë – për shkak të emrit të saj. Ky problem e ka lënë mbrapa Maqedoninë në rrugën e integritimeve në Nato dhe EU. Maqedonia në krahasim me Kosovën ka ekonomi më të zhvilluar për arsyet e lartcekura gjë që ka reflektuar edhe në shkallën e papunësisë, në anën tjetër, Kosova edhe dhjetë vite pas përfundimit të luftës ende përballet me një shkallë të lartë të papunësisë; ajo edhe tani pothuajse përballet me të njëjtat probleme që ka patur edhe pas përfundimit të luftës.

1.1. Tregu i punës dhe politikat kundër papunësisë në Maqedoni

Politika për punësim varet nga nevoja dhe kërkesa në treg. Në përgjithësi nuk mund të themi se cilat janë politikat por politikat varen nga nevojat e kompanive .

Për të zgjidhur problemin me papunësinë, Maqedonia duhet njëkohësisht të përballet me dy sfida dhe atë zhvillimin ekonomik dhe rikonstruimin e tregut të forcës punëtore papunësia në Maqedoni është shumë e lartë dhe në këtë ndikon jofleksibiliteti dhe niveli i ulët i arsimimit.

Zhvillimi i disa sektoreve te ndryshëm ndikoi në uljen e papunësinë si zhvillimi i bujqësisë , tregtisë , industris se lehtë dhe industris së rëndë . Me zhvillimin e bujqësisë Maqedonia e pasluftës punësoi diku rreth 2-3 % te numrit të përgjithshëm , por një zhvillim tjetër është edhe tregtia ku vet pozita e saj i mundësoi nje rritje ekonomike dhe nje zvoglim të një pjese të papunëve , por edhe në industrine e lehtë si punimet e atrizanateve të produkteve ushqimore si dhe në tekstil uli dukshem numrin e te papunesuarve.

Maqedonia është pavarësuar në vitin 1991 me kushte ekonomike mjaft të pafavorshme. Në krahasim me shtetet e tjera të ish-Jugosllavisë ajo ishte shteti i zhvilluar më dobët, me shkallë të lartë të papunësisë (20%) dhe infrastrukturë më pak të zhvilluar.

=====

Procesi i tranzicionit prej një ekonomie të mbyllur dhe të planifikuar nga qendra drejt një sistemi të tregut të hapur dhe funksional është ballafaquar me shumë strese të jashtme dhe të brendshme, të cilat vazhdimisht ndikonin në politikat dhe reformat e filluara.

Strategjia e zhvillimi varet në rend të parë nga sistemi ekonomik-shoqëror si dhe nga niveli i arritur i forcave prodhuese . ne strategjine rol te rendesishem luan zgjidhja institucionale si faktor shoqëror , politika e zbatuar ekonomike dhe baza e krijuar ekonomike .

Shteti si bartes i politikës dhe zhvillimit strategjine e vet e zhvillon permes zbatimit te politikës ekonomike , si perparesi e rendesishme mund te numrohen : rritja e shpejte ekonomike dhe punësimi i plotë.

Politika e punesimit eshte nje veprimtari shume e nderlikuar ekonomike , politike dhe shoqerore.

Zhvillimi i punesimit varet prej karakterit dhe modelit te ekonomizimit , drejtimit dhe zhvillimit te ekonomise , situates demografike , rregullimit shoqeror etj .

Politikat zhvillimore te Republikës së Maqedonis orjentohe drejt politikave tatimore të cilat po e stimulojn hapjen e vendeve të reja te punës , nëpërmjet zvoglimit te tatimit te ardhurat e ndermarrjeve janë më te larta , keto te ardhura në masë të vogël ose te madhe do të orjentohe në investime të reja , konsum etj keshtu që do të ndikojnë në rritjen e kërkesës së pergjithshme efektive e cila ndikon ne rritjen e prodhimit dhe te punësimit . Politika doganore dhe subvencionet në masë të madhe po nxisin aktivitet ekonomike nëpër viset me nivel të ulët zhvillimi ekonomik në veqanti në komonat e Maqedonisë përendimore e cila ka një popullat të re dhe shë shkallë më të lartë të papunësisë. .

Politikë tjetër kishte me qenë edhe politikat kreditore ulja e interesit te bankave , kreditimi I ndërmarrjeve të vogla dhe te mesme ekonomike mund të jete mjet shumë efikas për hapjen e vendeve të reja të punës .

Por edhe zhvillimi i teknologjisë bashkekohore është një faktor që mund te krijonte te ardhura me te larta ,fitim ,akumulim dhe punesim .

1.2. Konteksti makroekonomik në Maqedoni

Republika e Maqedonisë është një vend i varfër me tranzicion problematik, i cili ishte ngarkuar me kompleksitetin e marrëdhënieve ndër-etnike dhe socio-ekonomike e kësaj kur I shtohen edhe pasojat negative që vijnë nga mjedisi i pafavorshëm ndërkombëtare (bllokada greke për shkak të problemeve me emrin, Këshillit të Sigurimit të OKB mbi embargon e RF të Jugosllavisë , si dhe lufta nder etnike etj) paraqitet një problem që ka pak mundësi zgjidhje,

=====

Për një shtet si Maqedonia që ishte shtet komunist dhe ka bërë kalimin nga një ekonomi e kontrolluar nga shteti në ekonomi të tregut të lirë, mungesa e kapitalit për zhvillimin e ndermarrje dhe stabilizimi punëdhënësve, mungesa e administrimit publik modern dhe efikas, transformim i pamjaftueshëm në sistemin arsimor, sistemin e mbrojtjes sociale dhe siguria, sociale kërkojnë përpjekje të mëdha dhe të vështira për tu tejkaluar.²⁷

Me gjithë problemet e cekura më lart në vitin 2007 Maqedonia shënon ecuri pozitive të treguseve makroekonomike . GDP-ja në tremujorin e parë të vitit u rrit në normën 7 % në tremujorin e dytë dhe të tretë pati tendencë rënie që në fund të arrihet një rritje e GDP-se prej 5.5 % në nivel vjetor .

Në këtë periudhë edhe shtetet tjera të tranzicionit shënuan norma të përafërta zhvillimi , sektor kryesor të cilët ndikuan në këtë rritje ishin ish sektori I prodhimit industrial dhe sektori i eksportit , sektori i ndërtimitaris dhe industris në Maqedoni mbuluan pjesën më të madhe të rritjes së GDP-se në tre muajt e parë kurse në tremujoret tjera kishin tendencë rënie, ndërsa që sektori i komunikacionit i tregtisë ndikuan në dinamizimin e rritjes së GDP-se.

Nga këndvështrimi i kërkesës agregate , norma e lartë e rritjes ekonomike u realizua me kërkesën e rritur të vendit në përmisimin e pozitës së tregtisë jashtme.

Rritja e theksuar e eksportit të hekurit dhe qelikut dhe niveli I rritjeve të prodhimeve të tekstilit mundësoi zvoglimin e deficitit të bilancit tregtar për tremujorin e parë të vitit 2007 me 13.2% , kurse konsumi shënoi rritje për 6% .

Në tremujorin e dytë punësimi u rrit me 3.5% ndërsa papunësia u zvoglua me 1.6% ku norma e papunësisë u ul nga 36.2 % në 35.8%.

Rritja e kërkesës për produktet e Maqedonisë si shembull. - shitja e metaleve ndikoi në shtimin e depozitave nga jashtë , kjo situatë ndikoi në realizimin e suficitit në bilancin e pagesave . Në gjashtë muajt e parë të vitit 2007 në llogaritë e bilancit të pagesave u realizua suficit 62.5 milione euro përkundër deficitit 51.6 milione euro të gjashtë muajt të parë të vitit të mëparshëm.

Kurse në fund të vitit 2007 Maqedonia arriti normë të inflacionit 10% e cila u bë si rezultat i ndikimeve të jashtme ku si vatrë kryesore ishte rritja e çmimeve të energjisë elektrike por zbutja e politikës tatimore dhe vijimi i zvoglimit të normave të interesit në kushtet e mjedisit të volitshëm ekonomik , ndikuan në rritjen ekonomike .

27 Mbrojtja sociale dhe Përfshirja sociale në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë f 20

Por si në rastin e Kosovës ashtu edhe në Republikën e Maqedonisë dallimet e mëdha ndërmjet: 1.GDP-së dhe konsumit, 2.Kursimeve dhe investimeve vendore, 3.Nevojave për investime publike dhe kapacitetit të buxhetit, Eksportit dhe importit,dhe 5.Papunësisë dhe nivelit të investimeve, vënë në pah nevojën e përqendrimit të përpjekjeve kah zvogëlimi i këtyre shpërpjestimeve .

1.3. Indikatorët bazë të tregut të punës në Maqedoni

Si ne rastin e Kosoves kemi edhe indikatorët baze për tregun e punës edhe në Republikën e Maqedonisë dhe indikatorët baze të tregut të Maqedonisë janë :

2. Struktura kombëtare e popullsisë

Repubilika e Maqedonis sipas regjistrimit të vitit 2002 ka 2,022,547 banorë.

Përbërja etnike e popullsisë së shtetit të Maqedonis është e shumëllojshme, me 64.18% maqedonas, 25.17% shqiptarë , 3.85% turq, 2.66% romë, 1.78% serbë, 0,84% boshnjakë, 0.48 vllehë dhe 1.04% të tjerë




Fig.1.Struktura etnike e Maqedonisë

2.1.Punësimi

Dekada e rritjes ekonomike së ngadalshme filloi të përmirësohet ngadalë, por vazhdimisht duke filluar prej vitit 2001. Në vitin 2002 GDP shënoi rritje prej 0.9%, pas së cilit në 2003 arriti rritje prej 2.8%, kurse prej

=====
 vitit 2004 shënon rritje prej 4%. Parashikimet të Drejtorisë së Përgjithshme për Çështje Ekonomike dhe Financiare (2008) tregojnë rritje relativisht të matur prej 3.1% në vitin 2006 në krahasim me 3.8% në 2005. Shkaku themelor për këto rezultate relativisht të matura ishte rritja më e dobët se sa pritej në fushën e prodhimitarisë, bujqësisë dhe ndërtimtarisë. Për shembull, prodhimtaria industriale shënoi rritje prej vetëm 2.5% në vitin 2005. Prodhimtaria bruto vendase për çdo banor në pikëpamje të fuqisë blerëse është 26% e mesatares të BE-së. Megjithatë ekzistojnë dallime të dukshme rajonale të GDP-së për çdo banor në raport me standardet e fuqisë blerëse, e cila është pothuajse dy herë më e madhe në rajonin e kryeqytetit (afërsisht 50% e mesatares së BE-së, në krahasim me mesataren nacionale prej afërsisht 25% të mesatares së BE-së). Ky dallim i'u detyrohet dallimeve të theksuara në investimet e infrastrukturës dhe të ardhurave në kryeqytet dhe zonat rurale. Sipas parashikimeve për vitin 2007 të Drejtorisë së Përgjithshme për Çështje Financiare dhe ekonomike llogaritet që GDP-ja do të rritet deri në 4.3% në vitin 2007 dhe 5.3% në vitin 2008.

Paga mesatare mujore bruto në vitin 2006 ka qenë 23,036 denarë apo 374.56 euro (duke e përfshirë tatimin personal të të ardhurave dhe të ardhurat e mbrojtjes sociale të punësuarve) Paga mesatare neto për të njëjtën periudhë ka qenë 13,527 denarë apo 219.95 euro.

Në vitin 2006 paga mesatare mujore u rrit për 7.3% në krahasim me vitin 2005. Përkrah pagave të vogla mujore, gjithashtu ekziston një numër i madh të punësuarish të cilët nuk marrin paga rregullisht (në dhjetor 2006, 13.3% prej të gjithë të punësuarve nuk kanë marrë rrogë).

Rritja ekonomike ne Maqedoni fillon pas vitit 2001 dhe kjo rritje ekonomike vazhdon ne perqindje te vogel deri ne vitin 2009 , si ne tabelen e meposhtme²⁹ .

29 Enti I Statistikave të Maqedonis




Fig.2.Rritja ekonomike e Maqedonis 2001 – 2010.

Nga ky grafik shohim se niveli I papunësis ka rënë në krahasim me vitin 2001 deri ne vitin 2009 dhe kjo ngritje I referohet kryesisht zhvillimit të sektorit privat.

2.2.Punësimi sipas strukturës sektoriale

Në kuader të sektorëve ekonomik, ndertimtaria , komunikacioni dhe postë-telekomunikacioni kane pasur veprimtari me te larta investuese rreth 50% (2008) , elektroekonomia është një sektor që ka përfshirë 9% te investimeve te përgjithshme në vitin 2005. Komunikacioni dhe postë-telekomunikacioni kanë një rendësi të veqant për zhvillimin ekonomiko-shoqërore te Maqedonisë, por ky orientim i investimeve ka ngushtuar hapsirën e veprimtarisë prodhuese në sektorin parësor I cili është kusht , për zhvillim ose me fjalë tjera te rrisim prodhimin dhe te përmiresojmë strukturën prodhuese , për të qenë konkurent në tregun e jashtëm I cili përbën qellimin themelor te transformimit te kapitalit shoqëror e shtetror te vendit. Maqedonin e karakterizon një struktur e prapambetur ekonomike, që sipas nivelit të zhvillimit ekonomik në krahasim me vendet ballkanike dhe radhitet me vendet jo mjaftë te zhvilluara .

Në tabelën e meposhteme është e paraqitur ndryshimi e struktures sektoriale të punësimit ne ekonomine e Maqedonise³⁰ .

	Viti	Sek. primarë	Sek. sekondar	Sek. terciar	Totali ne %
Republika e Maqedonisë	2001	9.0	45.0	46.0	100 %
	2008	9.7	31.8	58.5	100 %

30 :Enti Shtetëror I statistikave të Maqedonisë. Zhvillimet sektoriale në Kepublikën e Maqedonisë

Tab.3. Zhvillimet sektoriale në Kepublikën e Maqedonisë

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën e mësipërme shihet që sektori dytësor ka pësuar rritje në mënyrë të ndjeshme nga 45.0% në 31.8% kurse në sektorin tretësor ka pasur rritje nga 46 % për vitin 2001 në 58.5 % në vitin 2008, që nuk është rezultat i zhvillimit ekonomik të Maqedonisë por me falimentimin e sektorit të industrisë, fillimi i procesit të tranzicionit bëri të mundur hapjen e një numri të madhë firmash të vogla, sidomos në lëmin e tregtisë që u punësuan një numër i konsiderueshëm i të papunëve.

3. Papunësia

Papunësia është forma më drastike e barazise sociale, personat e papunësuar ndihen si të tepërt dhe të varur ata paraqesin barrë për shoqërinë. Shtetet me shkallë të ulët të papunësisë kanë qëndrueshmëri shoqërore, kurse ato me papunësi të lartë karakterizohen me tensione shoqërore, aftësia e sistemit për të zgjidhur problemin e papunësisë llogaritet si detyrë e qdo vendi.

Papunësia në aspektin ekonomik paraqet formën më të shtrenjte të shfrytëzimit të pamjaftueshmë të faktoreve zhvillimore, niveli i papunësisë është një barometër që tregon nivelin e zhvillimit të një vendi.

Vendet e zhvilluara kanë nivel të papunësisë të ulët kurse ato të pa zhvilluara kanë nivelin e lartë të papunësisë, përderisa Maqedonia hyn në grupin e dytë me një nivel të lartë të papunësisë.

Pasqyra e personave të papunësuar në Maqedoni 31.07.2007.³¹

Nr	Qendrat për punësim	Totali	Qytet	Fshat	Totali	Qytet	Fshat
1	Berov	4175	2014	2161	419	118	301
2	Manastir	19831	14472	5359	2863	1686	1177
3	Vallandov	2891	937	1954	617	134	483
4	Veles	14606	10396	4220	2932	1324	1608
5	Vinic	3461	2060	1402	600	323	277
6	Gjevgjeli	3651	2231	1420	650	326	324
7	Gostivar	16816	8942	7874	4926	1981	2945
8	Diber	4329	2783	1546	156	33	123
9	Delceve	4177	2755	1422	382	211	171
10	Demirhisar	2155	597	1558	120	13	107
11	Kavadarci	8605	6352	2253	597	411	186
12	Kercov	8682	5263	3419	2041	923	1118

³¹ ESHS të Maqedonisë- Niveli i papunësisë sipas komunave

13	Kocan	10793	6622	4171	948	557	391
14	Krivapallank	6934	4296	2638	300	120	180
15	Krushev	2642	1400	1242	218	20	198
16	Kumanove	31939	21389	10550	8113	4231	3882
17	Mak.Brod	2683	1467	1216	417	61	113
18	Negotine	5114	3748	1366	1036	661	375
19	Oher	12189	9021	3168	1540	887	653
20	Prilep	24454	18455	5999	5544	3246	2298
21	Probishtip	3686	3094	592	532	388	144
22	Radovish	6438	2994	3444	1067	466	601
23	Resen	3093	1659	1434	201	79	122
24	Svet Nikole	4713	2986	1227	343	125	218
25	Shkup	85916	75213	10703	22661	18281	4380
26	Struge	9071	3081	5990	941	162	779
27	Strumnic	19900	7263	12637	8010	1971	6039
28	Tetove	29886	13268	16618	7201	1290	5011
29	Shtip	8962	7966	996	1058	835	223
Gjithesejt		364.351	244.663	119.688	76.414	41.884	34.530

Tab.4. Niveli i papunësisë sipas komunave

Nga tabela më lartë vërejmë se në statistika janë të shënuar numri i të papunëve dhe numri I atyre që janë të regjistruar nëpër entete sociale për sigurim social , por mendohet se numri i të papunëve në Republikën e Maqedonis sillet diku rreth 390.361 persona .

3.1.Statusi i aktivitetit

Sipas statusit të aktivitetit popullsia e Maqedonis përfshihet në njerën nga kategoritë që janë të cekura më poshtë dhe ndahen në tri statuse : 1. Të punësuar 2. Të papunë dhe 3. Jo pjesë e fuqisë punëtore .

Të punësuar – janë personat që pjesën më të madhe të javës e kalojnë në punë dhe kanë një pagë .

Të papunë - janë personat që janë të aftë për punë por nuk janë në punë ose janë pushuar nga puna ose pushim të përkohshëm ose të ngjajshme.

Jo pjesë e fuqisë punëtore - të gjithë ata persona që hyjnë në rangun e të moshuarve , student etj.

=====

Karakteristikat e papunësisë në Maqedoni

Struktura e papunësisë është treguesi më i sigurt i pozitës ekonomike dhe sociale të atyre të cilet presin vende të reja të punës . Nëse në ekonomit e vendeve të ndryshme mbizotëron kategoria e personave që presin punë në periudha afategjata, atëherë kemi të bëjmë me probleme shumë serioze në sferën e papunësisë dhe paraqitet një pozite të vështirë ekonomiko-sociale për ata që presin punësim Një situatë të tillë e hasim në Republikën e Maqedonis ku sipas statistikave të nxjerra nga Enti Statistikor i Maqedonisë për punësim i bërë në vitin 2003 mbi 44% të të papunësuarve presin punë më shumë se 5 vjet ku afërsisht në përqindje 22% e të papunësuarëve presin punë për herën të parë³².

Nr	Koha e pritjes për punë	Nr i të papunëve	Pjesëmarrësit në %
1	Deri në një muaj	9.471	2.4
2	Prej 2-5 muaj	26.393	6.8
3	Prej 6-11 muaj	33.344	8.5
4	Prej 12-17 muaj	24.743	6.4
5	Prej 18-24 muaj	28.644	7.3
6	Prej 2-3 vjet	34.606	8.9
7	Prej 3-4 vjet	32.626	8.6
8	Prej 4-5 vjet	26.915	6.9
9	Prej 5-8 vjet	72.378	18.5
10	Mbi 8 vjet	100.378	25.7
	Gjithësej	390.361	100 %

Tab.5. Kohëzgjatja e papunësisë në Maqedoni

Sipas Entit të Statistikave për punësim ¼ e të papunësuarve që kërkojnë punë ndodhen në Shkup më pas vije Kumanova me papunësinë e përgjithshme 8.5 % , Tetova me 7.2% , afërsisht 66% e të papunëve jetojnë në qytete dhe 34% të tyre jetojnë nëpër fshatra .Struktura e të papunësuarve sipas kualifikimit ka rëndësi të madhe sepse paraqet potencialin e fuqisë punëtore, vendet që kanë të papunë të kualifikuar ndodhen në pozitë më të mirë se vendet me të papunë të pakualifikuar, Maqedonia ndodhet në pozitë të pa volitshme sepse më shumë se gjysma e personave që kërkojnë

³² Enti shtetror i punësimit – Maqedoni-2003

punë janë të pakualifikuar dhe pa përvojë pune , vetëm 5.6% janë me shkollim të lartë që kërkojnë punë, këtë e shohim në listën e mëposhtme.³³

Nr	Kualifikimi	Nr i të papunëve	Pjesëmarrësit në %
1	Te pakualifikuar	186.187	47.70
2	Gjysme të kualifikuar	16.575	4.24
3	Te kualifikuar	70.367	18.02
4	Me kualifikim të lartë	227	0.05
5	Me shkollë të mesme	95.043	24.37
6	Me shkollë të lartë	7.125	1.82
7	Me fakultet	14.644	3.77
8	Magjister	82	0.02
9	Doktor të shkencave	11	0.002
	Gjithesëj	390.361	100 %

Tab.6. Struktura kualifikuese e fuqisë punëtore të papunësuar në Maqedoni

Analizë e politikave të tregut të punës në Maqedoni

Zhvillimi i politikave përmes masave aktive të Qeverisë për uljen e papunësisë në Republikën e Maqedonisë ndikoi që numri i të papunësuarve në vend në vitin 2008 ka shënuar rënie që dmth se rritja e numrit të të punësuarve është tregues i nivelit të zhvillimit ekonomik në vend.

Si rezultat i këtyre masave të politikave aktive edhe shkalla e papunësisë në Maqedoni edhe pse në përqindje dukshëm të ulët, megjithatë është duke u përmirësuar, dmth këto masa po japin rezultate të mira. Për vitin 2008 përmes këtyre masave ishin punësuar diku mbi 7000 persona .

Rritjen e punësimit dhe uljen e shkallës së papunësisë në programin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për periudhën 2006-2010 janë paraparë tri shtylla:

1. Rritja e aftësisë konkurruese të kompanive të Maqedonisë.
2. Rritja e investimeve direkte dhe të huaja.
3. Përmirësimi i kapaciteteve të institucioneve publike dhe implemetimi i reformave .

Nga ajo që u tha më lart shohim se ekonominë e vogla siç është rasti i Maqedonisë zhvillimin e vet mund ta shohin përmes eksportit. Në të ardhmen eksporti i mallrave të Maqedonisë pritet të rritet në shtetet ekonomikisht të zhvilluara dhe atyre të BE-së

33 Burimi : Enti shtetror i punësimit – Maqedoni. Struktura kualifikuese e fuqisë punëtore të papunësuar në Maqedoni

Politikat e zhvillimit të tregut në Maqedoni kanë tendenca rritje në industrinë e lehtë dhe atë të rëndë por përfaqësim më të lartë kanë pasur lemenjët e prodhimit parësor (prodhimi i rrymës, prodhimi i materialit ndërtimor , prodhimi i xeheve, prodhimi i tekstilit , prodhimi i letrës dhe prodhimet grafike).

Maqedonia dhe Kosova kanë prodhuar lëndët e para dhe gjysëmfabricate sepse gjatë ish Jugosllavise përpunimi i këtyre lëndëve është bërë në Serbi , Slloveni dhe Kroaci , dhe në këtë pjesë të tregut të punës një pjesë e fabrikave kanë falimetur është dashur që të mbyllen , ashtu që është rritur dukshem numri i të papunëve .

Por duke u nisur nga baza ekzistuese si dhe orientimet e mundshme strukturore të ekonomise së Maqedonisë sektori i ndustrisë së tekstileve në bazë të ecurisë së punësimit që nga viti 2002 , 2005 , 2010 në vitin 2020 do ta trefishoje punësimin e krahasuar me vitin 2005 ose te themi se rritet për 2.2 herë.

Te dhënat e tabelës së mëposhteme tregojnë se sektori I ndërtimtarisë dhe ai i metalurgjisë së zezë premtojnë rritjen e punësimit me 1.6 herë , perkatesisht 1.2 here në vitin 2020 krahasuar me nivelin e punesimit me vitin 2000.

Kurse sektori i industrisë së letrës dhe elektroekonomia pritet të zvoglojnë numrin e të punësuarve prej 426 përkatësisht 3159 krahasuar me numrin e të punesuarve te vitit 2000.

Bazuar në situatën aktuale , pritet që shërbimet e infrastrukturës së informatikës në të gjitha veprimtarit të fillojnë të dinamizohen pas vitit 2010 Por gjithashtu pritet që sektori I industris së Maqedonise pas vitit 2015 te arrijë fazën e pjekurisë së plotë duke mundësuar shtrirjen e efekteve te saj ne sektorin tretësor duke kontribuar në rritjen e numrit të të punesuarve .Paraqitja e parashikimeve të punësimit në sektorët e ekonomis së Maqedonis deri në vitin 2020.³⁴

Sektoret / Vitet	2000	2005	2010	2015	2020
Ind. Tekstilit	30.686	40.825	51.710	68.573	89.981
Ind. Letres	1.636	1.439	1.361	1.279	1.210
Sek. Ndertimtari	27.658	28.731	29.938	35.941	45.633
Mjetet.e komunikim	5.396	3.296	2.025	781	- 371
Metale me ngjyra	1.880	2.094	1.529	814	- 157
Ind. duhanit	5.272	3.410	1.924	62	- 205
Mak.dhe aparatet	5.365	6.100	3.110	654	- 1.203

34 Statisticki Godisnik na Republika Makedonija, Drzaven zavod za statistika , Skopje

Elektroekonomia	8.496	8.112	6.957	5.337	3.194
Metal. zeze	6.455	5.745	5.946	6.736	8.090

Tab.7. planifikimi për 10 vitet e ardhshme

3.4. Konkluzione

Nga informatat e paraqitura më lart shohim se tregun e punës të Republikës së Maqedonisë e karakterizon një papunësi e lartë me një fuqi të pashfrytezur punëtore, për shkak të ndryshme por një ndër kryesoret për qindja e madhe e të papuneve me nivel të ulët të shkollimit është tregues për ekonominë e dobët të vendit ,

Me gjasë politikat që është duke i bërë Qeveria e Maqedonisë në industrinë e rëndë dhe shërbimet e infrastrukturës së informatikës do të jenë një nismë pozitive për uljen e papunësisë në një periudhë afatmesme.

Maqedonia është duke bërë politika favorizuese për investitorët e jashtëm që të investojnë në këtë vend si dhe janë duke u përgatitur që me produktet e tyre finale të pushtojnë tregjet e vendeve të pasuar si dhe ato të BE-së. Këtë pushtim të tregjeve siç u tha më herët Qeveria e Maqedonisë ka ambicie ta realizojë me favorizimin e Bizneseve të vogla dhe të mesme që do të nxiste një zhvillim të hovshëm ekonomik për këtë vend të varfër në karahasim me vendet e BE-së.

Politikat që duhet bërë si në rastin e Kosovës ashtu edhe atë të Maqedonisë duhet të bëjë reforma në shtetin arsimorë për përgatitjen e kadrovave sipas standardeve të BE-së që të ketë mundësi konkurimi në tregun e dijes të regjionit që do të nxiste një zhvillim të hovshëm për shtetin e Maqedonisë.

Trashëgimi i teknikave dhe teknologjive të njëjta i referohet faktit se të dy ekonomitë kryesisht kanë prodhuar dhe eksportuar brenda federatës së ish Jugosllavisë gjysëmprodukte për republikat më të mëdha të cilat kanë prodhuar produktet e gatshme për eksportime jashtë federatës Qasja e integruar e politikave në mbështetjen dhe promovimin e eksportit – aftësia konkurruese, stimulimi dhe promovimi i eksportit janë disa prej veprimeve në të cilat duhet të jenë të fokusuar qeveritë e të dyja vendëve.

4. Literatura

1. Rudriger Dornbusch -Makroekonomia - Depaamentit I Ekonomisë – Institutit Massachusetts I teknologjisë
2. Stanley Fischer – Makroekonomia – Banka Botërore dhe Depaamentit I Ekonomisë – Institutit Massachusetts I teknologjisë.

3. Dr.Petrit Pollozhani - Struktura Ekonomike dhe Punesimi si prezentues te zhvillimit ekonomik (2006) Strugë
4. Rudiger Dobrnbusch & Stanley Fischer - MACROECONOMICS
5. Dr.Nexhat Muhaxheri – MakroEkonomi (2005) Prishtine
6. Prof.Dr.Isak Mustafa – Biznesi dhe punesimi - mbeshitetur Fridrich Ebert Stiftung .(2006) Prishtine
7. Goce Petrovski - Nevrabotenosta i rastot vo Rapublika Makedonija.
8. Nacionalna strategija za ekonomski razvoj Republike Makedonije. (1997) Skoplje
9. Nacionalna razvojna strategija za Makedoniju, razvoj i modernizacija. (1997) Skoplje
10. Rose, N. Socijalne politike. (1994) Skopje
11. Rose, N. Sovremeni sustava socijalne zaštite. (1995). Skopje:

KUD 338.48 9496.51:497.7)

VLERAT ATRAKTIVE POTENCIAL PER ZHVILLIMIN E EKOTURIZMIT NË MALIN SHARR

Mr.sc. Bedri Millaku, Phd candidat

Abstrakt

Mali i Sharrit është potencial për nevojat e veprimtarive turistiko-rekreative, përfshin pjesën qendrore të Gadishullit Ballkanik. Pjesa më e madhe i takon Kosovës. Perketesisht pjesa veriore prej rreth 1100 km², pjesa jugore prej 500 km² Republikës së Maqedonisë. Siperfaqja e përgjithshme 1600 km², parqet potenciale të rendesishme për zhvillimin e ekoturizmit me vlera të veqanta atraktive. Vlera atraktive të madhe paraqesin 25 liqej të cilët kalojnë lartësinë absolute mbi 1900 m. Bimët barishtore të cilat mbulojnë sipërfaqe të shumta. Të gjitha kullosat janë malore. Malet e Sharrit përfaqësojnë qendrën Ballkanike të biodiversitetit me përafërsisht 2.000 lloje bimore prej të cilave 200 lloje janë endemike (karakteristike për regjionin). Fauna e pasur dhe mjedisi i pastër ekologjik dhe mjaft i shëndetshëm ku mund të gjëndet qetësia shpirtërore për vizitorët. Me të vertet paraqet potencila për zhvillimin e ekoturizmit si turizmi i bazuar në natyrën, i cili kursen e mjedisin dhe për të ruajtur mirëqenien e popullatës lokale duke përfshirë elemente të turizmit kulturor dhe rural.

Fjalët çelës; Ekoturizëm, Malet e Sharrit, R.Kosovës, R. Maqedonisë, Biodiversitet, Florë, Faunë

Hyrje

Kjo përbënë rreth 25% të florës së përgjithshme të Ballkanit dhe rreth 18% të florës së Evropës në mesin e të cilave 86 lloje janë shpallur ndërkombëtarisht të rëndësishme, 26 prej tyre janë përfshirë në Listën e Kuqe të bimëve të kërcënuara të IUCN-së³⁵. Veçoritë gjeomorfologjike dhe gjeologjike – Malin e Sharrit e përbejnë, majet më të larta dhe pjesët e ulëta me shumë forma atraktive dhe me formacione të ndryshme gjeologjike. Mali Sharr” sipas klasifikimit klimatik të Kosovës hyn në klimën lindore kontinentale, me veqori mjaft të pershtatshme për zhvillimin e turizmit. Reshjet e shumëta janë begati malit të Sharrit me ujëra të cilat peisazhit i japin vlera atraktive të veçantë. Si për nga rrjedhat lumore ashtu edhe me

³⁵ Instituti për Mbrojtjen e Natyrës Prishtinë.

=====

liqen mjaft atraktive. Territori i “Mali Sharr” dallohet me begati të florës dhe me shumë breza vegetativ, të cilët janë në pajtim me ndërrimin e lartësive mbidetare. Mali i Sharrit është i pasur me shtazë të ndryshme. Janë të përhapur lloje të veçanta të shtazëve, dhe i përkasin llojeve endemike. Ekonomia turistike – Në Malin e Sharrit ngërthen në vete të gjithë veprimtarinë që është në funksion të zhvillimit të turizmit në këtë hapësirë. Ne këtë pjesë ka potencila në disponim për zhvillimin e turizmit siq janë: turizmi dimëror, turizmi veror, turizmi malor rural, turizmi i gjuetisë dhe peshkimit, turizmi shëndetësor, turizmi alpinist, aktivitetet në natyrë, ekskursionet turistike, të cilat me angazhim dhe veprimtari të shoqërisë do të vëhen në shërbim të ofertës turistike.

Pozita gjeografike

„Mali Sharr” përfshin pjesën qendrore të Gadishullit Ballkanik, shtrihet në kryqëzimin e rrugëve në drejtimin lindje – perëndim ndërmjet Detit të Zi dhe detit Adriatik. Në drejtimin veri – jug ndërmjet Evropës së Mesme dhe Detit Egje. Pjesa më e madhe takon Kosovës Perlatësisht pjesa veriore prej rreth 1100km², pjesa jugore e maleve të Sharrit me sipërfaqe prej 500 km² Republikës së Maqedonisë. Kufiri në mes të Kosovës dhe R. Maqedonisë kalon nëpër majat malore të Sharrit në jug dhe jug – lindje të Kosovës përmes kuotave të larta malore të Lubotenit (2.499m), Kullës (2.314m), Livadicës (2.491m), Cukës së Liqenit (2.604m), Bistrës (2.640m), Majës së zezë (2.584m), Koblicës (2.526) dhe Kara Nikollës (2.106m). Nga pjesa perëndimore mali Sharr kufizohet me republikën Shqipërisë. Përmes luginës së lumit Lepenc (Siriniq) lidhet me Fushën e Kosovës ndërsa përmes Luginës së Lumëbardhit të Prizrenit (Sredska) lidhet me Rrafshin e Dukagjinit³⁶. Nga sipërfaqja e përgjithshme e maleve të Sharrit 1600 km² parqet potenciale të rëndësishme për zhvillimin e ekoturizmit me vlera të veçanta atraktive. Për nga aspekti floristik, “Mali Sharr” bën pjesë në malet më të begatshme të Gadishullit Ballkanik.

³⁶ , Dr. Riza I. Çavolli, Gjeografia regionale e Kosovës, Prishtinë 1997.



Pozita Gjeografike e Maleve te sharrit³⁷

Të dhënat themelore për malin Sharr

Brenda territorit te malit ekzistojnë zona me vlera të veçanta natyrore: Maja e Arnenit Koxhoballkani (Pisha e Madhe, Oshlaku - Rusenica -, Livadhi i Mbretit – Liqeni i Jazhinces, Lumi i Bukuravqës, etj. Bukuritë natyrore si pyjet dhe kullosat janë karakteristikë e këtij regjioni. Vlera atraktive te madhe paraqesin 25 liqej te cilet kalojnë lartësinë absolute mbi 1900 m. Ne malin Sharr janë te pranishme Lumenjtë Lepenc, Nerodime dhe Lumbardhi i paraqesin rrejt atraktiv- hidrografik të pasur me ujë të pastër. Të gjitha përbëjnë potencial me vlera të larta turistike.

Veçoritë e kullosave

Bimet barishtore ne malet e Sharrit mbulon siperfaqe te shumta ndërsa shumica e sipërfaqës është e përshtatshme për kullotjen e bagëtive. Të gjitha kullosat janë malore, në kuadër të të cilave veçohen dy lloje:

- Kullosat pyjore (kullosat në tokat pyjore deri në 2000 m).
- Kullosat e maleve të larta (kullosat mbi vegjetacionin pyjor mbi 2200 m). Kullosat karakterizohen me mbulesën e pasur barishtore dhe burimet ujore të cilat krijojnë kushte të volitshme për hvillimin e blegëtorisë.

³⁷ Mnistria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapesinor-Prishtinë.

=====

Kullosat shtrihen mbi vegjetacionin pyjor deri të majet më të larta ku gjendet mbulesa barishtore. Për këtë shkak quhen edhe kullosat e maleve të larta apo kullosat alpike. Këto kullosa përbëhen nga bimët barishtore në kuadër të të cilave dominojnë bashkësitë e barit (graminae).

Kullosat primare, gjëgjësisht kullosat e maleve të larta gjenden në terrenet ku mund të zhvillohen vetëm bimët barishtore dhe për shkak të lartësisë së madhe mbidetare dhe kushteve klimatike ato shfrytëzohen vetëm gjatë sezonës verore (prej 6-15 maj deri 15 shtator). Kufiri i poshtëm i kullosave të maleve të larta nuk është me një nivel të caktuar të lartësisë mbidetare në gjithë territorin e Parkut nacional, por ai dallon si pasojë e ndikimit të relievit, klimës, ekspozicionit, veçorive të tokës dhe ndikimit të njeriut, ashtu që në disa rajone fillon prej 1600 m deri në 2000 m të lartësisë mbidetare. Duke marr parasysh se kufiri i kullosave të maleve të larta gjendet prej 1600 m deri mbi 2300 m, mund të konstatohet se amplituda (diferenca) e lartësisë mbidetare të kullosave është shumë e madhe (afro 700 m).

Kullosat e maleve të larta të janë mjaft të pasura me lloje bimore, në kuadër të të cilave veçohen llojet e shumta endemike.

Trashëgimia natyrore – Vlerat me bukuritë dhe atrakcionet e shumta natyrore në malin e Sharrit të cilat janë të rëndësishme për Planifikimi hapësinor. Mbrojtja e natyrës është veprimtari multidisiplinare dhe është pjesë integrale e zhvillimit të përgjithshëm shoqëroro-ekonomik. Përparimi i vlerave të natyrës në këtë pjesë paraqet potencial të madh për të gjithë për zhvillimin e turizmit.

Biodiversiteti - Malet e Sharrit përfaqësojnë qendrën Ballkanike të biodiversitetit me përafërsisht 2.000 lloje bimore prej të cilave 200 lloje janë endemike (karakteristike për vendin). Kjo përbën rreth 25% të florës së përgjithshme të Ballkanit dhe rreth 18% të florës së Evropës në mesin e të cilave 86 lloje janë shpallur ndërkombëtarisht të rëndësishme, 26 prej tyre janë përfshirë në Listën e Kuqe të bimëve të kërcënuara të IUCN-së.

Veçoritë geomorfologjike, gjeologjike, klimatike, hidrologjike dhe peisazhore

Veçoritë geomorfologjike dhe gjeologjike – Malin e Sharrit e përbejnë, majet më të larta. Këto janë malet ndërmjet kufirit të Republikës së Maqedonisë dhe Kosovës Pamja e fundit morfologjike e trevës së Sharrit, është para se gjithash rezultat i lëvizjeve tektonike me të cilat janë krijuar tërësitë kryesore geomorfologjike dhe më vonë i forcave të jashtme që kanë ndikuar, akullnajat, rrjedhat ujore etj. Si shkak të veprimit të akullnajave me të cilat kanë qenë të mbuluara pjesët e larta të Sharrit gjatë kohës së akullnajave janë krijuar një numër i madh i thellimeve akullnajore (cirqeve),

valëve si dhe sasive të mëdha të morenave (materialit akullnajor). Në këto thellime (cirqe) më vonë janë krijuar liqej të akullnajave, më të njohurit janë liqejt atraktiv të Livadicës dhe Jazhincës. Pastaj theksohen thellimet cirkore të Çuka e liqejeve dhe Livadica³⁸. Në formën morfologjike të Sharrit në një përmasë më të madhe ndikojnë rrjedhjet lumore. Ndërsa në pjesët më të ulta luginat kanë pamje normale.



Pamje atraktive nga Malet e Sharrit

Veçoritë klimatike – ”Mali Sharr” sipas klasifikimit klimatik të Kosovës hyn në klimen lindore kontinentale. Nga analiza e bazës së të dhënave në sektorin e meteorologjisë rezultojnë se temperatura mesatare vjetore shumë vjeçare është 8.4 gradë celsius. Muaji më i ftohtë është janari me -1.8 dhe -1.3 gradë celsius. Vlerat ekstreme të temperaturës në vitin 1963 me -33 dhe -34⁰C. Temperatura mesatare ditore variojnë nga 22-25⁰C. Vlera mesatare e lagështisë relative është 67-70 %. Era arrinë shpejtësinë nga 1 deri në 30 m/s, dominojnë drejtimet e erës nga ana e Jugut, jugpërendimit dhe juglindjes. Sasia e reshjeve si vlerë mesatare në Shterpcë dhe Jazhincë variojnë nga 670 deri në 1200 mm³⁹. Në muajin shkurt dhe Mars paraqiten orteçet e borës si fatëkeqesi natyrore. Ditë me diell në këtë rajon ka prej 220 deri në 280. Vrantësit dhe lidhshmeria me rrezatimin e diellit dukshëm ndikojnë në valorizimin turistikë. Trashesia e borës ka arritur lartësinë deri në 3 metra në vitin 1956. Numeri i ditëve me reshje bore dhe lartësia me e madhe e bores pas vitit 1956 janë regjistruar në vitin 1981, në Jazhincë 117 ditë me trashesi 89cm, në Shterpcë 108 ditë me trashesi 90 cm. Është karakteristike e përgjithshme se klima e ofron mundësi të favorshme për valorizimin turistikë

³⁸ . I.A. gjeomorfologjia e pjesës së malit Sharr të vënë nën mbrojtjen e natyrës, dorëshkrim.

³⁹ Instituti Hidrometrologjik i Kosovës-Prishtinë

si gjatë stinës së dimrit ashtu edhe në stinët e tjera vjetore. Vlerat e temperaturës për dallim prej territorit që e rrethon, janë shumë të ulëta, nga kjo edhe gjatësia e periudhës me temperatura të ulëta, gjëgjësisht periudha dimerore është me e madhe, përkatesisht zgjatë deri në 4 muaj, e që kushtëzon krijimin e mbulesës së trashë të borës dhe mundësinë e valorizimit turistik për sportet dimrore. Po ashtu, duhet cekur dukurin meteorologjike - inverzionin e temperaturës, i cili krijohet për shkak të nxëmjes jo të barabartë të shpateve malore dhe ultësirave, e që përfaqëson përshtatshmerinë për valorizim turistik. Gjatë verës vlerat e luhatjes së temperaturës në Malin Sharr nuk janë të larta që po ashtu shkon në favor të zhvillimit të turizimit rekrativ veror.



Pejsazh dimëror nga malet e Sharrit

Veçoritë hidrologjike – Reshjet e shumëta janë begati malit Sharrit me ujëra të cilat peisazhit i japin vlera atraktive të veçantë. Rrjedhjet sipërfaqësore, për shkak të konfiguracionit të terrenit dhe sasisë ujore, gjatë reshjeve dhe shkrirjes së borës, janë mjaft të theksuara. Rrjedhjedhat me ujë të lumenjve malorë me numër të shprehur të ujvareve dhe rrjedhjeve të rrëmbyeshme, të cilat këtë territor e presin në të gjitha drejtimet, i japin pamje mjaft terheqese për vizitorët. Mali Sharr është i pasur me një numër të madh të liqejeve malorë, më të mëdhenj ose më të vegjël që janë krijuar në thellësitë e akullnajave (glaciale).

Liqenet – Liqenet akullnajore janë prej atrakcioneve me vlera më të mëdha të Malit Sharr. Në lartësinë absolute mbi 1.900m janë të përhapura 25 liqej të cilët veqohen sipas bukurisë dhe madhësisë; Liqeni Livadica dhe Liqeni i Jazhincës, Gornjasellës, Karanikollës, Miskovës dhe Bezdankës dallohen me atrakcionet e tyre. Liqeni më i madh është liqeni i Livadicës që

=====

shtrihet nën majën me te njëjtin emër në latesinë 2.173m. I cili veqohet me elemente morfologjike dhe morfometrike; form te zgjatur, gjatësi 230m gjerësi 120m, me thellësi më të madhe prej 7.3m. Në stinën e verës temperatura e ujit nganjehere arrijnë edhe deri në 20°C, me çka iu mundëson vizitorve larje në te. Liqeni i Jazhincës shtrihet në pjesën e ashpër dhe shkëmbore të Sharrit – nën majën e Bistrës, ka sipërfaqe me të vogël se Livadica, ka gjatësinë prej 120m, gjerësinë 80m, por është më i thellë i cili arrijnë thellsinë (11m).

Liqeni i Karanikollës ka i gjatësin 115m, dhe gjerësin 102m me thellësi vetëm 0,8m. Liqeni i Gornjësellës shtrihet tek burimi i lumit Bistrica e Prizrenit– gjatësia e tij është 100m, gjerësia 53m, thellësia 1.5m. Ngjyra e ujit shkon prej të kaltrëtes deri në të gjelbërt.

Territori përmban tërësinë tejet të rëndësishme peisazhore të cilën e karakterizojnë një sërë lokalitetesh me bukuri dhe atrakcione të shumëta natyrore duke përfshirë (luginat, lumenjt, ujvaret, shkëmbinjët shkrepër, thellimet e akullnajave, etj). Në disa pjesë të malit, përkatesisht në pjesët me të ulët ulëta të parkut – në regjionin e Sredskës dhe Siriniqit, peisazhi e përbëhet nga kulturat bujqësore. Tërësi më atraktive parqesin pjesët me pyje, barë, livadhet, kullosat dhe formacionet e tejra barishtore, të cilat përfshijnë sipërfaqet në mes lartësive nga 999 dhe 500 m. Formacionet e pyjeve (të ahut, arnenit, molikës, bredhit, hormoqit, etj) ndërrohen me formacionet e barishtoreve duke u paraqitur në të gjitha nuancat e ngjyrës së gjelbërt që shkaktajnë përjetim të bukur bukuri së natyrore. Relievi është krijuar me prerjen e një sërë luginave të lumenjve dhe përrockave në formë të kanioneve dhe grykave me ujvaret e numërta dhe liqenet e shumtë e plotëson përjetimin e plotë të kësaj natyre autentike të bukur dhe të paprekur. Pjesët e ulta të Sharrit, gjatë verës në livadhe lulëzojnë lulet malore me ngjyra të ndryshme duke i dhënë peisazhit atraksion dhe bukuri të jashtëzakonshme e hapësirës aromë dhe freski të posaçme të natyrës së pastër. Përjetim të jashtëzakonshëm vizuel të bukuri së natyrore Mali Sharr ofron në stinën e vjeshtës – në kohën e krijimit të peisazhit kalues malor kur i tërë territori mbulohet me të gjitha ngjyrat e spektrit, si dhe në pranverën e vonshme kur në viset e ulta harliset vegjetacioni bimor duke e mbuluar tërë territorin në gjelbërim, ndërsa majat e larta të Lubotenit, Bistrës dhe maleve tjera edhe më tutje janë nën mbulesën e bardhë të borës. Te cilat paraqesin atraksion të vertetë turistik.

Vegjetacioni

Territori i Parkut Nacional “Mali Sharr” dallohet me begati të florës dhe me shumë breza vegjetativ, të cilët janë në pajtim me ndërrimin e

lartësive mbidetare, me begati në bashkësi të rralla endemike të pyjeve dhe livadheve



Vegjitacioni ne malin e Sharrit

Fauna

Mali i Sharrit është i pasur me shtazë të ndryshme. Janë të përhapuar lloje të veçanta të shtazëve, dhe i përkasin llojeve endemike. Fauna e Sharrit dhe në përgjithësi fauna e Kosovës e cila nuk është hulumtuar terësisht, të dhënat nga literatura rezultojnë se fauna e Sharrit përbëhet nga: 7 lloje Peshq, 9 lloje amfibe, 10 lloje reptilë, 154 lloje shpendë dhe 30 lloje gjitarë.



lli (Lynx lynx)

Rrëqebu

Shpendët (Aves) – Shpendët e Sharrit paraqiten në të gjitha biotopet, ndërsa numri i llojeve dhe populacioneve të tyre i tejkalon të gjitha klasat e tjera të faunës me përjashtim të insekteve, të cilat janë me numër më të madhë. Shpezët kanë përhapje të gjerë prandaj mund të hasen në të gjitha anët territorit të Malit të Sharrit .



Gypaetus barbatus (shqiponja - Orli)

Ekonomia turistike – Në Malin e Sharrit ngërthen në vete të gjithë veprimtarinë që është në funksion të zhvillimit të turizmit në zonën e malit Sharr. Duhet dhënë prioritet ndërtimit të shtigjeve të skijimit, teleferikëve, objekteve hoteliere, objekteve të banimit, infrastrukturës dhe të gjitha aktivitetet sportive në sitnën e dimërit dhe në stinën e nxehtë të vitit. Mandj pushimet, pikniqet, alpinizmi, gjuetia, peshkimi dhe të gjitha veprimtaritë të cilat paraqesin atraksion të vertetë⁴⁰. Turizmi me aktivitetet - rekreative është njëri ndër funksionet themelore në “Malin Sharr” zhvillohen aktivitete të llojllojshme turistike - rekreative, ndër të cilat më të rëndësishme janë turizmi stacionar piknik dhe transit⁴¹. Turizmi stacionar për territorin e parkut nacional të Malit Sharr është më i rëndësishmi duke marrë parasysh karakteristikat e tij në sezonën dimërore dhe verore.

⁴⁰ Dr.sc.Fetah Recica & Mr.sc. Bedri Millaku / Ekonomia e Turizmit, Prishtine 2011.

⁴¹ Departamenti i Turizmit në MTI-Prishtinë.

Shfrytëzimi i hapësirës së vikend zonave - Malit Sharr para vitit 1999 e edhe sot është i shprehur ndërtimi i shtëpive për pushim - vikend shtëpizave (270 sosh). Marrëdhëniet ende të pazgjidhura pronësore ndikojnë në stagnimin e vendit të vetëm turistik serioz në Kosovë. Edhe pse potenciali është në dispozicion. Do të ishte me rëndësi modernizmi i hoteleve sipas standardeve, gjithashtu të teleferikëve, dhe objekteve të tjera përcjellëse në mënyrë që turistët të kenë me sporte të ndryshme dimërore, për dallim nga kohërat e mëparshme kur ka qenë e vizituar nga mijëra turistë nga ish Jugosllavia dhe më gjerë.



Vikend zona e Prevalles

Perfundimi

Turizmi Paraqet një nga veprimtaritë më komplekse të shoqërisë së sotme moderne. Në vendet e zhvilluara paraqet karakterin multidiciplinar të shumë veprimtarive si: ekonomia, politika, kultura dhe të gjitha veprimtaritë jetësore. Në këtë pjesë ka potenciale në dispozicion për zhvillimin e turizmit siq janë: turizmi dimëror, turizmi veror, turizmi malor rural, turizmi i gjetisë dhe peshkimit, turizmi shëndetësor, turizmi alpinist, aktivitetet në natyrë, ekskursionet turistike.

Territori i malit të Sharrit me pozitën e tij dhe potencialet në dispozicion, vet fakti tregon se mundësitë për të pranuar turistë janë shumë më të mëdha se sa ofertat reale, çka do të thotë që planifikimi duhet të kuptohet si proces në perspektivë. Malin e Sharrit me të drejtë e quajmë regjion turistik i Sharrit. Regjioni në fjalë përbenë potencialin më atraktiv turistik në Kosovë. Vlera e veqanta paraqesin: shtigjet e skijimit, rënia e

=====

terenit, ekspozicioni i relievit, bukuritë natyrore, gjelbrimi, ajri i pastër, ushqimi ekologjik me qumshtin dhe prodhimet e tij të shëndetshme dhe ekologjike. Në këtë zonë është ndërtuar qendra e Brezovices. Qendra e skijimit “Brezovica” është 12km larg fshatit me po të njëjtin emër në komunën e Shterpcës. Qendra e skijimit në Brezovicë shtrihet në një territor prej 2 500ha, në lartësinë prej 1718 deri në 2522 metra mbi nivelin e detit. Shtigjet e rregulluara për skijim në Brezovicë janë 40 kilometra. Shtigje të lakuara sipas kërkesave dhe disa prej të cilave janë të gjata deri në 5 kilometra. Statistika e lakueshmërisë mesatare të këtyre shtigjeve është 38%, gjë që entuziazmon edhe më profesionistët e skijimit.

Literatura

1. Dr.sc.Fetah Recica & Mr.sc. Bedri Millaku / Ekonomia e Turizmit, Prishtinë 2011.
2. A/ OECD (ACAU- Atelier Cooperatif d’Architecture et d’Urbanisme) Geneve,më 1968:
3. “Analiza e mundësive dhe problemeve të zhvillimit të turizmit dimëror-sportiv”
4. Dr.I.L Aeschliman-“Analiza e tregut të huaj turistik të turizmit dimëror-sportiv në Jugosllavi”
5. B. Millaku – Shqyrtime Teorike operative dhe analitike të turizmit funksionet në segmentin balnear të banjave, banja e Pejës Klllokotit dhe ujërat termominerale të Kosovës-Prishtinë 2008.
6. . M. Gashi “Vlerat turistike në Kosovë” Plani regjional hapësinor i KSAK Prishtinë 1969.
- 7 .M. Gashi : “Uslovi i mognosti za razvoj turizma SAP Kosovu, Prishtinë 1977.
8. M. Gashi : “Osnovni potencial turističkih vrednosti Kosova”,ekspertiza izrađena za potrebe i rade regionalnog prostornog plana Kosova, Priština 1969.
9. I.B.T. Trbovlje, “Programi i zhvillimit të turizmit dimërorsportiv në Kosovë”,botimi (1972).
10. “Programi i zhvillimit të turizmit në masivin e Sharrit”;
11. “Plani detal urbanistik i Brezovicës” ;
12. “Raport vrojtimi mbi gjendjen dhe problemet e zhvillimit të turizmit në Kosovë”,nëntor 1999,
13. “Vlerësimi i mundësive për investime në hotelerinë e Kosovës (rezime)”,nëntor 2000,
14. “Informatë e shkurtër mbi resurset turistike të Kosovës, gjendjen aktuale të ekonomisë turistike të Kosovës dhe propozimi i listës prioritare për ndërtimin e objekteve hoteliere në Kosovë”, korrik 2001,

- =====
15. I.A. gjeomorfologjia e pjesës së malit Sharr të vënë nën mbrojtjen e natyrës, dorëshkrim,
 16. Dr. Riza I. Çavolli, Gjeografia regjionale e Kosovës, Prishtinë 1997.
 17. “Gjendja dhe problemet e zhvillimit të turizmit në Kosovë”,prill 2002.
 18. “Analiza e shkaqeve dhe tendencave të pavoritshme në zhvillimin e turizmit në Kosovë në periudhën e pasluftës”, janar 2003.C/. Enti i Statistikës i Kosovës:
 19. Vjetarët statistikorë 1969 – 1989;
 - 20.Pasqyrë statistikore mbi bizneset në Kosovë, nëtor 2002.D/. Zyra e Regjistrimit të bizneseve pranë MTI-së, qershor 2004;
 - 21.Sherifi, Y., Mustafa,B. (2002):Disa veçori të faunës së Malit Sharr,Studime Gjeografike, Nr. 14. Akademia e shkencave dhe Arteve të Shqipërisë;
 22. EKMN (1982): Arsyeshmëria shoqërore e shpalljes së pjesës së Malit Sharr në Kosovë për Park Nacional,Prishtinë.

KUD 65 (496.51)

**KARTA EVROPIANE E NDËRMARRJEVE TË VOGLA; FILLIMI
ME I SHPEJT DHE ME I LIRË AKTIVITETEVE TË VENDEVE TË
BALLKANIT PËRNDIMOR-KOSOVË**

*MSc.Behrije Ramaj
behrije_ramaj@hotmail.com*

Abstrakt

Me këtë punim synojmë të analizojmë rolin e Kartës Evropiane për ndërmarrjet e vogla në fushën e ndërmarrësi dhe ngritjen e cilësisë në përcaktimin dhe definimin e raportit të indeksit së politikave së SME-ve. Ndërmarrjet e vogla janë shtylla kurrizore e ekonomisë Evropiane. Ato janë burimi kryesor i vendeve të punës dhe një terren ushqyes për idetë e biznesit. Ndërmarrjet e vogla duhet të konsiderohen si shtytësit kryesor për novacion , punësim si dhe integrim social dhe lokal në Evropë. Ky punim pretendon të ndikojë në kuptimin dhe rëndësinë e raportit të indeksit së politikave të NVM-ve, politika që janë pjesë e Kartës Evropiane për Ndërmarrje , dhe çdo vend anëtarë i kësaj karte duhet ti aplikoj këto politika. Karta Evropiane e Ndërmarrjeve të Vogla(KENV) është sjellë nga liderët e Bashkimit Evropian në Këshillin e Evropës prej 19 – 20qershor 2000.Karta Evropiane e Ndërmarrjeve të Vogla përfaqëson dokumentin themelor të politikave të Komisionit Evropian për vendet anëtare dhe për vendet tona që ndodhen në procesin e Stabilizim-Asocimit, është një instrument strategjik i cili aplikohet në të gjithë vendet e Ballkanit Perëndimor si një metodë planifikimi për vitet e ardhshme që këto vende të arrijnë standardet Evropiane në gjithë linjat e veprimt të Kartës. Kjo Kartë konsiderohet si dokumenti themelor në politikën e Komisionit Evropian për ndërmarrjet e vogla.

Fjalët kyçe: Regjistrimi i kompanisë, fillimi i aktivitetëve, njoftim ,pajtushmeri, Karta Evropiane e ndërmarrjeve të vogla.

JEL klasifikimi: L , L26, P31, P27, O57, N90,

1.Hyrja

Ndërmarrjet e vogla janë shtylla kurrizore e ekonomisë Evropiane. Ato janë burimi kryesor i vendeve të punës dhe një terren ushqyes për idetë e biznesit. Përpjekjet e Evropës për të hyrë në ekonominë e re do të kenë sukses vetëm nëse biznesi i vogël do të vendoset në krye të

=====

agjendës. Ndërmarrjet e vogla janë më të ndjeshmet ndaj të gjitha ndryshimeve në mjedisin e biznesit. Ato janë të parat që vuajnë nëse ngarkohen me burokraci të tepërt. Dhe janë të parat që lulëzojnë nga iniciativat e prerjes së shiritave të kuq dhe shpërblimeve të suksesit.

Në Lisbonë ne vendosëm synimin që Bashkimi Evropian të bëhet ekonomia më konkurruese dhe më dinamike në botë, e bazuar në diturinë, e aftë për rritje ekonomike të qëndrueshme, vende pune më të shumta dhe më të mira dhe kohezion më të madhe social. Ndërmarrjet e vogla duhet të konsiderohen si shtytësit kryesorë për novacion, punësim si dhe integrim social dhe lokal në Evropë. Si pasojë, është e nevojshme që të krijohet mjedisi më i mirë i mundshëm për biznesin e vogël dhe sipërmarrjen.

Për nxitjen e kësaj, ne: Njohim kapacitetet dinamike të ndërmarrjeve të vogla për t'iu përgjigjur nevojave të tregut të ri dhe për të ofruar vende pune; Potencojmë rëndësinë e ndërmarrjeve të vogla në ushqyerjen e zhvillimit shoqëror dhe rajonal, duke qenë në të njëjtën kohë shembuj për iniciativën dhe përkushtimin; Njohim sipërmarrjen si një aftësi jetësore të çmuar dhe produktive, në të gjitha nivelet e përgjegjësisë; i duartrokasim ndërmarrjes së suksesshme, e cila meriton të shpërblehet në mënyrë të drejtë;

Konsiderojmë se ndonjë dështim është bashkëshoqërues me iniciativën e përgjegjshme dhe marrjen përsipër të rrezikut dhe se kjo duhet të shihet kryesisht si një mundësi për të mësuar. Njohim vlerat e diturisë, të përkushtimit dhe të fleksibilitetit në ekonominë e re. Situata e biznesit të vogël në Bashkimin Evropian mund të përmirësohet me veprime që nxisin sipërmarrjen, vlerësojnë masat ekzistuese, dhe kur është e nevojshme, i bëjnë ato të favorshme për biznesin e vogël dhe sigurojnë që politikë bërësit t'i marrin parasysh në mënyrën e duhur nevojat e biznesit të vogël.

2. Roli dhe analiza e dimensionit për fillim me të lehtë dhe me të lirë

Vlerësimet për kuadrin në dimensionin e 2-të nuk ka ndryshuar dukshëm nga ai i cili është adoptuar në 2007. Raporti i Kartës, ka lejuar një krahasim të konsiderueshme në mes të dy periudhave.

Një kompani fillestare mund të ndahet në tri faza:

- Faza e parë përfshin regjistrimin e kompanisë (apo korporatizimit, në rastet kur procesi i çon në krijimin e një entiteti të ri juridik). Akti i regjistrimit është lëshuar nga një gjykatë ose agjenci të specializuara për regjistrimi e kompanisë.
- Faza e dytë përfshin fillimin e aktiviteti për ngritjen e një kompanie të re dhe të ndryshme me administratë dhe degët e tyre qendrore dhe publike- lokale (p.sh takson administrative , për punësimin dhe

agjencive, administrimin e doganave dhe zyrat e statistikave) që merren me sektorin e biznesit.

- Faza e tretë përfshin të gjitha procedurat e nevojshme për të siguruar pajtushmërinë e vendit me kornizë legjislative dhe rregulluese. Kur këto procedurat janë përfunduar, licencat dhe lejet janë lëshuar.

Fig. Vlerësimi për kuadrin dimensionali

Regjistrimi i Kompanive	Njoftimi	Pajtueshmëria
-numri i ditëve për të marrë certifikatat për regjistrimin e kompanive -numri i hapave që duhet marrë certifikata për regjistrimin e kompanive -kostoja zyrtare e marrjes së certifikatës për regjistrimin e kompanive	- Administrative numrat e identifikimit - Numri i ditëve për marrë identifikimin e nevojshëm	-numri i ditëve të plota të procesit të përgjithshëm -numri i hapave të plotë të procesit të përgjithshëm -zbatimi i heshtjes- është miratuar në rregull -kostoja totale e procesit të përgjithshëm -kërkesat e kapitalit minimal -regjistrimi online

Ashtu si në raportin e Kartës në vitin 2007, vlerësimi për Fazën 1 regjistrimi (kompanive) dhe Fazën 2 (njoftimi), është kryer duke përdorur një sërë të dhënave të siguruar nga qeveritë e Ballkanit perëndimor, të përshtatur në vlerësim të pavarur.

Të dhënat për procesin e përgjithshëm të ngritjes të një biznesi janë marrë nga raporti i biznesit 2009 IFC Banka Botërore.

1. Mospërputhje në mes të dhënave të përfshira në grupin e treguesve analitik për fazën 1 dhe fazën 2, koha e përgjithshme e treguesit e koston me kusht, tregojnë ndikimin e lojtarëve privat apo publik të tilla si noterët, avokatet, autoritetet komunale dhe agjencitë tjera qeveritare se sa ato që janë përfshirë direkt.
2. Dy faktorët e mëparshme veçanërisht të rëndësishëm të marrjes është ndikimi i marrjes së licencave dhe lejeve nga administrata qendrore ose lokale.

Kroacia, Maqedonia, dhe Kosova kanë futur procesin e thjeshtuar fillestar për vepra artizanale, ndërsa procedurat e njoftimit të aplikimit për regjistrimin e kompanive është e njëjtë për të gjitha kategoritë e ndërmarrjeve. Krijimi i një regjistri elektronik për kompani rregullisht duhet përditësuar dhe mirëmbahet siç duhet, mund të kontribuojnë ndjeshëm për mbledhjen e besueshme të statistikave të biznesit, shkëmbimin e informacionit midis agjencive qeveritare dhe shpërndarjen e informacionit për biznes.

=====

Ajo gjithashtu mund të hapë rrugën për integrimin e rrjetit evropian në informacionin e biznesit. Shumica e vendeve të Ballkanit përëndimor janë angazhuar në mënyrë aktive për të krijuar regjistra elektronik të kompanive që të mund të arrihet përfundimisht sistemi online. Edhe pse ende nuk e kanë përpunuar treguesit specifik dhe vlerësuar përparimin e kësaj , kjo mund të bëhet në kuadrin e mundur në vazhdimin e procesit.

3. Procesi i regjistrimit të kompanis

Në raportin e kartës 2007 ne kemi ndarë vendet e Ballkanit përëndimor në dy grupe në bazë të pozicionit të tyre në regjistrimin e kompanive dhe procesit të reformës. I pari grup përfshin vendet që deri në fund të 2006 tashmë kishin kryer një reformë të përgjithshme të procesit të kompanive. Pjesë e regjistrimit janë Kroacia, Maqedonia , Kosova, Mali i Zi dhe Serbia janë pjesë e këtij grupi. Grupi i dytë përbëhet nga Bosnja dhe Hercegovina dhe Shqipëria vend që në atë kohë janë në faza të ndryshme të regjistrimit të kompanive dhe planifikimit të reformave .

Bosnja dhe Hercegovina tashme kishte përpunuar një planë për reforma me mbështetjen e donatorëve të konsiderueshme dhe ajo kishte filluar për ndryshimin e legjislacionit përkatës, ndërsa Shqipëria ishte në një fazë të planifikimit të hershme dhe ende është debatuar çfarë lloj të kuadrit institucional duhet miratuar (nëse për të lenë regjistrimin e kompanive në sferën e gjykatave gjyqësore ose te krijojnë një kompani të specializuar agjensit për regjistrim). Dy vjet më vonë Shqipëria ka përfunduar zbatimin e një reforme radikale të sistemit të saj në regjistrim dhe tani është në krye të grupit të parë (shif tabelën 1). Ne mund të vëzhgojmë një përmirësim në kosto dhe efikasitetin e regjistrimit të kompanive, me e thellë është të vendet që i përkasin grupit të parë, më shumë i rëndësishëm është përdorimi në Maqedoni në sajë të zbatimit të ligjit 2006 për sistemin one-stop-shop për mirëmbajtjen e regjistrimit të tregtisë dhe regjistrin e entitet.

Kroacia gjithashtu ka sistem tjetër ligjor me një ndalesë të operuar nga hirta e shërbimit të vendit të administratës publike në bashkëpunim me agjensin financiare kombëtare Kroate dhe FINA. Megjithatë reformat e regjistrimit të kompanive në Bosnje dhe Hercegovinë qëndron i bllokuar. Ligji , legjislacioni për kompani të re (duke bërë thirrje për marrjen e një certifikate të regjistrimit të një kompani të jetë brenda pesë ditëve), është miratuar harmonizimi i procedurave të legjislacionit të kompanive në nivel të njësisë u miratua në 2004 në nivel shtetëror dhe legjislacioni ka kaluar në nivel të njësisë në përputhje me legjislacionin e shtetit, por sistemi i ri ende nuk është operacional.

Çdo pjesë për këtë arsye ka një të veçantë në regjistrimin e biznesit duke përdorur procedura të ndryshme dhe aplikimin e programeve të

ndryshme për të lehtësuar .Dizajnimi i sistemit të shkëmbimit të informacionit midis gjykatave të regjistrimit në nivelin e njësive dhe krijimin e një regjistri kombëtar virtual nuk është instaluar .

Tabela 2. Procesi i regjistrimit të kompanive

Tabela 2.		ALB	BIH	HRV	XK	MK	MNE	SRB
Numri i ditëve për të marr certifikatën për regjistrimin e kompanive	2007	8	10	2-7	1	2-5	4	5
	2009	1	<15	<5	1	1	<4	<5
Nr i hapave për të marr certifikatën për regjistrimin e kompanive	2007	7	6	1	3	1	1	2
	2009	1	5-7	1	3	1	1	2
Shpenzimet zyrtare të të certifikatave	2007	EUR 140	Peraf EUR 600	EUR 450	EUR 22	EUR	sigurimit	
		50-150 EUR	EUR 15	EUR 50-100				
për regjistrimin e kompanive	2009	EUR 1	EUR 150-750	> EUR 350	EUR 5-20			
			Përaf.EUR 57	EUR 11	Përaf EUR 6			

4.Procesi i fillimit te aktivitetit

Gjatë dy viteve të fundit ,përparimi në njoftim ka qenë më pak i shënuar se sa në regjistrimin e kompanive. Numri i procedurave të njoftimit të kërkuar(që rezulton në çeshtjen e numrave të ndryshme identifikues dhe autoritete administrative), dhe kohëzgjatja e procesit ka mbetur kryesisht e pandryshuar në vendet e Ballkanit Perëndimor. Kosova ka prezantuar në procedurë të thjeshtuar për regjistrimin e artizanaleve, duke përfshirë dorëzimin e certifikatës së regjistrimit të biznesit brenda një ditë për një tarifë prej 9 euro. Megjithat si konkluzion për krijimin e QKR, Shqipëria(e cila tashme kishte miratuar një numër të vetëm identifikimi) ,ka qenë në gjendje të shkurtimit të procesit të njoftimit për një ditë. Ngjashëm Maqedonia pas futjes të sistemit me një ndalesë ka gjithashtu procesin e efektshëm e lëshimit të numrave të regjistrimit. Tani kërkohen numrat (numri i regjistrimit të kompanive dhe zyra e numrave të taksave), janë lëshuar në të njëjtën kohë nga një sistem stop-shop brenda katër orëve të kërkesës. Kroacia dhe Maqedonia janë duke punuar drejt ne themelimin një numri të vetëm identifikimi.Në Mal të Zi , pesë regjistrime dhe identifikime. Numrat janë ende te nevojshme(p.sh zyrat statistikor, doganat, zyra e punës dhe zyra e tatimeve).Mali i Zi çdo autoritet administrative ka regjistrin e vetë dhe kërkon numrat korrespondues për kompanitë. Kroacia dhe Maqedonia janë dy vend që kanë miratuar regjistrime të ndryshme dhe procedurat e njoftimit për vepra artizanale.Kosova ka prezantuar në procedurë të thjeshtuar për regjistrimin e artizanaleve, duke përfshirë dorëzimin e certifikatës së regjistrimit të biznesit brenda një ditë për një tarifë prej 9 euro.Në Kroaci pronarët e bizneseve zejtare mund të kompletojnë

procedurat e regjistrimit me kontaktin Hiro piket për pesë ditë. Licencat janë konsiderueshëm më të ulëta se tarifat e regjistrimit të kompanisë vlera rreth 65 euro.

Përveç kësaj, disa aktivitete kërkojnë një lejë teknike me një kosto që varion midis 50 deri 150 euro në varësi të aktivitetit. Në Maqedoni regjistrimi artizanal trajtohen nga Dhoma e Mjeshtërisë, duke vepruar si një pikë e vetëm. Gjithë procesi është kompletuar në tetë ditë për tarifë përafërsisht prej 100 euro.

Tabela 3. Procesi i fillimit të aktivitetit në shifra

Tabela 3		ALB	BIH	HRV	XK	MK	MNE	SRB
Numri identifikues administrative	2007	1	3	2	3	3	5	2
	2009	1	2-3	2	3	2	5	2
Numri i ditëve të detyrueshëm për të marrë numrat e identifikimit	2007	5	7 gjykatës për regjistrimin e 15-30 për treginë e jashtme		6-15	2-5	2-5	5 15
	2009	1	15-20	5-15	5-15	1	5-15	15

Tablea 4. Në përgjithësi procesi i themelimit të biznesit në shifra

Tabela 4.		ALB	BIH	HRV	XK	MK	MNE	SRB
Numri i ditëve për të kompletura procesin e përgjithshëm	2007	39	54	45	23	18	24	18
	2009	8	60	40	22	9	21	23
Numri i hapave për të kompletuar procesin e përgjithshëm	2007	11	12	10	5	10	15	10
	2009	6	12	8	12	7	15	11
Kostoja totale e procesit të përgjithshëm (EUR)	2007	429	679	739	N/A	158	182	252
	2009	575	845	930		1 00	99	192 97
Kostoja totale e procesit të përgjithshëm (% e të ardhurave për	2007	22.4	37	12.2	22	7.4	6.6	10.2
	2009	25.8	30.8	11.5	78	3.8	4.4	7.6

5.Përfundimi me Rekomandim

Realizimi i këtij punimi do te ofroje një dokument dhe një bazë e mirë për ndërmarrjet e vogla ,veçanërisht ato që kanë synim zhvillimin e bizneseve të reja në forma të tilla. Do të jete një analize dhe një ndihmë për shumë ndërmarrës që te kenë qasje në analize e një pjesë që i është bërë raportit 2007-2009 të Kartës Evropiane për Ndërmarrje të Vogla.

Një rendësi të veçantë i është dhënë Kosovës, dhe të gjitha të arriturat apo edhe ngecjet e saj në këtë raport. Ndërmarrjet dhe subjektet e tjera ekonomike do të binden për rendësin e zbatimit të këtyre elementeve apo dimensioneve të Kartës Evropiane për Ndërmarrje të vogla dhe lehtësirat që do ti kenë ndërmarrësit. Mjedisi global ekonomik ndikon negativisht në rritjen makroekonomike në Kosovë, eksporti i disa kategorive kryesore pësoi kontraktime të qarta. Ashpër është ngadalësuar rritja ekonomike dhe qojnë likuiditete të thellë të jashtëm dhe mungesat në financime për ekonomin. Përkufizimi i NVM-ve në Kosovë është bazuar në kriteret e njëjtë në aspektin e punonjësve sipas përcaktimit të BE-së, pragu për qarkullimin dhe bilancet ndryshoj në terma absolute për shkak të madhësisë të ekonomisë se Kosovës dhe performancës.

Numri i të punësuarve është kriteri kryesor të punësuar në të dy përkufizimet, mbështetën në qarkullimin dhe shifrat e bilancit të gjendjes .

Hipotezat kryesore janë:

- a. Implementimi i rregullt i politikave te NVM-ve, do te shtojë efikasitetin e ndërmarrjeve
- b. Forcimi i kuadrit institucional dhe ligjor ndikon ne mbështetjen e politikave të NVM-ve
- c. Zbatimi i E-biznesit ndikon pozitivisht në afarizmin ndërmarrjeve

Referencat

1. Koman M, Prasnikar J, Drenkovska, Qorraj, G (2007): Characteristics of Entrepreneurs and self-employed in SEE: evidence from Kosovo and Macedonia; Reconstruction of enterprises and globalization. (Casnik Finance, 385), 2007.
2. Koman M, Prasnikar J, Qorraj, G (2008): The self-employment twist; evidence from Kosovo; Managing innovation in a connected world. Manchester: The International Society for Professional Innovation Management (ISPIM, 25), 2008.
3. Koman M, Prasnikar J, Qorraj, G (2010): The Entrepreneurship in Developing Countries A case of Kosovo; Transformation in Business & Economics, Vol.9,No 3 (21), ISSN 1648-4460. 2010.

4. Qorraj, G, (2010): Integrating the Western Balkans into the European Union: Overcoming Political and Economic Constraints; Journal of European Perspective for Eastern Balkans, October 2010, Vol.2 Number 2, ISSN 1885-7694.
5. Qorraj, G. (2010): Entrepreneurs and Self-Employees: The case of Kosovo; LAP Lambert Academic Publishing, ISBN:978-3-8433-7413-2 Germany, November 2010.
6. Progress in the Implementation of the European Charter for small enterprises in the Eastern Balkans/ sme policy index 2007
7. Progress in the Implementation of the European Charter for small enterprises in the Eastern Balkans/ sme policy index 2009
8. The dimensions listed here are those in Which, on average, the Western Balkan countries and UNMIK/Kosovo scored below 2.5 out of 5.
9. [www..masht-gov.net](http://www.masht-gov.net)

KUD 657.6

FAZAT E PLANIFIKIMIT TË AUDITIMIT TË JASHTËM NË SPECIFIKIMIN E NGRITJES SË CILËSISË SË RAPORTIMIT FINANCIAR

Brikenda Vokshi
brikenda.vokshi@uni-pr.edu

Abstrakt

Procesi i auditimit mund të ndahet në disa faza të auditimit. Secila prej këtyre fazave mund të përmbajë procedura të dizajnuara për një qëllim të caktuar por që mund të sjellin evidencë për qëllime të tjera nga procedura të tilla të auditimit mund të përmbushin qëllime të shumfishta. Paraplanifikimi paraqet njërën ndër fazat kryesore nëpër të cilën kalon procesi i auditimit. Në këtë fazë të auditimit poashtu duhet të jemi të sigurtë se skuadra e cila do t'a kryejë auditimin përbëhet nga anëtarë të skuadrës, të cilët e kanë eksperiencën dhe njohuritë e duhura për sa i takon industrisë në të cilën ndërmarrja e cila do të auditohet vepron. Poashtu e një rëndësie të veçantë është edhe pavarësia e skuadrës audituese, e cila siguron se auditimi do të kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe se do të marrin vendimin adekuat mbi Pasqyrat Financiare dhe të japë një opinion pa rezervë.

Fjalët kyçe: Procesi i auditimit, fazat e auditimit, paraplanifikimi, SNA, pavarësia e auditorit, planifikimi.

JEL kualifikimi: M4 , M42

1. Hyrje

Fazat nëpër të cilat kalon procesi i auditimit janë⁴²:

1. Pranimi dhe Vazhdimi i Punës me Klientin- standardet e auditimit kërkojnë që auditori të themelojë politika dhe procedura për të vendosur nëse duhet të pranojë të punojë më një klient të caktuar apo ta ndërpres dhe të vazhdojë me klientet tjerë të mëparshëm.
2. Themelimi i Kushteve të Angazhimit – auditori duhet të bije dakord me klientin për sa i takon shërbimeve që do të kryhen.
3. Paraplanifikimi – bëhët me qëllim që të realizimit të dy aktiviteteve kryesore, përcaktimin e personave të nevojshëm në

42 Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA), IFAC, 2000

- skuadrën e auditimit dhe që ata do ta kryejnë procesin e auditimit në mënyrë të pavarur;
4. Themelimi i Materialitetit dhe Vlerësimi i Rrezikut – në mënyrë që të planifikohet auditimi në mënyrën e duhur, skuadra e auditimit duhet që fillimisht të gjykojë për materialitetin dhe të bëjë një vlerësim fillestar për sa i takon rrezikut të biznesit të klientit. Të gjykuarit e materialitetit dhe të vlerësuarit e rrezikut përdoren për të përcaktuar objektin e auditimit.
 5. Planifikimi i Auditimit – auditori duhet të pregadisë një plan auditimi që paraqet, në detaje të arsyeshme, natyrën, shtrirjen, dhe kohëzgjatjen e punës së auditimit.
 6. Mbajtja Parasysh e Kontrollleve të Brendshme – kontrollet e brendshme janë procese mbi cilat kanë ndikim bordi i drejtorëve, menaxhmenti, dhe ajo pjesë e personelit i cili ka për detyrë të jap siguri të arsyeshme për sa i takon arritjes së besueshmërisë së raportimit financiar, efektivitetit dhe eficiencës së operacioneve dhe të vepruarit në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi..
 7. Auditimi i Proceseve të Biznesit dhe i Llogarive Përkatëse – duke u bazuar në njohuritë mbi entitetin dhe mjedisin ku ai vepron, auditori përcakton procedurat e nevojshme për të reduktuar rrezikun e anomalive materiale deri në një nivel të ultë, për sa i takon zërave të pasqyrave financiare e që influencohen nga procese të veçanta të biznesit.
 8. Përfundimi ose Kryerja e Auditimit – kur auditori përfundon së testuari salldot e llogarive, mbetet për tu vlerësuar mjaftueshmëria e evidencave për të arritur deri tek një përfundim adekuat dhe
 9. Dhënia e Raportit të Auditorit – paraqet fazën finale e një procesi auditimi. Nëse auditori ka mbledhur evidencë të mjaftueshme dhe të besueshme, ka vepruar në përputhje me standardet e auditimit dhe pasqyrat financiare janë në përputhje me standardet e kontabilitetit, ai do të jap një opinoin pa rezervë.

2. PARAPLANIFIKIMI I PROCESIT TË AUDITIMIT

Paraplanifikimi paraqet një rën ndër fazat kryesore nëpër të cilën kalon procesi i auditimit, dhe në përgjithësi përbëhet kryesisht nga aktivitetet kryesore:

- a) Përcaktimi i personave të nevojshëm që do të jenë anëtar të skuadrës që do t'a kryejë auditimin;

b) Të sigurohet se kompania e auditimit dhe skuadra që do të kryejë auditimin të jenë të pavarur.

Planifikimi i auditimeve dhe i hartimit të Programit të Auditimit janë proceset më kritike për të siguruar një standard të lartë auditimi në një ent/subjekt. Një plan i mirë auditimi do të sigurojë një përqendrim më të mirë në punën në terren nga grupi i auditimit.

Përpara se audituesit të fillojnë auditimin e entitetit duhet të kenë kujdes në:

- mbledhjen e informacionit;
- të kuptojnë entitetin;
- vlerësimin e riskut;
- përcaktimin e kriterëve të auditimit.

Një grup i suksesshëm auditimi duhet të ketë karakteristikat e mëposhtme:

- njohuritë, aftësitë, eksperiencën dhe ekspertizën e nevojshme për të mbyllur një auditim të suksesshëm;
- i pavarur dhe objektiv;
- një përkushtim për zbatimin e planit të auditimit në mënyrë efikase dhe efektive.

3. PLANIFIKIMI I AUDITIMIT

Planifikimi i auditimit përfshin zhvillimin e strategjisë së përgjithshme dhe qasje më të hollësishme sa i përket karakterit, kohëzgjatjes dhe shtrirjes së auditimit. Një proces i planifikimit të auditimit mund të zgjasë varësisht nga madhësia e biznesit të klientit, ndërlikueshmëria e auditimit, përvoja e auditorit me klientin dhe njohja me vetë biznesin e klientit.

Në planifikimin e një auditimi, grupi i auditimit duhet të:⁴³

- identifikojë aspektet kryesore të mjedisit në të cilën operon subjekti;
- vazhdojë të kuptojë më mirë marrëdhëniet, procedurat dhe besueshmërinë e subjektit;
- identifikojë drejtuesit e subjektit dhe të përfundojë vlerësim paraprak të studimit se cilat janë pikat e forta dhe të dobëta të subjektit;
- rishikojë raportet e auditëve të brendshme dhe manualin e procedurave të punës së subjektit;

43 Carcello, J, and T.L. Neal, 2003. Audit committee characteristics and auditor dismissal following "new" going concern reports the Accounting Review, faqe 369

=====

- vlerësojë besueshmërinë e raporteve që janë kryer nga auditimi i brendshëm;
- sigurojë dokumentet e përshtatshme që nevojiten për hartimin e programit të auditimit.

Një planifikim i mirë i auditimit është shumë i rëndësishëm për t'u siguruar që auditimi të kryhet në mënyrë efikase dhe eficiente. Efienca përcakton se sa mirë një organizatë përdor burimet e veta për të prodhuar të mira dhe shërbime.⁴⁴ Pra, efienca përqendrohet tek marrëdhënia midis produkteve të përfituara në terma të mallrave, shërbimeve ose të mirave të tjera (outputet) në raport me burimet e përdorura për t'i përfituar ato (inputet). Efektiviteti lidhet kryesisht me konceptin mbi arritjen e qëllimit. Efektiviteti është përfundimi i outputeve dhe raporti i impaktit të synuar dhe atij të realizuar. Është marrëdhënia midis qëllimit ose objektivave me outputet dhe ndikimin që kanë sjellë outputet e arritura.⁴⁵

Gjatë zhvillimit të një plani auditimi auditori kryesisht merret me:

1. Procedurat që ndërmerren për të kuptuar entitetin, dhe
2. Rezultatet e procesit të vlerësimit të rrezikut.

Qëllimi i planifikimit është që të cakton llojet dhe vëllimin e fakteve të nevojshme që auditori të bindet se në pasqyrat financiare nuk ekzistjnë anomali materiale⁴⁶.

Procedurat e planifikimit janë:

1. Mbledhja e informative për kushtet e afarizmit të ndërmarrjes, si dhe degës në të cilën ndërmarrja vepron,
2. Kryerja e procedurave analitike fillestare,
3. Kryerja e procedurave me qëllim të fitimit të njohurive për kontrollin e brendshëm,
4. Caktimi i rëndësisë (të planifikimit),
5. Vlerësimi i rreziqeve, dhe
6. Përpilimi i programit të auditimit.

Si pjesë e procesit të planifikimit, auditori mund të kryejë procedurat analitike siq janë koeficientët financiar për të identifikuar ato transaksione specifike ose saldo të llogarive të cilat meritojnë një kujdes me të veçantë ngase mund të përmbajnë anomali.

4. MATERIALITETI I AUDITMIT

Materialiteti, rreziku i auditimit dhe evidencat paraqesin konceptet kryesore gjatë kryerjes së një procesi auditimi që rezultojnë me shprehjen e

44 Gjon Ndreja, Kontrolli dhe Auditimi i Brendshëm, ITAP – Shqipëri, Prill 2007, faqe 87

45 Po aty, faqe 87

46 Dr. L. Zager, B. Tusek Revizija, Zagreb, 2007, faqe 103

opinionit nga auditori i jashtëm për pasqyrat financiare të një entiteti të auditimit⁴⁷.

Materialiteti kufizohet si madhësia e elementit ose e gabimit, e cila e gjykuar në rrethana të veqanta të mungesës ose anomalisë së tij mund të influencojë ose ndryshojë vendimet ekonomike të marra nga ana e përdoruesve racionalë, duke u bazuar mbi pasqyrat financiare⁴⁸.

Materialiteti varet nga masa (madhësia) e gabimit e gjykuar në rrethana të veqanta të mosprezentimit apo të prezentimit të gabueshëm të po atij gabimi.

Që të mund të përcaktojë se mosprezentimi apo prezentimi i gabueshëm në vendimmarrjet ekonomike të shfrytëzuesve, auditori duhet të ketë parasysh këto rrethana praktike⁴⁹:

1. Të identifikojë shfrytëzuesit e pritur të pasqyrave financiare;
2. Të identifikojë informacionin në pasqyrat financiare i cili do të jetë më i rëndësishmi për këta shfrytëzues, (si p.sh., shpenzimet totale, pasuritë totale etj.);
3. Të përllogarisë përqindjet më të larta në të cilat shuma e rëndësishme në pasqyrat financiare do të mund të keqdeklaroheshin pa ndikuar në mënyrë të konsiderueshme në vendimet e shfrytëzuesve;
4. Të shumëzojë përqindjen nga hapi 3 me shumën (shumat) bazë nga hapi 2;
5. Të përzgjedhë shumën më të ultë nga hapi 4. Kjo paraqet shumën e materialitetit që nënkupton se qfarëdo gabimesh që tejkalojnë këtë vlerë janë materiale.

Auditori gjatë bisedave paraprake duhet të identifikojë shfrytëzuesit e mundshëm të pasqyrave financiare. Marrim një shembull: nëse qëllimi i auditimit është për të marrë hua nga banka, mund të supozohet që banka pra është shfrytëzuesi primar i pasqyrave financiare. Interesimi i bankës është kryesisht aspekti financiar si: mjetet qarkulluese, detyrimet afatshkurëtra, vlera totale e mjeteve, vlera totale e detyrimeve dhe ekuitetit së bashku me koeficientët financiar.

Në pregaditjen e planit për auditim auditori duhet të përcaktojë nivelin e materialitetit lidhur me pasqyrat financiare në përgjithësi si dhe llogaritë individuale, transaksionet apo sqarimet. Përcaktimi i materialitetit është qështje e gjykimit profesional ngase nuk ka standard për përcaktimin e nivelit të tij.

47 Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, (ISA), IFAC, 2000, faqe 75

48 Abbott, L.J., Y.Parker.2000. The effects of audit Committee activity and independence on corporate fraud, *Mangerial Finance* 26, faqe 59

49 Manuali i auditimit të Performancës, Tiranë, 2007, faqe 98

=====

Firmat audituese shfrytëzojnë udhëzues të përgjithshëm për përcaktimin e pikënisjes së materialitetit për gabimet si tërësi brenda pasqyrave financiare siq janë: **përqindja e shpenzimeve totale, përqindja e normalizuar e të ardhurave para tatimit, përqindja e të hyrave totale, përqindja e kapitalit (ekuitetit) dhe përqindja e pasurive.**

Ne zakonisht mund ta përzgjedhim shumën më të ultë që rezulton nga secila vlerë e mundshme e materialitetit, dhe përdorim atë shumë për auditimin e pasqyrave financiare si tërësi. Kjo është një arsye që gabimet shpeshherë ndikojnë në më shumë se një komponentë.

P.sh., një gabim me paratë e gatshme mundet poashtu të paraqesë një gabim në shpenzimet. Si rezultat auditori nuk duhet ta merr shumën me të madhe të materialitetit për ta audituar paranë e gatshme se sa që e merr për auditimin e shpenzimeve.

Shembull: Ne e zgjedhim një nivel të materialitetit 450 000 euro për entitetin X. Auditori mendon se kontrollet e brendshme janë goxha të mira dhe prët shkallë të ultë gabimi, prandaj ai përllogaritë gabimin në pasqyrat financiare në shumën 45 000 euro (10% të shumës së materialitetit). Ne mendojmë që gabimet ndryshojnë shumë pak për qdo vit prandaj llogarisim precizitetin si të barabartë me 90% të ndryshimit në mes të 450 000 euro (niveli i materialitetit) dhe 45 000 euro (gabimi i përllogaritur) $450\,000 \times 0.9$ jep një vlerë për precizitetin prej 364 500 euro.

Auditori duhet të ketë parasysh materialitetin gjatë natyrës, kohëzgjatjes dhe shtrirjes së auditimit. Për të ardhur deri këtu auditori i jashtëm e përcakton nivelin e materialitetit në nivel të pasqyrave financiare, e me pastaj e shpërndanë atë në llogaritë dhe klasët e transaksionet. Kjo shpërndarje i ndihmon në përcaktimin e natyrës, kohëzgjatjes dhe shtrirjes së auditimit.

Kjo i ndihmon auditorit të vendos:

- Se çfarë procedurave të aplikojë;
- Kohën e aplikimit të procedurave, dhe
- Sa kohë nevojitet.

4. PËRFUNDIMI

Raporti i auditimit identifikon pasqyrat financiare dhe periudhat fiskale të mbuluara nga auditimi. Një auditim standard do t'i mbulojë të gjitha pasqyrat financiare: pasqyrën e të ardhurave, bilancin e gjendjes, pasqyrën e rrjedhjes së parasë dhe pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet. Raporti poashtu përshkruan përgjegjësitë e auditorëve dhe të menaxhmentit. Menaxhmenti është përgjegjës për pregaditjen e pasqyrave financiare. Ndërsa auditorët janë përgjegjës për përdorimin në mënyrë kompetentë të

teknologjive në dispozicion për të konfirmuar hyrjet e menaxhmentit të bëra në pasqyrat financiare.

Raporti i auditorit përmbledhë tërë procesin e auditimit. Standardet e auditimit përfshijnë procedurat e përdorura në kryerjen e një auditimi për të ndihmuar auditorët në formimin e një mendim mbi ndershmërinë e pasqyrave financiare.

Auditimi si një process sistematik i vlerësimit të pasqyrave financiare të entiteteve të cilat auditohen paraqet një siguri se këto pasqyra janë pregaditur drejt dhe paraqesin pamjen e vertetë të entitetit. Kështu që auditimi e rrit saktësinë dhe cilësinë e raporteve financiare. Karakteristikat cilësore janë tiparet kryesore që e përbëjnë informacionin kontabël të paraqitur në pasqyrat financiare të raportuara. Kuptimshmëria dhe dibishmëria konsiderohen si dy nga cilësitë kryesore që e bëjnë informacionin kontabël të dobishëm. E për të qenë i dobishëm, informacioni duhet të jetë në kohë dhe në vlerë parashikuese ose sugjeruese. Poashtu duhet ta paraqesë me besnikëri ngjarjet dhe duhet të jetë i verifikueshëm dhe asnjans. Informacioni mbi një ndërmarrje është më i vlefshëm kur ai mund të krahasohet me informacionin për ndërmarrjet e tjera dhe kur është i pregaditur duke përdorur metoda të caktuara gjatë periudhave kohore.

5. REFERENCAT

1. Grup autorësh, Auditim, Tiranë, 2007.
2. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA), IFAC, 2000.
3. Dr. L. Zager, B. Tusek Revizija, Zagreb, 2007.
4. Abbott, L. J., S. Parker, G. F. Peters. 2001. The effectiveness of blue ribbon recommendations in mitigating financial misstatements: an empirical study. *Auditing Mid-year Conference*. Houston, Texas.
5. Manuali i auditimit të Performancës, Tiranë, 2007.
6. Gjon Ndreja, Kontrolli dhe Auditimi i Brendshëm, ITAP – Shqipëri, Prill 2007

=====

KUD 551.432:338.48 (496.51)

“BJESHKËT E NEMUNA”, POTENCIAL I FUQISHËM PËR ZHVILLIMIN E TURIZMIT MALOR

*Driton Sylqa
driton.sylqa@uni-pr.edu*

Abstrakti

Pozita gjeografike e “Bjeshkëve të Nemuna” me veçoritë e saj specifike e bën të pashmangshme emërtimin e këtij destinacioni si potencial të fuqishëm për zhvillimin e turizmit malor. Ky punim diskuton rëndësinë e planifikimit strategjik për zhvillimin e turizmit malor në vendin tonë, për të paraqitur më pastaj karakteristikat impulsive dhe potencialin e "Bjeshkëve të Nemuna". Një konsideratë e posaçme i është dhënë arsimimit profesional të gjeneratave të reja në sektorin e turizmit. Një vlerësim i përgjithshëm rekapitulon idenë se bashkëpunimi dhe harmonizimi ndërshtetëror rajonal është i domosdoshëm për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të këtij destinacioni turistik.

Fjalët kyçe: Bjeshkët e Nemuna, zhvillimi i qëndrueshëm, turizmi malor, rritja ekonomike

JEL classification: M1, Q01, Q5

Hyrje

Evropa është destinacioni i parë turistik në botë.⁵⁰ Pavarësisht nga kjo, destinacionet e reja turistike janë gjithmonë më konkurruese dhe të afta për të fituar pikë të aksioneve të tregut. Një nga sfidat e industrisë së turizmit sot është përqendrimi më shumë në cilësi sesa në produkt, si një strategji e orientuar drejt klientit që e bën një destinacion turistik më konkurrues.

Për të bërë turizmin të rritet në zonën e Ballkanit, disa nisma duhen të merret urgjentisht.

Para së gjithash është e nevojshme të identifikohen me saktësi aftësitë profesionale dhe aftësitë e nevojshme nga ndërmarrjet turistike dhe nga administrata publike dhe të mundësohen nga ato, nëpërmjet një zinxhiri trajnimi të përhershëm. Ky është një veprim i rëndësishëm për të përmirësuar

50 COM (352) "Evropa, destinacion turistik nr 1 në botë - një strukturë e re politike për turizmin në Europë", European Commission, 2010

=====

cilësinë e shërbimeve dhe për të kënaqur pritjet turistike. Për të arritur këtë është e nevojshme të ndahet pronësia nga menaxhimi, duke siguruar profesionistët e specializuar dhe duke përcaktuar rregulla të sakta të udhëheqjes. Në anën tjetër, zbatimi i politikave fiskale favorizon punësimin e personelit të specializuar në ndërmarrjet turistike. 51

Turizmi i qëndrueshëm ka tendencë të krijoj përshtypjen mbi ruajtjen afatgjatë të ambientin natyral, që kërkon një pjesëmarrje aktive të popullatës lokale dhe të turistëve në akte për ruajtjen dhe edukimin për ruajtjen e biodiversitetit (ripyllëzimi, mbrojtja e faunës dhe florës, rikthimi i shtazëve të kërcënuara, etj).

Një turizëm i qëndrueshëm rajonal i Bjeshkëve të Nemuna kërkon një bashkëveprim të ndërsjellë të shteteve të rajonit. Këto bjeshkë kanë potencial natyror enorm me mundësi të jashtëzakonshme për zhvillimin e shumë degëve të turizmit. Ekzistojnë kushte të përshtatshme jo vetëm klimatike, por edhe fizikogjeografike si komplekset e gjera të pyjeve dhe të livadheve, pasuria hidrografike, bukuritë natyrore etj., ku mund të ndërtohen qendra sportive, rekreacioni, sanatoriume, qendra kurimi dhe qendra për përgatitjen e sportistëve në lartësi diverse mbidetare. Janë të rralla malet që kanë një pasuri aq të madhe me një faunë interesante si Bjeshkët e Nemuna.

Planifikimi i turizmit dhe roli i tij

Planifikimi i turizmit në të gjitha nivelet është çelës për realizimin e zhvillimit të suksesshëm të turizmit dhe menaxhimit të tij. Përvoja e shumë zonave turistike ka dëshmuar se në planin afatgjatë qasja e planifikimit e zhvillimit të turizmit sjellë dobi dhe njëherit eviton problemet e mëdha të mundshme. Planifikimi është i domosdoshëm në mënyrë që turizmi të rivitalizohet dhe të mbaj ekonominë në binarë të duhur zhvillimi në të ardhmen. Turizmi duhet të planifikohet në nivele nacionale dhe regjionale, në rrafsh planifikimi është në lidhje të drejtpërdrejtë me politikën e zhvillimit. Planet strukturore, standardet, faktorët individualë dhe me të gjitha sferat tjera të domosdoshme të zhvillimit turizmit. Në vijim do t'i përmendim favoret e rëndësishme specifike nga planifikimi nacional dhe regjional i turizmit.⁵²

Definimi i qëllimeve dhe politikës zhvillimore të turizmit;

Zhvillimi i turizmit duhet ruajtur resurset kulturore dhe natyrore për gjenaratat e tashme dhe të ardhshme;

Integrimi i turizmit në politikën e tërësishme zhvillimore të vendit dhe regionit;

51 Muhaxheri, Nexhat, *Ekonomika dhe Menaxhmenti në Turizëm*, Dukagjini, Pejë 2006

52 Krasniqi, Armand, Ukaj, Fatos, *Menaxhimi i Organizatave dhe Destinacioneve në Turizem*, Pejë, 2010

=====

Sigurimi i bazave racionale për marrjen e vendimeve të sektorit publik dhe privat lidhur me zhvillimin turistik;

Mundësia e zhvillimit të koordinuar (harmonizar) i të gjithë faktorëve të rëndësishëm për turizëm;

Optimalizimi dhe balansimi i favoreve ekonomike e shoqërore, dobite për ambientin, si dhe distribuimin i këtyre dobive shoqërore me çrast minimizohen problemet aktuale;

Sigurimi i planit fizik strukturor i cili paraqitet si udhërrefyes për lokalitetet, tipin dhe vëllimin e zhvillimin turistik të atraksionit turistik të destinacionit turistik, objektet e shërbimeve, infrastruktura;

Formësimin e udhërrëfyesve dhe standardve për sajimin e palnit të detajizuar specifike për zonat e zhvilluara;

Krijimi i parakushtve për aplikimin efikas të politikës zhvillimore të turizmit dhe menaxhimi duke siguruar kështu kornizat e nevojshme organizative dhe instucionale;

Krijimi i kushteve për kordinimin efikas të sektorit publik dhe privat dhe intensifikimi në zhvillimit turizmit;

Krijimi i bazave për monitoringun permanent të zhvillimin të turizmit.

Pozita gjeografike e “Bjeshkëve të Nemuna”

Ato përbëjnë pjesën periferike Perëndimore të Kosovës dhe zbresin gati vertikalisht si dhe përfundojnë në lindje dhe verilindje në fund të Rrafshit të Dukagjinit dhe në luginë të Ibrit, kurse në perëndim e mbyllin malet (kufiri) me Shqipërinë dhe me Malin e Zi. Duke u ngritur vertikalisht nga Rrafshi i Dukagjinit, masivi i madh i Bjeshkëve të Nemuna ofron pamje madhështore dhe paraqet potencial të madh turistik. Bjeshkët e Nemuna kanë një shtrirje në drejtim veri-jug me gjatësi 40 km, ndërsa gjerësia e tyre është rreth 26 km.

Rajoni i Bjeshkëve të Nemuna është një hapësirë kapitale për zhvillimin e turizmit, si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri dhe në Malin e Zi. I shtrirë në territorin e tri shteteve, qendra kryesore e këtyre bjeshkëve është Peja, pastaj Deçani, Gjakova dhe Istogu. Ndërsa, në Shqipëri është qendra e Bajram Currit dhe pjesa veriore e Shkodrës, si dhe në Malin e Zi, është Rozhaja dhe Plava.⁵³

Gjatësia e kufijve ndërshtetëror të rajonit, përkatësisht gjatësia e kufijve të Kosovës me shtetet fqinje paraqitet në tabelën vijuese⁵⁴:

53 Studim mbi arsyeshmërinë e shpalljes së territorit të Bjeshkëve të Nemuna Park Nacional, Prishtinë, 2003

54 Enti statistikor i Kosoves, 2000 www.esk.rks-gov.net

=====

Shteti fqinj	Gjatësia ne km
Shqipëria	111.80
Mali i Zi	78.60
Maqedonia	158.70
Serbia	351.60
Totali	700.70

Kufijtë e Kosovës-Burimi: Enti Statiskor i Kosovës

2.1 Kapaciteti turistik i “Bjeshkëve të Nemuna”

Bjeshkët e Nemuna janë rajoni potencialisht më i rëndësishëm turistik i Kosovës. Hapësirat natyrore jashtëzakonisht cilësore, mundësitë e mëdha të pranimit të vizitorëve dhe monumentet kulturore-turistike krijojnë mundësi të pakufizuara të zhvillimit turistik. Ndër vlerat më të rëndësishme duhet të theksojmë vetë masivin malor të Bjeshkët e Nemuna dhe të Moknës (si degë e ndarë), fushat dhe kanionet e Drinit të Bardhë, të Bistricës së Pejës dhe të Deçanit, të Erenikut dhe të Mirushës, të liqeneve malore, qytetet si Peja, Deçani dhe Gjakova, Burimet Termale dhe rrjeti i mirë rrugor. Rajoni turistik i Bjeshkëve të Nemuna ka karakter policentrik, si i tillë prandaj edhe do të zhvillohet në të ardhmen. Peja është qendra më e shquar turistike e rajonit, por edhe e gjithë Kosovës dhe edhe më tej do të mbajë këtë vend. Por këtu janë edhe qytetet e tjera të Kosovës, disa të Shqipërisë, si dhe të Malit të Zi.⁵⁵ Disa nga këto qytete, si Peja, Bajram Curri dhe Rozhaja do të mund të ishin pikënisje të vajtjes deri të kapacitetet turistike malore, duke koncentruar të gjithë veprimtaritë përcjellëse të shërbimeve përcjellëse.⁵⁶

Vet rajoni i Bjeshkëve të Nemuna do të shfrytëzohet për organizimin e ofertës së tërësishme turistike me një afarizëm gjatë gjithë vitit. Veç zhvillimit të të gjitha llojeve të sporteve dimërore në lartësi mbi 1.000 m., ofrojnë mundësi ideale për turizmin veror malor (ecja, alpinizmi) si dhe zhvillimi i turizmit shëndetësor.

Rajoni malor turistik i Bjeshkëve të Nemuna është rajon më i madh turistik se rajoni i Sharrit. Prandaj këtu ekzistojnë kushtet për formimin e disa zonave (zona e tashme e Deçanit dhe e Pejës) që do të bashkonin qendrat malore të Rusolisë, Kurvalës, Bogdashit, Kopaonikut, Bjeshkës së Belegut, etj nga Gjeravica në jug, deri të Mokna dhe Hajla në veri. Për nga fizionomia e tyre Bjeshkët e Nemuna mund të klasifikohen në rajonet natyrore potenciale malore turistike që ofrojnë mundësi për formimin e

⁵⁵ Qytetet e 3 shteteve janë jashtë orientimeve të drejtpërdrejta të rrjedhave turistike, por në lidhje të ngushtë me hapësirat kryesore turistike të rajonit.

⁵⁶ Ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinor “Raport sektorial – Turizmi”, 2004

=====

ofertave complete turistike që mbështeten në potencialin e jashtëzakonshëm atraktiv të masivit malor.

Sipas specifikave dhe karakteristikave natyrore, sidomos sipas veçorive të relievit, të shumëllojshmërisë biogeografike të resurseve jashtëzakonisht të pasura ujore, të pasurisë së peizazheve dhe të motiveve të mjedisit, Bjeshkët e Nemuna, pa dyshim, janë masivi me unik malor në Ballkanin Perëndimor. Bjeshkët e Nemuna kanë vlerë kulmore në:

Pasurinë, shpeshhtësinë, shumëllojshmërinë dhe veçantitë gjeomorfologjike të objekteve (malet, grykat, kanjonet, shpellat, etj dhe veçoritë e tyre atraktive);

Kushtet morfologjike për zhvillimin e sporteve dimërore, të alpinizmit dhe të speleoturizmit⁵⁷;

De-nivelimin dhe kapacitetet potenciale, të shtigjeve të skijimit (65.396m dhe po aq skiatorë në një orë), me hapësira dhe kushte të tjera për zhvillimin e turizmit sportivo-dimëror.

Si dukuri impulsive me attribute shumë të dukshme estetike dhe që ngjallin kuriozitet dallohen: Gryka e Rugovës, Burimi i Drinit të Bardhë, Ujëvara e Mirushës, Shpella e Radavcit, kreshtat shkëmbore, Maja e Kopranikut, Liqeni i Kuqishtës, etj. Hapësira e Bjeshkëve të Nemuna paraqet vlerë të veçantë turistike, por njëkohësisht është faktor i valorizimit të tërës natyrës turistike të Bjeshkëve të Nemuna.

Vendet e gjuetisë në Bjeshkët e Nemuna janë mjaft atraktive, por duhet të rregullohen teknikisht dhe të mbrohen, në mënyrë që të përfshihen më me sukses në zhvillimin e turizmit të gjuetisë. Rajoni i Pejës, i Deçanit dhe i Ibrit janë përplot me lloje të rëndësishme peshqish që krahas bukurisë së peizazhit, ofrojnë kushte të jashtëzakonshme për zhvillimin e turizmit të peshkimit. Nga vlerat dhe atraksionet antropogjene turistike që përbëjnë komponentët atraktivë të ofertës turistike të Bjeshkëve të Nemuna mund të veçohen:

Trashëgimia e pasur dhe e shumëllojshme e monumenteve, kishat mesjetare serbe, monumentet e arkitekturës islame (xhamitë, hamamet, urat dhe hanet);

Pasuria etnografike dhe folklorike (veshja rugovase, vallet dhe këngët folklorike, zakonet tradicionale;

Veçoritë kulturo-historike të traditës dhe veçantitë e tjera;

Objektet e mbrojtura të natyrës, mjedisi jetësor ekologjikisht i shëndoshë dhe i pa-urbanizuar, largësia nga zhurma, popullimi i pakët dhe gjerësia e sipërfaqeve të lira për rekreacion në natyrë.

⁵⁷ Speleoturizimi është degë turistike që përfshin eksplorimin dhe hulumtimin e shpellave

=====

Vlerat natyrore, sidomos ato të mjedisit, të peizazhit dhe vlerat estetike të Bjeshkëve të Nemuna, nga pikëpamja e veçorive të tyre, karakterit burimor, shumëllojshmërisë dhe raritetit, meritojnë statusin dhe trajtimin e pasurive me interes të veçantë, prandaj duhet t'i mbrojmë edhe për brezat e ardhshëm në formën e parkut kombëtar;

Nevoja e shpalljes të Bjeshkëve të Nemuna park Kombëtar, buron nga fakti se dekadave të fundit seriozisht janë rrezikuar dhe i janë nënshtruar shkatërrimit dhe degradimit të pamëshirshëm.

Duke pasur parasysh strukturën e produkteve turistike dhe tendencat dhe kërkesat e turizmit, në Bjeshkët e Nemuna mund të zhvillohen degë të shumta dhe të shumëllojshme të turizmit, si: turizmi dimëror-sportiv, shëndetësor rekreativ, shëndetësore-kuruese, ekskursionist rekreativ, gjuetia, peshkimi, alpinizmi, speleoturizmi, etj. Në pajtim me kërkesat ekologjike, përparësi duhet t'i jepet zhvillimit të degëve selektive të turizmit, si: turizmit ekologjik, gjuetisë dhe të peshkimit, turizmit shëndetësor, rekreativ, alpinizmit, etj.⁵⁸

Korniza ligjore për parkun nacional

Baza juridike për shpalljen e Bjeshkëve të Nemuna Park Nacional qëndron në Ligjin mbi mbrojtjen e vlerave natyrore dhe vlerave të krijuara me punë të ambientit të njeriut ("GZK" 39/88). Sipas këtij ligji Parku Nacional është "rajon me vlera të ruajtura natyrore, të krijuara dhe estetike të cilat kanë rëndësi kulturore-arsimore, shkencore, estetike dhe turistiko-rekreative". Në Parkun Nacional mund të lejohen vetëm veprimtaritë me të cilat nuk rrezikohet burimi i botës bimore dhe shtazore, vlerat hidrografike, gjeomorfologjike, gjeologjike, kulturore si dhe vlerat e peizazhit të Parkut Nacional si dhe veprimet me të cilat mirëmbahet ose vendoset ekuilibri natyror. Veprimtaritë ekonomike dhe veprimtaritë tjera në territorin e Park Nacional duhet të ushtrohen vetëm në pajtim me planet dhe programet e Parkut Nacional.⁵⁹

Për herë të parë në Republikën e Kosovës mjedisit ju ka siguruar mbrojtje ligjore penale konform kornizave të Konventës ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet Ligjit penal.⁶⁰ Në kuadër të këtij ligji vendi jonë janë ka respektuar parimet dhe kërkesat e Konventës ndërkombëtare mbi mbrojtjen e mjedisit jetësor nëpërmjet Ligjit penal.

58 Reçica, Dr.Fetah. "Komunikacioni dhe udhëtimet turistike", 2006

59 Studim mbi arsyeshmërinë e shpalljes së territorit të Bjeshkëve të Nemuna Park Nacional, Prishtinë, 2003

60 Këshilli i Evropës, Komisioni për Mjedisin, Planifikimin Rajonal dhe Autoritetet Lokale, Strasbourg, 1998

2.2 Harmonizimi i strategjisë së zhvillimit

Trekëndëshi *Kosovë – Shqipëri – Mali i Zi* përkufizon Bjeshkët e Nemuna që janë vazhdim i Alpeve Shqiptare nga Shqipëria e Veriut dhe krahina e Plavës dhe e Gucisë, për të përfunduar kështu masivin në pjesën perëndimore të Kosovës.⁶¹

Duke pasur parasysh se për formimin e një qendre malore bashkëkohore turistike me sezon aktive verore dhe dimërore duhet një kohë e gjatë dhe mjete të konsiderueshme investive si dhe përkrahja e strukturave qeveritare. Ndërtimi është parashikuar të kryhet në disa etapa. Investimet në fillim duhet orientuar në zhvillimin e lokaliteteve që lidhen më mirë me rrjete rrugore dhe kanë potencial të pasur resursesh, ku duhet të respektohet parimi i koncentrimit të ndërtimeve turistike dhe të konceptit të marketingut. Në procesin e ndërtimit dhe të organizimit të përmbajtjeve turistike malore një kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet ruajtjes dhe përparimit të sistemit ekzistues ekologjik të Bjeshkëve të Nemuna. Çdo cenim i baraspeshës do të kishte pasoja negative në mundësitë e valorizimit turistik. Prandaj, organizimi i parkut kombëtare në rajonin e Bjeshkët e Nemuna është një hap i rëndësishëm në shfrytëzimin e organizuar optimal të mundësive potenciale të këtij rajoni.

Aдекватно kvalitativno i kvantitativno vrednovanje međuzavisnosti i povezanosti ruralnog razvoja i turizma, u svetlu agroturizma, utvrđuje se

=====

analizom ekonomskih efekata turizma i delom obostranih ekonomskih efekata. Kao direktni, ispoljavaju se sledeći uticaji turizma na poljoprivredu: veća proizvodnja i veći plasman poljoprivrednih proizvoda, veće zarade zaposlenih, nova radna mesta, razvoj nerazvijenih i slabo razvijenih područja, zaustavljanje iseljavanja iz pojedinih sela i opština zbog nedostatka posla, podsticaj prirodnog priraštaja stanovništva, zaštita i valorizacija kulturno istorijskih vrednosti (spomenici, manastiri, muzeji, galerije i sl).

Turizam preko indirektnih ekonomskih uticaja na poljoprivredu, indirektno podstiče i niz ostalih delatnosti i segmenata ekonomskog sistema na širem nivou: uključivanje privrede u međunarodnu podelu rada, opšte privredni i kulturni razvoj, socijalna i penziona politika, i sl (BUTTS, S., BRIEDENHANM, J 2006: 134).

Ekonomski efekti i za receptivna ruralna područja Kosova veoma su važni i brojni: razvoj niza napuštenih seoskih zajednica valorizacijom zapostavljenih-napuštenih imanja, seoskih kuća, salaša, sojenica, mehanizacije, oživljavanjem brojnih zaboravljenih tradicionalnih aktivnosti i sl. Suština ponude u ruralnim područjima jeste boravak u renoviranim seoskim kućama u tradicionalnom stilu sa mogućnošću samostalnog spremanja hrane, upoznavanje tradicionalnih kulturnih vrednosti i običaja i sve to u ekološki zdravoj sredini. Smeštaj i ishrana turista na ovaj način, mnogo su atraktivniji, ekonomski jeftiniji i istovremeno zdraviji od uobičajenog hotelskog smeštaja i ishrane. Znači, samostalno pripremanje hrane u seoskim kućama i salašima, objedinjava klasične usluge smeštaja i ishrane u jednu, za razliku od klasičnih usluga hotelijerstva i restoraterstva. Zatim, ovaj oblik turizma u ruralnim sredinama, konkretno salašima odvijao bi se tokom cele godine, za razliku sezonskog karaktera ostalih selektivnih oblika turizma. Direktni uticaji poljoprivrede na turizam ispoljavaju se kroz ponudu zdrave hrane, povećanje turističke potrošnje, upoznavanje turista sa kulturnim i tradicionalnim vrednostima (te komercijalni efekat i po ovom osnovu), boravak u zdravoj prirodnoj sredini i tsl.

Kao poseban značaj agroturizma i njegovu prednost u odnosu na sve ostale oblik turizma, može se navesti njegov nesezonski karakter, tj. funkcionalnost 365 dana. Međutim, višestruki ili multuplikativni efekti agroturizma na ekonomski razvoj zemlje, mogu se sagledati posredstvom turističke potrošnje. Analize i istraživanja u svetu, primene teorije multilpkatora u turizmu, pokazuju da novac ostvaren prodajom turističkih usluga stranim turistima, cirkuliše u privredi zemlje domaćina, praveći dodatne efekte za privredu, čak u 13 do 14 transakcija, pre nego nestane posredstvom uvoza proizvoda ili usluga iz te zemlje (Clement, 1961).

Ko su budući turisti i koje su karakteristike njihove tražnje, važno je za kreatore i nosioce ruralnog razvoja iz više razloga: kako organizovati

=====

ponudu, strukturu ponude, kvalitet i kvantitet ponude, prilagoditi sve kapacitete počev od saobraćajnih, komunalnih, smeštajnih, bezbednosnih, i dr.

Na ekonomske efekte turizma na određeno mesto, uticaj imaju grupe različitih faktora. Neke od njih, sa značajnijim intezitetom su:

- prirodne i antropogene vrednosti područja,
- materijalna osnova,
- pristupačnost (udaljenost od emitivnih turističkih područja, saobraćajna povezanost),
- organizacija i politika razvoja turizma
- organizovana ponuda sa svim sadržajima

Navedeni faktori i vrednosti određuju uticaje i značaj turizma za konkretno mesto. Turizam kontinuirano **podstiče razvoj niza ostalih delatnosti** u ruralnom području, koje direktno ili indirektno učestvuju u pružanju usluga turistima (saobraćaj, trgovina, proizvođači hrane i pića, građevinarstvo, i druge delatnosti koje učestvuju u ponudi).

Razvoj turizma podstiče ili donosi efekte i na makro-državnom nivou:

- uticaj na platni bilans zemlje,
- uticaj na zaposlenost i životni standard stanovništva,
- podsticaj razvoja ostalih privrednih delatnosti uključenih u turističku privredu,
- uticaj na investiciona ulaganja,
- podsticaj razvoja drugih nerazvijenih područja.

Prostorna odvojenost turističke tražnje i ponude određenog ruralnog područja ili destinacije ukazuje na značaj organizacionih aktivnosti u smislu uspostavljanja efikasnih odnosa između nosilaca tražnje i ponude. Slučajevi u praksi potvrđuju da obim turističkog prometa i potrošnje, zavisi od efikasne organizacije ruralnog razvoja i turizma uopšte, a posebno u smislu uspostavljanja povoljnih odnosa između nosilaca turističke tražnje i ponude.

Zaključak i poruka

Poljoprivreda nije jedina, ali je veoma značajan pokretač razvoja ruralnih regiona Evropske Unije. Sa Agendom 2000 i politikom razvoja ruralnih oblasti, kao drugim stubom Zajedničke agrarne politike (ZAP) Evropska Unija je razvila politiku podrške koja odgovara značajnoj ulozi poljoprivrednika i sve većim društvenim zahtevima koji se postavljaju pred učinak poljoprivrede. Drugi stub – politika razvoja ruralnih oblasti – odražava **filozofiju evropskog modela poljoprivrede** i njegove ciljeve, koji u poljoprivredi vide mnogo više od puke proizvodnje životnih namirnica.

Reforme iz 2003. godine, preko obavezujućih promena (modulacija), dovele su do smanjenja direktnih plaćanja velikim poljoprivrednim gazdinstvima u okviru ZAP-a, kako bi se finansirala nova politika razvoja ruralnih oblasti. Nova politika ruralnog razvoja posebno mesto i ulogu dodeljuje multifunkcionalnoj poljoprivredi, u okviru koje posebno mesto dobija, između ostalog, i agroturizam. Sva ta i mnoga druga pitanja iz domena privrednog i ruralnog razvoja, ekonomske, agrarne, turističke i ruralne politike, kao i pitanja odnosa poljoprivrede i turizma – predmet su studiranja na ovom, **atraktivnom i perspektivnom** studijskom programu, kako na osnovnim, tako i na master studijama.

Literatura

1. BUTTS, S., BRIEDENHANM, J.: Ruralni turizam: projektni okoliš i održivost, Acta turistica, Ekonomski fakultet, Zagreb, 2006.
2. CLEMENT, H.G.: The Future of Tourism in Pacific and Far East, Washington, 1961.
3. ČEROVIĆ, S.: Raznovrsnost turističkog tržišta, Privredna izgradnja, Novi Sad, br. 3- 4/2002.
4. Grupa autora: Strategija regionalnog razvoja Srbije, Ekonomski fakultet, Kragujevac, 2004.
5. ĐEKIĆ, S.: Održivi ruralni turizam kao komponenta održivog ruralnog razvoja, Turizam, Novi Sad, br. 6/2002, str. 22-23.
6. ĐEKIĆ, S., VUČIĆ, S.: Ograničenja u razvoju održivog ruralnog turizma, Turizam, Novi Sad, 2004, str. 34-35.
7. ĐEKIĆ, S.: Osnove razvoja turizma Srbije u uslovima globalne konkurencije, zbornik radova, Ekonomski fakultet, Niš, 2008, str. 331-342.
8. MILINKOVIĆ, S.: Regionalni izazovi ruralnog turizma Balkanskih zemalja, zbornik radova, Ekonomski fakultet, Niš, 2008, str. 169-175.
9. PEJANOVIĆ, R., NJEGOVAN, Z., TICA, N.: Tranzicija, ruralni razvoj i agrarna politika, monografija, Poljoprivredni fakultet – Novi Sad, Ekonomski institut, Beograd, 2007.
10. PEJANOVIĆ, R., NJEGOVAN, Z.: Aktuelni problemi poljoprivrede i sela Republike Srbije, Industrija, Ekonomski institut, Beograd, br.1/2009, str. 87-99.
11. WALL, G.: Turistička industrija: njena ranjivost i prilagodljivost promeni klime, Ekonomski fakultet, Zagreb, 2006.

KUD 657

**RËNDËSIA E STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË
KONTABILITETIT DHE REVIZIONIT FINANCIAR NË
MENAXHIMIN FINANCIAR NË BIZNES**

Fatos Ukaj
fatos_ukaj@yahoo.com
Fetije Ukaj
fetijeu@yahoo.com

Abstrakt

Ekonomia e Kosovës e ndërtoj një sistem financiar të pavarur që nga viti 1999 e këtej duke mundësuar funksionimin e ekonomisë që nga ndërmarrjet, sistemi bankar dhe Banka Qendrore si mbikëqyrës dhe menaxhuese e sektorit të financave. Në këtë punim do të pasqyrojmë rolin e menaxhimit financiar dhe implementimit të standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar. Do të shtjellojmë zhvillimin dhe nivelin e arritur të kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë. Do të shtjellojmë rendësin e implementimit të standardeve ndërkombëtare të raportimit Financiar por edhe pritjet dhe përfitimet e atyre që janë të interesuar të përdorin të dhënat, e ata mund të jene edhe investitorët e jashtëm, por edhe opinionin publik dhe mediat që janë të interesuar për zhvillimet në ekonomi dhe institucione. Në punim shfrytëzohen të dhënat e mbledhura nga burime të shkruara por edhe intervista me profesionist dhe menaxher të financave. Në fund do jepen përfundimet dhe rekomandimet për çështjen e shtruar.

Fjalët kyçe: Menaxhimi Financiar, Kontabilitetit, Auditimi, Raportimi financiar.

Abstract

The economy of Kosovo has built an independent financial system from 1999 onwards, enabling operation of the national economy including enterprises, commercial banking system and Central Bank as supervision and management institution of the finance sector. In this paper we will reflect the role of financial management and implementation of international reporting standards. We will examine the development and achievements on implementing of accounting and audit practices in Kosovo. We will examine the importance of implementing international financial reporting standards, but also expectations and benefits of those who are interested to use the financial data; they can be in first place the foreign investors, but also the public opinion and media that are interested in developments on economy and institutions. In this paper will be

presented used data collected from written sources but also interviews with professionals of finance branch and financial managers. In the end will be given the conclusions and recommendations about the issue analyzed.

Key words: Financial Management, accounting, auditing, financial reporting.

JEL Classifiacation: M41-Accounting, M42-Auditing

1. Hyrje

Me tranzicionin ekonomik të cilin e përjetoj dhe po e përjeton shoqëria kosovare del e pashmangshme nevoja për aplikimin e një sistemi me të avancuar të menaxhimit financiar në bizneset private, ndërmarrjet publike dhe në institucionet siç janë organizatat joqeveritare, ato qeveritare dhe në vetë institucionet e pushtetit lokal dhe ati qendror.

Faktikisht nevoja për një sistem të kontabilitetit dhe mënyrës së avancuar të menaxhimit financiar lindi që në fillim të vitit 2000 duke e pas parasysh vitin 1999 si vit të cilin mund ta cilësojmë si “viti i emergjencës”, ngritja e institucioneve shtetërore dhe fillimi i vjeljes së doganave, taksave dhe tatimeve e bene aktual evidencimin dhe menaxhimin e rrjedhës së mallrave dhe shërbimeve për çka edhe u ngrit iniciativa për aplikimin e standardeve ndërkombëtare në evidentimin e transaksioneve. Në këtë proces u inkuadruan specialistë vendas dhe ekspertë të huaj të cilët së bashku e benë realitet implementimin e sistemit të raportimit financiar të bazuar në standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe revizionit financiar. Fakti se në Kosovë ka në dispozicion një numër të konsiderueshëm të specialistëve financiar e beri më të lehtë që në konsultim me përvojat e vendeve të Evropës Juglindore dhe të atyre Europine të aplikohen standardet ndërkombëtare. Kjo fazë e implementimit të standardeve ndërkombëtare vazhdon edhe tani me intensitet të ashtuquajtur “hap pas hapi” në mënyrë që të i jepet kohë komunitetit të biznesit për adaptim në kushtet e reja të afarizmit ku aplikohen rregullat e raportimit dhe evidentimit të transaksioneve si në mallra dhe shërbime ashtu edhe në ata financiare.

Sistemi bankar (ai i bankave komercial) i dha një shtytje futjes në rrjedha të evidentimit të transaksioneve si gjë normale në nevojën që për transferet e bëra të ketë evidencë. Rol të rëndësishëm dhe vendimtar në çështjen e rregullësis së regjistrimit dhe përcjelljes së rrjedhave të grumbullimit, qarkullimit dhe shpërndarjes së mjeteve financiare me të cilat menaxhohet ka informimi i çdo subjekti që bënë pjesë në këtë zinxhirë të transaksioneve. Natyrisht se bizneset kosovare që në shumicë janë ndërmarrje të mesme dhe të vogla do të hasin gjithnjë e më shume në vështirësi për financimin e biznesit të vetë pikërisht për shkakun e

=====

menaxhimit të dobët apo keqmenaxhimit të financave dhe në përgjithësi të rrjedhës së biznesit të vetë. Këtij informimi mundë ti kontribuoj secili pjesëmarrës në procesin e menaxhimit të financave qoftë ato private apo publike, pikërisht shteti dhe institucionet që merren me politikat fiskale e kanë rolin vendimtar në informimin dhe edukimin e bizneseve për obligimet e tyre që të raportojnë për rrjedhën e biznesit dhe transaksionet e tyre. Faktor tjetër që ka rol në informimin dhe edukimin e bizneseve kanë shoqatat e bizneseve (Oda Ekonomike,AKB.. etj) që duhet njëkohësisht të ofrojnë asistencë në zgjidhjen e problemeve që lindin nga mosinformimi për rregullativen ligjore dhe obligimet ndaj autoriteteve fiskale në vend dhe jashtë tij. Faktorë tjetër që ka ndikim në informim për mënyrën dhe metodat për menaxhimin e financave janë bankat komerciale të cilat për klientët e vetë duhet të krijojnë kushte optimale në kuadër të mundësive të veta për mbajtjen dhe zgjerimin e biznesit pikërisht në asistimin e atij menaxhimi duke bërë planifikimin e rrjedhës së parasë dhe buxhetimin me kohë të investimeve të parapara. Për të arrit që niveli i menaxhimit të financave të bëhet transparente ka qenë e nevojshme të krijohet infrastruktura ligjore për kushtet dhe mënyrën e qarkullimit të mallrave dhe shërbimeve dhe evidencën e këtyre transaksioneve. Rregulloret e UNMIK-ut u përshtaten, si dhe u bënë ligjet të aprovuara nga Kuvendi i Kosovës duke filluar nga Ligjet sistemore për doganën, taksat dhe tatimet e deri tek udhëzimet për transparencën e transaksioneve financiare brenda vendit dhe jashtë. BQK (Banka Qendrore e Kosovës) si Institucion kryesor financiar në Kosovë në marrëdhëniet shoqërore ekonomike të tanishme ka detyrë dhe duhet të avancoj në atë drejtim që të sinjalizoj dhe të tregojë për joligjshmërit, moskuptimin dhe vështirësit në aplikimin praktik të rregulloreve të ndryshme që i përkasin qarkullimit dhe menaxhimit të rrjedhave financiare. Administrata Tatimor e Kosovës gjithashtu si agjencion në shërbim të qeveris ka obligim dhe detyrë që së pari të mbikëqyr implementimin e ligjit por edhe të ndërhyj aty ku vërehet një ngecje për shkaqe të mos zbatueshmeris së rregulloreve pikërisht me qëllim të mbrojtjes së komunitetit të bizneseve duke u mundësuar në këtë mënyrë një kohë për menaxhimin sa ma të mirë të financave të tyre pa e lenë anash përmbushjen e obligimeve ndaj taksave dhe tatimeve.

2. Arritjet në zhvillim dhe implementim të menaxhmentit financiar tek ndërmarrjet dhe institucionet në Kosovë

Në menaxhimin e financave në ndërmarrjet kosovare vend të rëndësishëm duhet të kenë këto principe që kanë të bëjnë me financimin e bizneseve dhe në përgjithësi me rrjedhën, planifikimin dhe gjendjen financiare të biznesit.

Këto principe mundë të përshkruhen si:

- Principet bazë të financave,
- Principet për politiken financiare,
- Principi i planifikimit të financimit dhe rrjedhës së financave,
- Principi i analizës së financimit dhe rrjedhës së financave,
- Principi i kontrollës së arsyeshmërisë së përdorimit të mjeteve financiare..

Mundë të vendosen edhe principe tjera por këtu do të ndalemi vetëm tek këto duke i përshkruar dhe dhënë ide specialistëve që vetë të përcaktojnë nevojën për njohuri të reja në këtë lëmi dhe të avancojnë njohurit ekzistuese teorike por edhe praktike të veta.

Sa më shumë që një biznes i përmbahet principeve të financimit aq më pak do të jetë në rast të vijë në kundërshtim me rregullativen ligjore dhe vetë përshtatjes në ekonominë e tregut.

Principet bazë të financave – mundë të përshkruhen më sa vijon duke pas parasysh se mundë të vendoset për shumë sish varësisht nga nevojat dhe madhësia e biznesit. Principi mbi subjektin që financohet, principi mbi funksionin e njësisë monetare (euros), principi i vështirimit të biznesit nga aspekti i financave, principi i burimit të mjeteve monetare për financim, principi i ndërlidhjes së rrjedhës së financave, principi i rentabilitetit në financim, pastaj principi i sigurisë dhe likuiditetit, duhet që të ekzistoj edhe principi i stabilitetit dhe ndershmërisë në financim.

Principet për politiken financiare- në një biznes mundë të realizohen në kuadër të politikës afariste dhe zhvillimore të veta duke vendosë : cakun kryesor financiar, zgjidhjes dhe formulimit të strategjisë financiare, zhvillimit të një organizimi vertikal dhe horizontal financiar, si dhe mbështetja në principin e vendosjes për financimin dhe rrjedhat financiare. Në principet e politikës financiar tentohet që të arrihet një optimum në mesë të gjerësisë, nivelit dhe strukturës së përbërësve të politikës si p.sh. Optimumi në strukturën në mesë të obligimeve ndaj burimit të financave, pastaj politika e optimumit të solovences(aftësisë paguese).

Politiken financiare e formulojnë dhe e propozojnë shërbimet profesionale financiare në kuadër të biznesit si dhe trupat udhëheqës në biznes (bordet e drejtorëve etj.)

Principi i planifikimit të financimit dhe rrjedhës së financave- është një prej principeve që kanë të bëjnë me planifikimi në kuadër të biznesit dhe për këtë arsye bihen këto lloje të planeve: plani i mundësive investuese (aftësia e biznesit për të investuar), plani për mjetet financiare të nevojshme, plani për burimin e mjeteve për financim, plani i inkasimit dhe pagesës së mjeteve financiare, si dhe plani për plasmanin e mjeteve financiare.

Principi i analizës së financimit dhe rrjedhës së financave- është një prej principeve që ka të bëjë me shumti me monitorimin e devijimeve si

=====

në planin e financimit ashtu edhe në planin e rrjedhës së financave. Kjo pikësëpari ka të bëjë me analizën e :

- efikasitetit financiar të investimeve të bëra në mjetet themelore dhe në ato të lëvizshme,
- çështjet që kanë të bëjnë me marrëdhënjet afariste me “burimin e financimit”,
- çështjet që kanë të bëjnë me stabilitetin financiar, likuiditetin dhe solvencën, dhe përcjellja e plasmanëve financiare.

Principi i kontrollit të arsyeshmërisë së përdorimit të mjeteve financiare- është princip të cilit duhet që ti përmbahen ndërmarrjet dhe për këtë janë përgjegjës sektori financiar dhe kontrolli i brendshëm i ndërmarrjes që e analizojnë arsyeshmërinë e shfrytëzimit të mjeteve financiare , rrjedhës së mjeteve financiare dhe krahasimit të situatës aktuale me atë të planifikuar.

Duhet cekur se kontrollin e ligjshmërisë dhe mënyrës së shfrytëzimit të mjeteve financiare në ndërmarrje e bënë Administrata Tatimore por edhe auditori i jashtëm si organe eksterne.

3. Trashëgimia dhe ndryshimet pozitive të nevojshme në implementimin e standardeve të kontabilitetit dhe revizionit financiar

Edhe Kosova sikurse edhe vendet e tjera të Evropës Juglindore e ka trashëguar përvojën me një sistem “gjigant” të kontabilitetit dhe të sistemit tatimor që ka qenë ngarkesë për biznesin dhe zhvillimin e ekonomisë së tregut.

Menjëherë pas luftës në vitin 1999 janë bërë përgatitjet dhe konsultimet iniciuar nga Faktori Vendor dhe Ndërkombëtar qeverisës për aplikimin e një sistemi të duhur, së pari të *sistemit tatimor* e pastaj kjo është pasuar me implementimin gradual të *standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe revizionit financiar* për të vazhduar edhe në ditët e sotme me rritjen e numrit të standardeve të aplikueshme në raportimet financiare që ndërmarrjet biznesore duhet të përgatisin dhe të raportojnë tek Administrata Tatimore e Kosovës. Natyrisht se me radhë vijnë principet të cilat duhet të ekzistojnë në lëmin e evidentimit të transaksioneve financiare gjegjësisht Kontabilitetit.

Principet në kontabilitet e kanë arsyen e ekzistimit në atë që funksioni i kontabilitetit të mos jetë vetëm i rregulluar me ligje dhe rregullore por edhe me rregullat e pranura gjerë nga profesionistët e kontabilitetit.

Principet e kontabilitetit mundë të grupohen në :

- principet fillestare të kontabilitetit,
- principi i shprehjes në kontabilitet të kategorive ekonomike,

=====

- principet e llogari mbajtjes,
- principi për planifikimin në kontabilitet,
- principi për mbikëqyrjen në kontabilitet,
- principi i organizimit të shërbimit të kontabilitetit.

Këto principe përpunohen në bazë të standardeve të kontabilitetit dhe në bazë të specifikave të vetë ndërmarrjes, madhësisë së saj, personelit profesional në dispozitim etj.

Qëllimi parësor i atyre që mbikëqyrin raportimin financiar të ndërmarrjeve por edhe i vetë biznesit është që në bazë të implementimit të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe revizionit financiar të arrihet:

- së pari drejtimi i kaheve financiare nga ekonomia joformale në atë formale,
- së dyti që të identifikohet kapaciteti i kapitalit të bizneseve veç e veç, dhe të ati kosovar në përgjithësi, dhe
- së treti të evitohet në masë sa ma të madhe manipulimi, falsifikimi dhe prodhimi i dokumentacionit të rrejshëm kontabël.

Standardet e Revizionit që shfrytëzohen në Kosovë por që janë edhe ndërkombëtar bazohen dhe duhet të bazohen në këto principe:

Revizionin Financiaro-Ekonomik mundë ta bëjnë vetëm personat e kualifikuar dhe me përvojë profesionale dhe që janë të pavarur nga ndërmarrja apo institucioni tek i cili kryhet revizioni financiaro-ekonomik, si dhe që ndaj detyrës të kenë qëndrim profesional.

Revizioni dhe punët që duhet kryer planifikohen në mënyrë profesionale, ndërsa personelin e ri dhe me praktikë të vogël vazhdimisht duhet udhëzuar dhe mbikëqyrë.

Revizioni financiaro-ekonomik duhet të bëjë hulumtimin dhe vlerësimin e punës së kontrollit të brendshëm në ndërmarrje dhe institucione, dhe varësisht nga vlerësimi përcaktohet volumi dhe mënyra, si dhe koha e nevojshme për kryerjen e kontrollit gjegjësisht revizionit.

Gjatë kontrollit duhet mbledhë sa më shumë informata, dokumente dhe dëshmi që do të shërbejnë për lëshimin e opinionit të revizorit për objektivitetin e prezantimit të gjendjes ekonomiko-financiare dhe rezultateve të afarizmit.

Në opinionin e revizorit duhet gjithsesi të ceket se a janë raportet financiare real dhe në mënyrë objektive e paraqesin situatën financiare të ndërmarrjes apo institucionit tek i cili është kryer kontrolli dhe se ato raporte janë përpiluar në harmoni me principet e kontabilitetit.

Assesi nuk duhet që revizioni financiaro-ekonomik të renditet në funksionin e kontabilitetit dhe të shikohet si pjesë e analizës kontabël dhe mbikëqyrjes kontabël . Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të

kontabilitetit dhe revizionit financiar e shtron domosdoshmërishtë nevojën për ekspertë të profesionit dhe atë në një numër të konsiderueshëm. Pikërisht kjo ndikoj dhe ndikon në orientimin e numrit gjithnjë në rritje të punëkërkuësve potencial në aftësimin për kryerjen e punës lidhur me financat, kontabilitetin dhe revizionin financiar.

4. Përfundime

Në studimin e gjendjes së implementimit të kontabilitetit dhe revizionit financiar në bazë të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit që do të ketë ndikim direkt në kualitetin e menaxhimit financiar është e vërejtur:

- niveli dhe tempi jo i kënaqshëm i implementimit të rregulloreve mbi raportimin financiar,
- niveli dhe tempo jo i dëshiruar i implementimit të raportimit në bazë të standardeve ndërkombëtare,
- niveli i ulte i bashkëpunimit të autoriteteve tatimore në Kosovë me bizneset rreth përgatitjes, kontrollit dhe avancimit të raportimit financiar,
- gatishmëria e zbehte e biznesit kosovar për përshpejtimin të futjes së rrjedhës së parasë dhe mallrave në evidencën kontabël,
- ngritja e aktivitetit të shoqatës së kontabilistëve dhe revizorëve për aftësimin e kuadrit profesional nëpërmes kurseve të avancuar,
- ngritja e vetëdijes në institucionet tatimore për nevojën e edukimit të bizneseve e jo vetëm ndëshkimi.

5. Rekomandime

Në vazhdim do japim disa rekomandime për procesin në vazhdim të implementimit dhe avancimit të menaxhimit financiar, raportimit financiar dhe revizionit financiar:

- Aplikimi i metodave dhe standardeve ndërkombëtare në menaxhimin financiar, raportimin financiar dhe revizionin financiar nuk duhet të jete vetëm thjeshtë një cak, por gjithnjë duhet te shikohet si një zgjidhje optimale që do të ndihmoj biznesin në zhvillim dhe sistemin buxhetor të vendit në mbështetjen në të hyra reale.
- Menaxhimi financiar, raportimi financiar dhe revizioni financiar në biznes dhe institucione duhet të implementohen jo si një imponim por si një vlere e arritjeve më të avancuara në botën e biznesit global.,

- Aplikimi i menaxhmentit financiar, raportimit financiar dhe revizionit financiar në biznese dhe institucione duhet të kryhet jo në baze të interesave politike dhe grupacioneve të ndryshme por si interes i vendit për të përfituar investitorët e jashtëm dhe kapitalin e huaj si vend i sigurt dhe me rregulla e ligje që dihen paraprakisht.
- Menaxhimi financiar, raportimi financiar dhe revizioni financiar në biznese dhe institucione duhet larguar nga ndikimi i përfitimeve afatshkurtra dhe ndryshimi i shpeshtë i udhëzimeve, rregullave dhe standardeve.
- Në menaxhimin financiar, raportimin financiar dhe revizionin financiar duhet të behet përfitimi i mundshëm nga konsulenca e organizatave ndërkombëtare, ekspertiza e huaj në drejtim të ngritjes së kuadrit profesional dhe implementimit pragmatik të asaj që është e mundshme të implementohet.
- Koordinimi i veprimeve dhe masave në mese të biznesit, shoqatës së kontabilistëve, administratës tatimore dhe subjekteve tjera të përfshira në liberalizimin e politikës fiskale që do të ndikonte në stabilizimin makroekonomik, liberalizimin dhe reformat në sistemin tatimor.
- Të shihet mundësia që të institucionalizohet dhe standardizohet puna e kontabilistëve të certifikuar dhe revizorëve të certifikuar si një mundësi për punësim dhe mundësi të avancimit profesional.
- Të bëhet informimi publik intensiv dhe me kohë për rrjedhat dhe risit në lëmin e menaxhmentit financiar, raportimit financiar dhe revizionit financiar.
- Eliminimi i paragjytimeve të bizneseve për evazion fiskal dhe drejtimin e ekonomisë gri kah ajo formale.
- Eliminimin e korrupsionit me anë të një kontrole permanente dhe të drejte të raportimit financiar nga ana e revizorëve ekstern por edhe ngritja e kontrollës interne si preventiv.

Objektiva e atyre që e kanë për detyrë dhe obligim të kujdesen për aplikimin e standardeve menaxhimin financiar, në kontabilitet dhe revizion duhet të jenë të lidhura ngushtë me interesat e atyre që përgatisin kuadro profesioniste por edhe me komunitetin e biznesit, pra që qëllimi i veçantë i secilit akterë të jetë në lidhje të ngushtë dhe i harmonizuar me qëllimin e përbashkët .

Shkalla e efikasitetit në implementimin e standardeve varet nga koordinimi i aktiviteteve në mesë të akterve në nivel të vendit, gjegjësisht të Institucioneve, Shoqatave dhe vetë Bizneseve.

Aktivitetet e secilit lidhen me forcën e zbatimit të strategjisë së tyre dhe synimet e tyre duhet të jenë të lidhura për të rritë punësimin, me këtë rast paralel me avancim në integrimin në rrjedhat globale të tregut.

Referencat:

1. Epstein Barry, Jermakowicz Eva, 2007, "IFRS 2007, Interpretation and application of International financial Reporting standards", John Wiley & Sons, Inc.
2. Auditimi i avancuar, SHKCAK, Prishtine,
3. R.Meigs, J.Williams, S.Haka, M.Bettner "Financial Accounting", Irwin McGraw Hill, New York, 2001,
4. Charles W.L.Hill "International Business", McGraw Hill Higher Education, New York, 2001,
5. E.John Larsen "Modern Advanced Accounting", McGraw Hill, New York, 2000,
6. Raportet e MEF, 2004-2010,
<http://mef-rks.org/sq/download/323-raporte-dhe-publikime-tjera>
<http://mef-rks.org/sq/sekretariati-i-bordit-kosovar-mbi-standardet-dhe-raportimi-financiar->
7. Ligjet dhe Rregulloret mbi tatimin dhe taksat e aplikueshme në Kosovë.
<http://www.atk-ks.org/legjislacioni/ligjet/>
8. Ligji Nr. 03/L-222-për Administratën tatimore dhe Procedurat.
9. Shoqata E Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (*Shkçak*)
www.scaak-ks.org/

=====

KUD 338.48 (496.51)

TURIZMI RURAL FORME E VEÇANTE E TURIZMIT NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

*Dr.sc Fetah Reçica
fetahreqica@hotmail.com*

Abstrakt

Turizmi është veprimtari multidimensionale e shoqërisë së sotme bashkëkohore. i cili tashme është afirmuar si një fenomen tipik i qytetërimit bashkëkohor, i cili fenomen parashihet që në të ardhmen të rritet dhe masivizohet edhe më tepër. Turizmi nuk ka lindur me qytetërimin industrial por ka përparuar krahas zhvillimit të njerëzimit dhe qytetërimit. Ketë sektor pas sektorit të bujqësisë dhe energjetikes duhet pranuar si njërin ndër sektorët që duhet dhënë prioritet në zhvillimin e ardhshëm të ekonomisë së Kosovës. Turizmin pra duhet të shihet si një sektor me perspektive në të ardhmen e afërt, dhe si një sektor që ndikon në afirmimin e Kosovës në arenën ndërkombëtare. Formë e veçantë e turizmit bashkëkohor është turizmi rural që me të drejtë quhet turizmi i shekullit njëzetentë . Kjo formë e turizmit tek ne mund të themi se fare nuk është duke u eksplotuar.

Fjalët çelës; Turizmi rural, Bujqësia, Atraksionet turistike, infrastruktura e zonave rurale, resurset nacionale, Bruto produkti.

Hyrje

Procesi i zhvillimit rural është proces në të cilin njerëzit në viset rurale i bashkojnë resurset e tyre për të përmirësuar kushtet jetësore dhe të punës. Përmes përmirësimit dhe rritjes së shkathtësive të tyre, ata synojnë të rrisin kapacitetet e përgjithshme individuale dhe të përgjithshme , për të përmirësuar të ardhurat e tyre njëkohësisht edhe mënyrën e jetesës së tyre. Ne bazë të saj banorëve të zonave rurale u jepet mundësia që të menaxhojnë vet zhvillimin e tyre, me marrëdhënie të balancuara gjinore dhe shfrytëzim të qëndrueshëm të ambienteve rurale, duke zhvilluar veprimtari të rëndësishme ekonomike dhe joekonomike.

Qasja bashkëkohore lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm rural nënkupton një qasje komplekse, e cila përfshin: bujqësinë, resurset nacionale dhe menaxhimin e tyre, transportin rural, ujin dhe higjienën, telekomunikimet, edukimin, shëndetësinë, shërbimet sociale.

Kosova me kushtet e saj natyrore është i kushtëzuar nga madhësia gjeografike, struktura demografike, madhësia e tregut, dhe niveli i ulët i zhvillimit ekonomik. Vet natyra dhe zhvillimi ekonomik kanë pjesëmarrje te popullsisë rurale në popullsinë e gjithëmbarshme e cila është rreth 60 %. Familja rurale mesatarisht ka 8.3 anëtarë (urbane 6.3 anëtarë). Më shumë se gjysma e fuqisë së aftë për punë është e papunësuar. Papunësia në zonat rurale është 54.5 % (44 % në zonat urbane). Burimet kryesore të të ardhurave të familjeve rurale janë: paga (58.0 %), remitancat (14.1 %), të ardhurat nga bujqësia (9.1 %), pensionet, asistenca sociale (7.4 %), të tjerat (11.4 %).

Fermat janë të vogla dhe mjaft të shpërndara. Madhësia mesatare e fermës është 2.36 ha, e tokës bujqësore 2.01 ha, e tokës që punohet 1.30 ha dhe 0.7 ha livadhe dhe kullosa⁶⁸. Numri mesatar i parcelave është 3.4. Nga popullsia rurale pa edukim janë 14.0 %, me edukim fillor 41.2 %, të mesëm 37.5 %, dhe të lartë 7.3 %⁶⁹.

Pjesëmarrja e bujqësisë në vlerën e brutoproduktit është rreth 25 %; Te gjithë këta parametra janë ne predispozita te kushteve te zhvillimit te bujqësisë. Kosova ka 577.000 ha tokë bujqësore⁷⁰, prej të cilave 272,040 ha janë të mbjellura me kultura të ndryshme bujqësore, ndërsa pjesa tjetër është livadhe, kullosa dhe djerrina. Vetëm një sasi e vogël e prodhimeve bujqësore që prodhohen në sektorin privat është e dedikuar për treg (nga 3.4 % te pemët deri në 27 % te perimet). Kjo tregon për mundësitë e vogla të bujqësisë kosovare për të qenë faktor kyç i zhvillimit ekonomik përgjithësisht dhe i atij rural, në këtë moment. Nëse kemi parasysh se vetëm 55 % të familjeve rurale prodhojnë produkte bujqësore dhe blegtorale, atëherë del se plotësimi i përgjithshëm i nevojave të familjeve rurale me produkte vetanake sillet rreth 33 %⁷¹. Shkaqet e një gjendjeje të tillë janë të shumta dhe sillen prej rendimenteve të ulëta dhe politikave ekonomike joadekuate që ndikojnë në aftësinë e pamjaftueshme konkurruese, deri te organizimi jo i mirë institucional dhe i fermerëve. Infrastruktura rurale, si rrugët, sistemi i ujësjellësit, i ujitjes, kanalizimi dhe energjia elektrike nuk janë të zhvilluara në nivelin e kënaqshëm. Veçanërisht rrugët e cilësisë së dobët dhe transporti i shtrenjtë dhe jo i rregullt, nga viset rurale në ato urbane, determinon me të madhe cilësinë e jetës dhe aktivitetet ekonomike në viset rurale. Kjo kërkon që strategjia e zhvillimit rural të bazohet edhe në mundësitë alternative. Rritja dhe zhvillimi i prodhimtarisë bujqësore japin bazë te mirë për zhvillimin turizmit fshatar.

⁶⁸ MBPZHR- Prishtinë 2008.

⁶⁹ Po aty.

⁷⁰ Agjencia Kadastrale e Kosovës –Prishtinë.

⁷¹ Po aty.

Ngritja infrastrukturës rurale si bazë për zhvillimin e turizmit të Kosovës

Infrastruktura e përshtatshme mund të konsiderohet si një nga faktorët më të rëndësishëm për zhvillimin rural në Kosovë. Ajo i shërben shumë qëllimeve, si përmirësimi të kushteve të jetesës, sigurimit të qasjes në tregje, përmirësimi të prodhimit bujqësor si dhe thithjes së investimeve. Krejt këto ndikojnë në zhvillimin e turizmit rural.

Përmirësimi i përgjithshëm i kushteve jetësore mund të arrihet vetëm me një infrastrukturë rurale të zhvilluar, por jo vetëm kaq. Infrastruktura rurale është edhe parakusht esencial për rritjen e prodhimtarisë bujqësore, rritjen e aftësisë konkurruese, si dhe rritjen e profitabilitetit dhe, në përgjithësi, për krijimin më të madh të të ardhurave, që ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e standardit jetësor. Duke pasur infrastrukturë rurale të zhvilluar, në Kosovë pengohet edhe fenomeni shqetësues i migrimit nga viset rurale drejt atyre urbane, sepse qasja në tregje është shumë më e lehtë, si dhe zvogëlimi i diferencave ndërmjet fshatit dhe qytetit shkon çdoherë duke u zvogëluar e me këtë edhe motivi i migrimit.

Faktorët të cilët janë të domosdoshëm për infrastrukturën rurale janë:

Rrugët – Vendbanimet rurale veçohen me mungesë të madhe të infrastrukturës rrugore. Kjo ndikon në rritjen e prodhimtarisë bujqësore, në njërën anë, si dhe një nga faktorët vendimtarë që determinojnë vendimin për ta braktisur fshatin, duke pasur parasysh transportin e vështirësuar dhe ofertën shumë të varfër të shërbimeve. Kjo mungesë ndikon edhe në pengimin e qasjes në shërbimet tjera themelore, siç janë arsimi, kultura dhe shëndetësia.

Mungesa e burimeve financiare – buxhetore dedikuar infrastrukturës rurale është shumë e madhe. Burimet financiare për këto investime janë shumë të pakta, por po ashtu është e vogël edhe rëndësia që i jepet zhvillimit të bujqësisë në viset rurale. Në vitet e fundit ndërtimi i rrugëve ka marrë përmasa të zhvillimit i cili dita e ditës po i plotëson zbrazësit të cilat ndodhen. Në këtë mënyrë do të jetë edhe në funksion të turizmit rural⁷².

Uji - Në viset rurale të Kosovës sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm është në gjendje shumë të rëndë. Një numër vendbanimesh që gjinden bri rrugëve magjistrale apo afër qyteteve të mëdha janë të lidhura me sistemet e ujësjellësit publik. Në shumë fshatra janë ndërtuar me vetëkontribut sisteme të vogla të ujësjellësve lokalë, cilësia e të cilëve nuk kontrollohet. Por, numri më i madh i ekonomive familjare furnizohet me ujë nga pusët, me kualitet të ujit të dyshimtë dhe të dobët.

⁷² Agricultural Policies in Transition Economies – Trends in Policies and Support. Raport i OECD-së, 2002.

=====

Në bazë të studimeve, mbi 50 % e popullsisë përdor ujin për pije i cili nuk i plotëson kushtet elementare të kualitetit. Aktualisht, kompanitë e ujësjellësit janë të organizuara në nivel rajonal dhe atë komunal, kurse çmimet e shërbimit përcaktohen nga këto kompani pa ndërhyrje nga Qeveria.

Kanalizimi - Është karakteristikë se në të kaluarën investimet publike në ndërtimin e sistemeve të kanalizimit në viset rurale kanë qenë shumë të vogla, për të mos thënë se nuk ka pasur fare. As sot gjendja nuk është e mirë. Higjiena është në nivel të ulët, shpeshherë kanoset rreziku i sëmundjeve ngjyëse. Shërbimet e grumbullimit të mbeturinave nuk ekzistojnë, andaj ekonomitë familjare gjenden si munden, duke shpërndarë mbeturinat aty-këtu, duke ndotur ambientin.

Energjia elektrike - Furnizimi me energji elektrike është vështirësuar sidomos pas vitit 1999 dhe nga kjo kanë pësuar jo vetëm viset rurale, por edhe ato urbane. Përndryshe, edhe pse të gjitha vendbanimet rurale janë të elektrifikuara prej kohësh, problemi kryesor qëndron në vjetërsimin e sistemeve të distribuimit të rrymës dhe në kapacitetet e tyre të ulëta. Është me rëndësi të posaçme furnizimi me energji elektrike, sepse ai paraqitet si faktor kufizues në aktivitete agropërpunuese, por edhe në biznese të tjera në të gjitha kompanitë⁷³.

Sistemet e ujitjes - Sistemet e ujitjes në Kosovë paraqiten si faktorë kufizues në prodhimtarinë bujqësore. Ekziston deficit i ujit, që ndikon në produktivitetin dhe në profitabilitetin e fermerëve.

Nga të dhënat e anketës me familjet rurale del se rreth 66 % e familjeve të anketuara deklarojnë se nuk kanë mundësi fare të ujisin tokën e tyre, ndërkaj 34 % kanë mundësi që Nga të dhënat e përgjithshme vërehet se vetëm 16 % e sipërfaqeve të përgjithshme punuese ka mundësi të ujitjen. Në rajonet të cilat nuk janë të mbuluara me hidrosistem, ujitja me pompa të ndryshme e rrit koston e prodhimit.

Zhvillimi i qëndrueshëm rural nuk mund të paramendohet zhvillimin e përgjithshëm dhe të fuqishëm të infrastrukturës rurale. Është evidente se kjo nuk mund të bëhet pa mbështetje financiare buxhetore. Edhe pse nevojat dhe prioritetet buxhetore në Kosovë janë të shumta, është shumë e nevojshme që të rritet vetëdija te projektuesit buxhetorë se investimet më të mëdha buxhetore për infrastrukturën rurale vendosin themelet për zhvillimin e përgjithshëm rural e sidomos të bujqësisë, e cila me produktet e saj ndikon në mënyrë direkte në zhvillimin e turizmit rural.

Tiparet themelore të zhvillimit të turizmit rural në Kosovë

⁷³ Po aty.

Ne bazë të gjendjes së pasqyruar, në analizat dhe hulumtimet e bëra, turizmit rural duhet dhënë prioritet të veçantë. Turizmi rural ndikon në zhvillimin e zonave rurale, balancimin e zhvillimit të rajoneve me pak të zhvilluara dhe pengimin e shpërnguljes së popullsisë rurale. Viteve të fundit në trend është udhëtimi i vizitorëve drejtë fshatrave turistike. Hetohet një rritje e interesimit të njerëzve nga vendbanimet urbane për qëndrim dhe kalimin e kohës nëpër vendbanime rurale, pra ti ikin jetës së përditshmërisë të zhurmshme dhe të mërzitshme në qendra të mëdha urbane. Turizmi rural ka një klientel specifike të veten. Këta janë persona aventuresk që janë të apasionuar pas bukuri natyrore, personat që janë adhurues të kafshëve shtëpiake, adhurues të kalërimit me kuaj, adhuruesit e punëve bujqësore, si vjelja e frutave, personat që preferojnë prodhimet e freskëta bujqësore (djathë, verë, fruta) si specialitete autoktone⁷⁴.

Një klientel e veçantë e turizmit rural janë kategoria e turistëve gjuetar, kjo klientel është e apasionuar pas gjuetisë së kafshëve të egra. Kjo veprimtari është e lidhur me sezonin e gjuetisë prandaj këta janë turist me aktivitet sezonal. Shfrytëzuesit tjerë të turizmit rural janë gjithashtu turistët e sporteve dimërore. Kosova ka potenciale të mëdha për zhvillimin e turizmit rural, prandaj këto potenciale duhet shfrytëzuar në funksion të zhvillimit të turizmit në përgjithësi dhe turizmit rural në veçanti.

Për zhvillimin e turizmit rural ndikojnë një sërë faktorësh:

1. Atraksionet turistike;
2. Faktori financiar;
3. Niveli i arsimimit të popullsisë lokale
4. Doket dhe zakonet
5. Infrastruktura e zonave rurale.

1. Atraksionet turistike - Kosova ka atraksione të shumta në zonat malore, fushore, pranë lumenjve etj. për zhvillimin e turizmit rural. Te gjitha këto krijojnë kushte për zhvillimin e turizmit rural.

2. Faktori financiar-Për zhvillimin e kësaj forme të turizmit nevojitet mbështetje financiare nga ana e shtetit me instrumentet e tij për popullsinë lokale, me qëllim të përmirësimit të jetës në fshat, përmirësimit kualitativ të strehimit për turistët e mundshëm. Kjo mbështetje financiare realizohet përmes kreditimit me kushte të volitshme nga bankat komerciale, me norma të ulëta të kamatave dhe me afat të gjatë për kthim, si dhe subvencionimit të kreditimit të ekonomive fshatare nga fondet qeveritare të ndara për sektorin e turizmit.

3. Niveli i arsimimit të popullsisë lokale- Në zhvillimin e turizmit rural si faktorë me peshë është niveli i arsimimit të popullsisë lokale, duke veçuar njohjen e gjuhëve të huaja në mënyrë që komunikimi i turistëve me

⁷⁴ Departamenti i Turizmit në MTI-Prishtinë 2008.

=====

popullsinë lokale të jetë me i lehtë. Ndhimesë në këtë drejtim do të jetë organizimi i kurseve për gjuhë të huaja për popullsinë vendase. Pastaj e rëndësishme është edukimi dhe informimi i popullsisë nga lëmi i turizmit, ekologjisë, kulturës, mënyrës se sjelljes ndaj turistëve etj.

4. Kultura, doket dhe zakonet-Niveli kulturor i popullsisë lokale është në atë nivel që nuk i përgjigjet nevojave të zhvillimit të kësaj forme bashkëkohore të turizmit. Në popullsinë rurale ende nuk ekziston gatishmëria për pranimin e turistit në gjirin familjar, sepse turistët e jashtëm janë të interesuar që të njihen drejtpërdrejtë me mënyrën e jetesës së banorëve, të njihen me kulturën e popullsisë, doket dhe zakonet, ushqimin autokton etj.

5. Infrastruktura-zhvillimi i turizmit rural është i lidhur ngushtë me nivelin e zhvillimit të infrastrukturës së zonave rurale. Këtu me infrastrukture mendohet në ndërtimin e rrjetit të rrugëve, rrjetit elektrik, rrjetit të PTT, ujësjellësit dhe kanalizimit etj.

Turizmi rural ka implikime të shumta në përmirësimin e pozitës social-ekonomike të popullsisë lokale:

- Shtimi i prezencës së turistëve në zonat rurale do të ndikojë në shtimin e aktivitetit ekonomik të popullsisë lokale, si shtimi i prodhimtarisë bujqësore për plotësimin e nevojave për prodhime bujqësore,
- Rritja e kërkesës për shërbime të ndryshme, për prodhime artizanale, si rezultat i gjithë kësaj kemi rritjen e punësimit dhe rritjen e të ardhurave të ekonomive fshatare.
- Ngritja e kualitetit të jetës në zonat rurale, ndikon në ndalimin e migrimit të popullsisë rurale në drejtim të qendrave urbane, sidomos gjeneratave të reja, e cila është fuqi punëtore e nevojshme në prodhimtarinë bujqësore.

Kosova me potencialet e veta turistike ka perspektive për zhvillimin e turizmit rural por duhen investime në infrastrukture dhe superstrukture.

Kërkesat dhe dëshirat e mysafirëve për këtë lloj të turizmit janë të përmbledhura në disa pika⁷⁵.

- Përfjetimet në Fermë;
- Gjithpërfshirja e formës së Pushimit me ekologjik dhe me afër natyrës;
- Besueshmëria;
- Transparenca;
- Singjeriteti për shkëmbim dhe ide të reja;
- Informacionet për mysafirët;
- Ofertat dhe aktivitetet speciale;

⁷⁵ Dr.sc.Fetah Recica & Mr.sc. Bedri Millaku / Ekonomia e Turizmit, Prishtinë 2011.

- Prodhimi i sigurt (konsumi i mbrojtur).

Zhvillimi i bujqësisë krahas me infrastrukturën do ti shtyjë ne funksion potencialet turistike dhe zhvillimin e kësaj forme te rëndësishme te turizmit për Kosovën.

Përfundimi

Turizmi rural dhe rëndësia e tij kanë potenciale te mëdha për zhvillimin e tij. Me qen se vendi ynë disponon me mbi 1000 vendbanime rurale . Kjo paraqet bazë te rëndësishme qe këto potenciale ne disponim te shfrytëzohen për ketë formë të turizmit. Shfrytëzimi I potencialëve turistike për ketë formë te turizmit do te jetë I rëndësishme për ngritjen ekonomike si dhe zhvillimin e infrastrukturës ne zonat rurale. Turizmi Rural paraqet vlera te larta duke u cilësuar me një numër aktivitete të ndërlidhura ne mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë. Turizmi rural paraqet kompleks aktivitete të cilat kanë rëndësi ne efektin ekonomik te zonës turistike dhe me gjerë. Aktivitetet e ndryshme janë në disponim për mysafiret te cilët e shijojnë produkte fshatare dhe atraksionet natyrore dhe kushtet e favorshme klimatike, duke gjet mënyrën shumë te mire për pushim dhe rehabilitim nga punët dhe aktivitetet e përditshme ne zonat urbane. Qëllimi është qe këto vlera natyrore dhe turistike te futen ne funksion te ofertës turistike. Ne mënyre qe atraksionet te jenë ne funksion edhe te zhvillimit te turizmit. Mu këtu qëndron arsye se shfrytëzimi i mirfillt i ofertës turistike ne ketë fushë te turizmit për vendin janë te leverdishme. Ne mënyrë qe efekti ekonomik do te jetë mjaft profitabil për ekonominë vendore.

Literatura

1. Dr.sc.Fetah Recica & Mr.sc. Bedri Millaku / Ekonomia e Turizmit, Prishtine 2011.
2. B. Millaku – Shqyrtime Teorike operative dhe analitike te turizmit funksionet ne segmentin balnear te banjave, banja e Pejës Klokotit dhe ujërat termominerale te Kosovës-Prishtinë 2008.
3. M. Gashi “Vlerat turistike ne Kosovë” Plani regional hapësinor i KSAK Prishtinë 1969.
4. M. Gashi : “Uslovi i mogčnosti za razvoj turizma SAP Kosovu, Prishtinë 1977.
5. M. Gashi : “Turizmi si fenomen shoqëror bashkohes”, Časopis “Përparimi”,br.5.Prishtinë 1963. god.
6. M. Gashi : “Osnovni potencial turističkih vrednosti Kosova”,ekspertiza izrađena za potrebe i rade regionalnog prostornog plana Kosova, Priština 1969.

7. Faulkner, B., & Russell, R. (2000). Turbulence, chaos and complexity in tourism systems: A research direction for the new millennium. In B. Faulkner, G. Moscardo and E. Laws, (Eds.), *Tourism in the 21st century: Lessons from experience* (pp. 328–349). L
8. 8.Studimi Makroekonomik për sektorin e Bujqësisë: Taksimi, çmimet, mekanizmat tregtare dhe nxitëse në bujqësi dhe në sektorin e ushqimit në Kosovë, GFASTOAS 2002;
9. 9.Studimet e Entit për Zhvillim dhe Planifikim të Kosovës (1988);
10. Kosovo Economic Memorandum, World Bank, May 2004, Prishtinë;
11. Strategjia për zhvillimin e qëndrueshëm bujqësor dhe rural në Kosovë, MBPZHR, maj 2003, Prishtinë;
12. Sistemi i arsimit dhe zhvillimi ekonomik i Kosovës, Riinvest, 2004;
13. Statistikat e punës dhe punësimit të vitit 2002 në Kosovë, MPMS, maj 2003;
12. E-International Scientific Research Journalondon: The socio – Economic
13. Rindërtimi i Kosovës pas luftës – Strategjia dhe politikat, Riinvest, 2001;
14. 14..World Tourism Organisation (UNWTO) Statistics Departament.
15. World Travel and Tourism Council (2004), Annual Report: Progress & Priorities 2004/05.
16. Tooman, L.A. (1997), “Tourism and Development,” *Journal of Travel Research*, Vol. 35, No. 4, 33-4

KUD 336

PASQYRAT FINANCIARE DHE LLOJET E TYRE

*Msc. Fidane Spahija,
fidane.spahija@gmail.com*

Abstrakt

Ndjekja e një politike fiskale ekspansioniste kur kemi rënie ekonomike, do të rezultojë me rritje të deficitit buxhetor, i cili mund të prodhojë efekte negative në qëndrueshmerine fiskale.

Megjithate, teoria Keynesiane pretendon që rritja e kërkesës agregate do të rrise investimet, të cilat prodhojnë rritje ekonomike në të ardhmen duke rritur kështu të ardhurat buxhetore të cilat do të jenë të afta të shlyejnë borxhin publik.

Sipas një studimi të kryer nga FMN, rezulton që në vendet me nivel të ulët të të ardhurave për frymë ku bën pjesë edhe vendi ynë, kanali me të cilin politika fiskale ndikon rritjen ekonomike nuk janë investimet por rritja e produktivitetit të faktoreve të prodhimit.

=====

Politika fiskale dhe qendrueshmeria fiskale

Përveç rolit të saj në zbutjen e luhatjeve të zhvillimit ekonomik, zgjedhja e politikës fiskale duhet të mbajë në konsideratë edhe ndikimet në qendrueshmerinë fiskale. Një politikë fiskale e qëndrueshme do të thotë që borxhi publik në termat e Produktit të Brëndshëm Bruto (PBB) nuk ka prirje pozitive.

Qëndrueshmëria fiskale ka të bëjë me aftësinë e qeverisë për të financuar shërbimet publike dhe për të paguar ose kthyer borxhin publik.

Një kriter tjetër për të vlerësuar nëse një politikë fiskale është e qëndrueshme apo jo është edhe kushti që norma e parashikuar e rritjes së borxhit publik duhet të jetë me e vogël se norma e interesit gjatë një periudhe afatgjate.

Sipas FMN (2002) politikat ekonomike mund të klasifikohen si të paqëndrueshme në qoftë se ato çojnë në një situatë ku në të ardhmen qeveria nuk mund të financojë shërbimet publike. Në fakt aftësia e qeverisë për të financuar shërbimet publike është një kusht i nevojshëm i qëndrueshmerisë fiskale për shkak se financimi i shërbimeve publike mund të arrihet me kosto shumë të larta (rritja e taksave). Qëndrueshmëria fiskale, kërkon ruajtjen e aftësisë së qeverisë për të financuar shpenzimet publike pa ndryshuar politikat fiskale. Si përfundim, një politikë është e qëndrueshme në qoftë se "parashikohet që një huamarrës është i aftë të vazhdojë të paguajë borxhin e tij pa ndryshime të mëdha në të ardhmen në mënyrë që të balancojë të ardhurat dhe shpenzimet".

Një politikë fiskale do të vlerësohet e qëndrueshme në qoftëse ajo plotëson dy kushte: (i) qeveria përmbush detyrimet/kërkesat korrente të buxhetit duke paguar/kthyer borxhin dhe nuk monetizon (financon nëpërmjet emetimit të parave nga Banka Qëndrore) ate, dhe (ii) një vend/qeveri nuk vazhdon të rrisë nivelin e borxhit publik duke ditur që në të ardhmen do të kërkohej ndërhyrje me kosto të larta në mënyrë që të paguhet/kthehet borxhi. Treguesi më i lehtë për të vertetuar nëse një politikë fiskale është e qëndrueshme apo jo është norma e borxhit publik ndaj produktit të brëndshëm bruto, ose ndryshe norma borxh-të ardhura. Një normë borxhi publik në rritje do të thotë që politika fiskale po bëhet e paqëndrueshme. Sipas Blanchard (1990), norma e borxhit të një ekonomie mund të vlerësohet nëse është në rritje apo jo duke u bazuar në formulën : $\Delta b = b(r - y) - z > 0$, kur 'r' paraqet normën reale të interesit ose e përshtatur me inflacionin (normë nominale minus inflacion); 'z' paraqet balancën primare (të ardhurat minus shpenzimet pa interesa) të buxhetit të shtetit ndaj PBB; 'y' paraqet normën e rritjes së PBB dhe 'b' normën e borxhit ndaj PBB (Δb – ndryshimin e normës së borxhit). Pra norma e

borxhit publik ndaj PBB është në varesi të normës reale të interesit, normës së rritjes ekonomike dhe balancës primare të buxhetit të shtetit. Sa më e lartë të jetë norma e interesit dhe sa më e ulët norma e rritjes ekonomike aq më shumë ka mundësi që norma e borxhit të rritet.

Mbështetur mbi parimet e kësaj formule janë përcaktuar edhe kriteret e Paktit të Stabilitetit dhe Rritjes Ekonomike (PSRrE), nënshkruar në vitin 1997 si element i Traktatit të Maastricht. Sipas këtyre kriterëve, vendet e Bashkimit Evropian nuk lejohet të kalojnë nivelin e borxhit publik mbi 60% të PBB dhe deficitit buxhetor nuk duhet të jetë më i lartë se 3% e PBB. Tashmë kritikata ndaj kriterëve të PSRrE janë të shumta duke kërkuar që ai të rishikohet dhe të ndryshohet në dobi të zhvillimit ekonomik.

Kriteri i Paktit të Stabilitetit në lidhje me nivelin e deficitit buxhetor që të mbahet nën nivelin 3% e PBB, (përveç “rasteve të veçanta”, të tilla si një rënie në rritjen ekonomike më shumë se 2%), nuk janë respektuar nga vendet anetare. Në rastet kur nuk respektohen kriteret e tij përbën një politikë denimi, e cila nuk është përdorur asnjëherë. Edhe politika e denimit (në rastet kur kriteri i deficitit kalohet, ai vend është i detyruar të vendosë një depozit pa interes, - 0.2-0.5% e PBB, në llogari të Komitetit Evropian, dhe në qoftë se ky kriter nuk përmbushet brenda 2 viteve atëherë kjo depozitë do të kthehet në gjobë) të Paktit është kritikuar nga një numër i konsiderueshëm ekonomistësh dhe analistësh. Kjo politikë nuk është kredibël pasi ajo vendoset pas tre viteve pasi shfaqet fenomeni, dhe në bazë të shumicës së votave nga vendet anëtare. Pra denimi nuk është automatik por kërkon një vendim politik, i cili i vendos vendet anetare përpara një vendimi që mund të ketë kosto diplomatike. Pakti është shkelur disa herë nga disa vende anëtare; deficitit buxhetor në Portugali në vitin 2001 ishte 4.2% e PBB; ndërsa Gjermania dhe Franca parashikohen që deri në vitin 2006 të kenë një deficit buxhetor më të lartë se 3% e PBB.

Tabela 1. Niveli i Deficitit Buxhetor në % të PBB

	1999	2000	2001	2002	2003	2004
Gjermani	-1.5	(-1.4)	-2.8	-3.6	-3.4	-2.9
Francë	-1.8	-1.4	-1.5	-3.1	-3.7	-3.5
Portugali	-2.8	-2.8	-4.2	-2.7	-3.5	-3.2

Sipas Creel (2003) dhe Buti (2003) një seri reformash e propozimesh paraqiten për të ndryshuar situatën korente të Paktit. Një nga këto propozime lidhet me aplikimin e “rregullit të artë të financave publike” në Bashkimin Evropian. Rregulli i artë i financave publike lidhet me kufizimin e nivelit të huamarrjes vetëm për të kryer investime publike. Një propozim i tillë është bërë edhe nga Ministri i Financave Italiane, M. Giulio Tremonti për të zbatuar një program investimesh publike në Europë me qëllim nxitjen

=====

e rritjes ekonomike, duke mos i përfshirë këto shpenzime në kriterin e deficitit buxhetor, pra aplikimin e “rregullit të arte”. Në fakt një politikë e tillë përdoret në Britaninë e Madhe dhe Australi.

Pra zgjedhja e politikës fiskale është në vartesi të kushteve ekonomike të vendit dhe gjithashtu përshtatet për të përmbushur objektivat kryesore të një vendi në periudha afatmesme dhe afatgjata. Situata ekonomike jo e favorshme mbi të cilën filloi ekonomia e tregut në Kosovë bie fjala, kërkonte një ndërhyrje të konsiderueshme nga ana e qeverisë në ofrimin e shërbimeve publike. Nivelet e ulta të të ardhurave për frymë, institucionet e dobëta, rënia e prodhimit ishin faktorë që e bënë të nevojshme financimin e shpenzimeve publike në një masë të konsiderueshme nëpërmjet huamarrjes.

Borxhet publike shfaqen pasi niveli i shpenzimeve të qeverisë është më i madh se niveli i të ardhurave të tyre korente.

Politika fiskale dhe politikat sociale

Zgjedhja e politikës fiskale, duhet të konsiderohet si një instrument i rishpërndarjes së pasurisë brenda një shoqërie dhe të sigurojë mbrojtje sociale.

Politika fiskale luan një rol të rëndësishëm në çështjet sociale të një vendi. Një vend me një nivel varfërie të lartë detyron qeveritë që një pjesë të të ardhurave të mbledhura nga taksapaguesit të drejtohen në këto shtresa.

Të ardhurat nga taksapaguesit duhet të përdoren drejt, në mënyrë të paanshme dhe të jenë transparente, duke u bazuar më së shumti në burimin e të ardhurave nga kapitali, pasuria, fitimi dhe konsumi. Ky sistem duhet të jetë më shumë progresiv, me më shumë presion mbi kapitalin dhe pasurinë, dhe duke reduktuar taksat mbi punën dhe mbi konsumin e popullatës. Një politikë e tillë do të bëjë të mundur të ndërtohet një sistem i fortë i mbrojtjes sociale, i aftë për një shpërndarje të drejtë sociale dhe në dobi të rritjes së mirëqenies të të gjithë popullsisë.

Politikat sociale duhet të bazohen si në shkallën e zhvillimit ekonomik ashtu edhe në strukturën demografike të vendit.

Zgjedhja e politikës fiskale në vëndet ish-komuniste ka qenë tepër e vështirë, pasi kërkohej të arrihej njëkohesisht si rritje ekonomike, stabilitet makroekonomik, ashtu edhe financimi i shtresave sociale që goditeshin nga reformat strukturore. Në përgjithësi vëndet ish-komuniste në fillim të tranzicionit të tyre u karakterizuan me një nivel barazie të lartë pavarësisht se niveli i të ardhurave për frymë ishte mjaft i ulët krahasuar me ato të vendeve të Evropës perëndimore. Zhvillimi ekonomik i këtyre vendeve gjatë dekatës së fundit është shoqëruar edhe me rritje të nivelit të pabarazisë duke e bërë rolin e politikës fiskale në politikat rishpërndarëse me të nevojshëm.

=====

Sistemi i taksave progresive dhe politikat e transfertave drejt shtresave sociale vleresohen si instrumentat rishpërndarës më të mirë për peridhën afatshkurtër.

Politika e transfertave drejt shtresave sociale nuk mund të vleresohet si një politikë efiçente, pasi ajo nuk mund të ndryshojë gjendjen sociale të një individi. Subvencionet për përfitimet e papunësisë dhe ndihma ekonomike nuk kanë një ndikim të ndjeshëm në ndryshimin social të një personi. Politikat e transfertave mund të ndikojnë pozitivisht në rritjen e mirqenies së këtyre shtresave për një periudhë të shkurtër kohe por ato nuk mund të konsiderohen si një burim që do të prodhojë mireqenie permanente për këto shtresa.

Një rol të rëndësishëm në rritjen ekonomike dhe reduktimin e varferisë luan kapitali human. Sipas Romer (1986) dhe Lucas (1998), kapitali human luan rol kryesor në rritjen ekonomike dhe reduktimin e varferisë pra në zgjidhjen e problemeve sociale. Financimi i sektorit të arsimit dhe shëndetësisë nëpërmjet buxhetit të shtetit do të përmiresojë kapitalin human, i cili do të prodhojë rritje ekonomike dhe mireqenie. Ekziston një lidhje pozitive midis shpenzimeve në arsim e shendetesi me rritjen ekonomike e vertetuar nga një sërë kërkimesh.

Në një studim të Fondit Monetar Ndërkombëtar, është gjetur që shpenzimet publike në arsim dhe shëndetësi kanë një impakt direkt pozitiv në akumulimin e kapitalit arsimor dhe shendetësor, dhe një impakt indirekt negativ në rritjen ekonomike. Një rritje me 1% e PBB në shpenzimet e arsimit shoqërohet mesatarisht me tre vite shkolle më shumë duke ndikuar rritjen ekonomike me 1.4% në 15 vite. Ndërsa një rritje në shpenzimet e sektorit të shendetësisë me 1% e PBB shoqërohet me një rritje prej 0.6% në mbijetesën e fëmijëve nën 5 vjeç duke rritur rritjen ekonomike me 0.5% e PBB për frymë në vit.

Edhe në vendin tonë politika sociale ka qenë në vëmendjen e politikës fiskale që me fillimin e tranzicionit ku prodhimtaria ishte pothuajse inegzistente dhe papunësia u rrit ndjeshëm. Kjo situatë e detyroi qeverinë që të rrisë subvencionet për shtresat që u goditen më shumë nga ky ndryshim. Kështu nëpërmjet buxhetit të shtetit financohen si skema e pensioneve, ajo shëndetësore, transferime për pagesën e papunësisë, ndihma ekonomike dhe subvencione të tjera në dobi të shtresave sociale.

Politika fiskale dhe ekonomia sociale

Në fund të viteve shtatëdhjetë, një rrymë e re e quajtur "Ekonomiksi i krahut të ofertës" tërhoqi shumë vëmendje. Ofertistët janë të lidhur me disa ide të skajshme dhe të pamundura, si ideja se shkurtimi i normës së taksave

në SHBA do të ulë deficitin aq shumë sa norma e taksave të nxisë kaq shumë punë shtesë sa të rritet totali i taksave dhe të ulet deficitin.

Rreth kursimeve dhe investimeve, ofertistët argumentuan se sistemi i taksave në SHBA, shkurajon kursimet dhe individët do të kursenin më shumë në qoftë se përfitimet nga kursimet do të ishin më të larta.

Ata mbështesin taksa më të gjera të kredive të investimeve.

Sipas ofertistëve një normë më e ulët e taksave nxit sipërmarrjen private, duke argumentuar se rritja mund të rritej nëpërmjet politikave të ndërtuara për të nxitur eficiencë më të madhe, një dëshirë më të madhe për punë dhe investime, produktivitet më të lartë.

Sipas kësaj rryme një shkurtim në nivelin e taksave do të çojë në rritjen e të ardhurave, dhe kështu nuk do të kemi rritje të deficitit buxhetor (sipas kurbes Laffer).

Boshti horizontal tregon të ardhurat nga taksat, boshti vertikal normën e taksës




Figura 3: Kurba e Lafferit

Siç shihet nga figura të ardhurat nga taksat janë rritur deri në një nivel të caktuar të normës së taksës dhe me pas kanë filluar të bien.

Ekonomistët e krahut të ofertës argumentojnë që efekti inkurajues i shkurtimit të taksave është aq i madh sa që do të prodhojë rritje të të ardhurave për shkak të rritjes së bazës së taksueshme.

Një nga debatet më të shpeshta në sferën politike, sidomos gjatë periudhave të zgjedhjeve elektorale, fokusohet në sistemin e taksave.

Platformat elektorale që bazohen në ndryshimin e nivelit të taksave janë të prekshme, dhe zakonisht partitë që janë në opozitë prezantohen me

=====

sisteme me norma më të ulta taksash në qoftë se ato vijnë në pushtet. Faktikisht, platformat që janë bazuar në uljen e taksave nuk kanë rezultuar të suksesshme.

Argumentet teorike të kësaj rryme nuk janë vërtetuar në praktikë.

Përdorimi i këtyre ideve nga Reagan në vitin 1981 (i cili ishte një nga përkrahësit e ekonomisteve të krahut të ofertës) me shkurtim taksash, u shoqërua me rritje të deficitit buxhetor. Ndikimi në rritjen e kursimeve private dhe në rritjen e ofertës për punë ishte minimal, oferta për punë nuk u rrit dhe efekti në kursimet private u eliminua nga reduktimi në kursimet publike (rritje e deficitit buxhetor). Përderisa oferta për punë nuk u rrit dhe kursimet pësuan një rritje të vogël, të ardhurat buxhetore nuk pësuan rritje. Hipoteza e kurbes Laffer dështoi, bashke me përkrahësit e krahut të ofertës.

Ekonomistët e krahut të ofertës u shfaqën përsëri në kohën e Bill Clinton, në vitin 1993, kur ai paraqiti planin e reduktimit të deficitit buxhetor. Edhe pse gjatë viteve 1990 u ndoqën politikat e krahut të ofertës, deficitit buxhetor u rrit nga 2.7% e PBB në 1980 në 4.9% e PBB në vitin 1992, dhe borxhi publik nga 26.1% e PBB në 1979 në 50.6% e PBB në vitin 1993. Plani i shkurtimit të deficitit të Clintonit ishte bazuar në një rritje të caktuar të taksave mbi të ardhurat (vetëm për shumë të pasurit), një rritje në disa nga taksat indirekte dhe një ulje të ritmit të rritjes së shpenzimeve qeveritare.

Përkrahesit e rrymës së krahut të ofertës kritikuan që rritja në normën e taksave do të:

1. ndihmojë ekonominë që të shkojë në rënie dhe do të reduktojë rritjen ekonomike afatgjate;
2. rrisë deficitin buxhetor pasi individët do të reduktojnë ofertën e punës dhe kursimet;
3. rrisë normën reale të interesit për shkak të rritjes së deficitit buxhetor.

Në fakt efektet e planit të reduktimit të deficitit buxhetor të prezantuar nga Clinton ishin plotësisht të kundërta me ato çka paraqitën predikuesit e krahut të ofertës:

1. Deficiti buxhetor u reduktua nga 4.9% e PBB në vitin 1992 në 1.2% e PBB në vitin 1996, ndërsa norma e borxhit publik ishte në rënie;
2. Ekonomia përballi një rritje në vitet 1993-1994 pas recesionit të vitit 1990-91 dhe ekonomia u rrit me një normë mesatare prej 2.8% gjatë viteve 1992-96;
3. Norma e interesit mbeti e qëndrueshme duke arritur në 2% në vitin 1996 (instrumentet afatshkurtër) krahasuar me 5% që ishte në vitin 1980.

=====

Këto pikëpamje u shfaqën përsëri në Amerike në vitin 1996 nga Steve Forbes i Partise Republikane.

Ai propozoi: ndryshimin e sistemit progresiv të taksave mbi të ardhurat në një sistem më një norme të dhënë takse (flat). Sipas këtij propozimi, një sistem taksash me një normë të vetme do të ndikojë në rritjen e produktivitetit të punës duke stimuluar ofertën e punës, kursimet dhe investimet.

Në qoftë se një gjë e tillë do të ndodhë atëherë rritja ekonomike do të rritej nga një mesatare prej 2.5% në vit gjatë viteve 1990 në 4-5% në vit.

Por këto parashikime mbi dyfishimin e rritjes ekonomike janë të papranueshme nga ekonomistët, edhe kur ndodhin ndryshime të politikave ekonomike.

Kjo për arsye se ekonomistët nuk ngatërrojnë ndikimin në nivelin e PBB me ndryshimet në nivelin e rritjes ekonomike. Ekziston një ndryshim i madh midis politikave që ndikojnë nivelin e PBB nga ato që ndikojnë nivelin e normës së rritjes së PBB.

Është e pranueshme që efektet e ndryshimit të politikës së taksave në SHBA do të ndikojnë në nivelin e PBB, por është e vështirë të provohet ndikimi i kësaj politike në normën e rritjes afatgjatë. Për rrjedhojë ndryshimi i politikës së taksave të propozuar nga Forbes nuk çon në dyfishimin e rritjes ekonomike nga 2.5% në 5%.

Shkurtimi i taksave gjatë viteve 1980 në SHBA konfirmuan që nuk ekziston ndonjë efekt permanent në normën e rritjes ekonomike.

Megjithatë Robert Barro, një nga udhëheqësit e ekonomisteve konservativ është shprehur se kalimi në një sistem taksash flat pa ndryshime në shpenzimet qeveritare, do të stimulojë rritjen ekonomike, por ky efekt është i vështirë për tu matur.

Një shkurtim në shpenzimet joproduktive dhe taksa me 1% të PBB do të çojë në rritjen e rritjes ekonomike me 0.1% në vit.

Në qoftë se taksat bëhen me pak shtrënguese, pra nuk eliminohen, efekti në rritje do të jetë më i vogël (maksimumi do të përgjysmohet).

Pra edhe sipas Barro, vendosja e një norme konstante takse për të gjithë konsumatorët nuk do të sjellë rezultatet e pritura nga ekonomistët e krahut të ofertës.

Debatet politike, për shembull, që bazohen në shkollën e ndryshme të mendimit ekonomik paraqiten edhe në platformat elektorale në prag të zgjedhjeve elektorale në Shqipëri.

Një nga propozimet më të debatueshme nga opozita në prag të këtyre zgjedhjeve është ulja e taksave dhe me konkretisht mos tatimi i bizneseve të reja (bizneset e vogla) për një periudhë tre-vjeçare sepse mendojnë që kjo masë do të rrisë prodhimin.

=====

Por bie në kundërshtim me parimet e konkurrencës sepse bizneset ekzistuese do të jenë në pozita inferiore karshi bizneseve të reja. Një situatë e tillë do të prishte parimet e tregut duke krijuar çekuilibrim. Mostatimi i bizneseve të reja (bizneset e vogla) do të bie ndesh me parimin e thjeshtësisë të sistemit tatimor. Në mënyrë që bizneset të fitojnë nga ky përjashtim, ata mund të mbyllin biznesin egzistues duke e rihapur nën një emer të ri.

Vleresimet empirike të vitit 2003 tregojnë që për çdo 1 përqind shkurtim të takses mbi biznesin e vogel efekti në të ardhurat buxhetore është 450 milion lekë(bëhet fjalë për Republikën e Shqipërisë). Kombinuar kjo me abuzimet që do të vijnë nga aplikimi i mostatimit për tre vitet e para efekti në të ardhurat buxhetore parashikohet të arrijë në rreth 2 miliard lekë.

Në paketen fiskale të vitit 2005, Qeveria Qendrore e Republikës së Shqipërisë propozoi që të ulëj niveli i tatimit mbi biznesin e vogël, e cila nuk u pranua nga Qeverisja Vendore.

Rëndësia e taksave

Në bazë të të ardhurave tatimore hartohen politikat fiskale.

Termi politikë fiskale i referohet shpenzimeve që kryen një qeveri për të ofruar të mira e shërbime dhe mënyrës se si qeveria financon këto shpenzime. Ekzistojne dy metoda kryesore te financimit: nëpërmjet taksimit dhe nepermjet huamarrjes. Metoda e huamarrjes rezulton me kosto të larta dhe në disa raste me pamundësinë e shqyerjes, kështu që metoda e taksimit është me e thjeshta, me efikase dhe siguron të ardhura në masë të madhe në bazë të fuqisë të shtetit për mbledhjen e këtyre taksave.

Pra sistemi tatimor përbën burimin primar të të hyrave të shtetit, ato përbëjnë 50 % të të hyrave publike që janë thelbësore për mbarrëvajtjen e një shteti demokratik.

Duke u ndërtuar në mënyre të drejtë dhe në mënyrë eficiente sipas normave legjislativë, i sigurojnë shtetit mjetet e nevojshme për plotësimin e funksioneve të tij dhe për arritjen e objektivave të tij fiskale.

Përmirësimet që po i bëhen sistemit të taksave, si në anën e ndërhyrjeve në ligje ashtu edhe në administrimin e tyre, do të shoqërohen me efekte pozitive në rritjen e prodhimit. Ulja e normës së tatimit mbi fitimin nga 25% në 20% në vitin 2006 ndikon në rritjen e kursimeve të korporatave duke rritur kështu edhe investimet në ekonomi.

Zgjedhja e politikës se taksave, ndihmon në rishpërndarjen e pasurisë brenda një shoqërie dhe siguron mbrojtje sociale. Një vend me një nivel të lartë varfërie detyron qeveritë që një pjesë të të ardhurave të mbledhura nga taksapaguesit të drejtohen në këto shtresa. Kjo do të thotë që qeveritë nuk duhet t'i formulojnë politikat e tyre vetëm në dobi të tregjeve financiare, por të jenë funksion i vlerave sociale të përcaktuara në mënyrë

=====

demokratike. Në një sistem të tillë, të ardhurat nga taksapaguesit duhet të përdoren drejt, në mënyrë të paanshme dhe të jenë transparente, duke u bazuar më së shumti në burimin e të ardhurave nga kapitali, pasuria, fitimi dhe konsumi. Ky sistem duhet të jetë me shumë progresiv, me më shumë presion mbi kapitalin dhe pasurinë, dhe duke reduktuar taksat mbi punën dhe mbi konsumin e popullatës.

Sistemi i taksave progresive dhe politikat e transfertave drejt shtresave sociale vleresohen si instrumentat rishpërndarës me të mirë për peridhën afatshkurter.

Politika fiskale dhe roli i politikës

Zgjedhja e një politike fiskale të caktuar, është një nga treguesit që e klasifikon një qeveri si të majtë apo të djathtë.

Një qeveri është quajtur e majte në qoftë se kërkon të sigurojë shërbime publike duke shpenzuar më shumë për arsim dhe shëndetësi.

Në lidhje me sistemin e taksave këto qeveri mendojnë të mbajnë nivele të larta të taksave mbi të ardhurat për të mbuluar këto shpenzime qeveritare.

Qeveritë e majta pëlqejnë që të mbajnë nivele të ulta të taksave indirekte për arsye se ato janë regresive dhe kështu që prekin më pak të pasurit.

Qeveritë e djathta kërkojnë të reduktojnë shpenzimet qeveritare sa me shume të jetë e mundur. Qeveritë e djathta inkurajojnë skemat private të kujdesit shëndetësor dhe të arsimit privat. Në lidhje me taksat qeveritë e djathta mendojnë të mbajnë nivele të ulta të taksave mbi të ardhurat sepse sipas tyre taksat frenojnë sipermarrjen private.

Këto qeveri kërkojnë kalimin nga taksat direkte te ato indirekte.

Rezultatet e studimit të kryer nga Pettersson-Lidbom (2003) bazuar ë të dhenat e qeverisjes vendore suedese, treguan që roli i partive politike është i rëndësishëm. Qeveritë e majta shpenzonin dhe taksonin 2.5 përqind më shume sesa qeveritë e djathta. Sipas Tavers (2004) tregon që pershtatjet fiskale midis qeverive të majta dhe të djathta ndryshojnë; te majtet mbesheten në rritje taksash, ndersa të djathtet në shkurtim shpenzimesh. Studimi i Tavers (2004) mbeshetet hipotezen që të majtët janë më shumë të besueshëm sesa të djathtët kur shkurtojnë shpenzimet (shpenzimet totale si konsumin publik dhe komponentët e tij), dhe të djathtët janë më shumë të besueshëm kur rritin taksat (taksat në përgjithësi dhe taksat direkte mbi biznesin). I vështirë mbetet klasifikimi i politikës fiskale në vendin tonë. Për shkak të ristrukturimit të ekonomisë si pasojë e kalimit nga ekonomi e centralizuar në ekonomi tregu, zgjedhja e një politike fiskale të caktuar i përgjigjet gjendjes aktuale të ekonomisë.

Pasiguria politike në vend dhe mungesa e stabilitetit social ka çuar në politika të paqendrueshme që kanë ndikuar negativisht në ciklet e biznesit.

Literatura

1. "Leksione të Shkencës së Financës" Mario Leccisotti.
2. "Makroekonomi" Rudiger Dornbusch & Stanley Fischer.
3. "Financa Publike" Harvey S. Rosen. Tiranë. Albin 2003
4. Fondi Monetar Ndërkombetar. Challenges to reforming Tax Administration. May 2005
5. "Financat Publike" Prof.As.Dr. Beatrice Polo. Tiranë. Albpaper 2002.
6. Website. www.google.com
7. "The Politics of Tax Structure" Working Paper. Steffen Ganghof, January 2006
8. Alvaro Riascos Banco and Carlos A. Vegh "Procyclical Government Spending in Developing Countries: The Role of Capital Market Imperfections" IMF Working Paper, 2003.
9. Ames, B., Brown, W., Devarajan, Sh., and Izquierdo, A. "Macroeconomic Policy and Poverty Reduction" IMF and World Bank, 2001.
10. Dong Fu, Lori L. Taylor, Mine K. Yücel "Fiscal policy and growth" Federal Reserve Bank of Dallas, Working Paper 0301, 2003.
11. Durmus Özdemir "Growth, Infrastructure and Fiscal Policy". Istanbul Bilgi University, 2003.
12. Jose' Tavares, "Does right or left matter? Cabinets, credibility and fiscal adjustments", Journal of Public Economics 88 (2004) 2447– 2468
13. Milner, Helen. and Benjamin Judkins. "Partisanship and Trade Policy: Is There a Left-Right Divide on Trade Policy?", Columbia University,
14. Philipp C. Rother "Fiscal Policy and Inflation Volatility" European Central Bank, Working Paper no. 317, 2004
15. Per Pettersson-Lidbom "Do Parties Matter for Fiscal Policy Choices? A Regression-Discontinuity Approach" Department of Economics, Stockholm University, 2003.
16. Dokumenta dhe materiale te Ministrise se Financave, Bankes Boterore dhe Fondit Monetar Nderkombetar.

=====

KUD 338.48 (496.51)

ZHVILLIMI EKONOMIK DHE I TURIZMIT NE KOMUNËN E ISTOGUT –ASPEKETE AFTMESME DHE AFATGJATA

Mr.Sc.Mentor Latifaj

Abstrakt

Synimi i përgjithshëm i zhvillimit të turizmit për Kosovë është të rrisë cilësinë e jetesës së kosovarëve. Zhvillimi i turizmit do të duhet të matet dhe të vlerësohet në një periudhë afatmesme e afatgjatë, lidhur me aftësinë e tij për të përmirësuar mirëqenien e kosovarëve. Në këtë aspekt, ai mundet (dhe do të duhet të jetë) një pjesë e strategjisë së vendit për arritjen e prioritetëve të zhvillimit, të tilla si angazhimet e vendit për synimet e zhvillimit për mijëvjeçarin. Theksimi i turizmit kulturor në Kosovë, do të mbajë në një fokus të rëndësishëm përfitimin nga komunitetet lokale e provinciale që aktualisht ballafaqohen me mundësi të kufizuara ekonomike. esursi strategjik i turizmit kosovar duhet të mbetet hapësira me shumë vlerë, deri tani e ruajtur, që në afat të gjatë gjithnjë e me shumë do të ketë rëndësi. Vlera turistike kanë pothuaj të gjitha trevat e Kosovës në format dhe dimensionet, varësisht nga resurset dhe shkalla e zhvillimit. Fizionomia e elementeve tërheqës të Kosovës udhëzon qartë në rajonet malore, drejtimit e transittit turistik, qytetet e mëdha, banjat, komplekset dhe pasuritë e trashëgimisë natyrore dhe

HYRJE

Turizmi është një nga veprimtaritë më komplekse të shoqërisë së sotme moderne. Në vendet e zhvilluara, por edhe në disa shtete në tranzicion, është produkt i rëndësishëm eksporti dhe gjenerator i punësimit. Përfshin një gërshetim të gjerë dukurish dhe raportesh që lindin gjatë kohës së udhëtimit turistik, ndërsa në realizimin e tij futet thellë jo vetëm në aspektin ekonomik, por edhe në aspektin ekologjik, social dhe kulturor të jetës. Duke qenë se turizmi dhe kultura janë parë si dy koncepte të përafërta, në këtë punim diplome do të paraqes një strategji të bashkangjitur me një plan veprimi që ka si synim që Kosova të shndërrohet në një destinacion turistik duke shfrytëzuar jo vetëm atraksionet natyrore por dhe vlera të shumta të traditës dhe kulturës.

Promovimi i balancuar i turizmit kulturor nga autoritetet vendore mund të ketë efekt të dobishëm në komunitet. Turizmi kulturor është industri e zhvilluar në gjithë Evropën; qytetet historike, ngjarjet kulturore

=====

dhe ato artistike tërheqin vizitorë në shifra në rritje. Dobitë për autoritetet vendore janë të qarta: rritja e prosperitetit, përmirësimi i mundësive për punësim, zgjerim i mundësive në dispozicion të banorëve, efektet e dobishme në formë kaskade në industrinë e ndërtimit, në zejtarinë e specializuara dhe, mbi të gjitha, shtimin e njohurive dhe respektit të dyanshëm të kulturave dhe komuniteteve të ndryshme. Megjithatë, përfitimet e tilla mund të sigurohen dhe efektet negative mund të shmangen vetëm përmes formimit të një plani për menaxhimin turistik dhe kulturor, i cili të përfshijë ngushtë banorët lokal, sektorin privat, përfaqësuesit e industrisë turistike dhe autoritetet vendore. Duke ditur se Kosova ka një trashëgimi të pasur kulturore dhe një gërshetim të kulturave të ndryshme fetare atëherë mendoj se zhvillimi i kësaj forme të turizmit (turizmit kulturor) do të tërhiqte tërhiqte një numër të madh vizitorësh

1.1 Objekti i hulumtimit.

Punimi përqendrohet në përkufizimin e sistemit të tregut, ndërsa pjesa praktike ka të bëjë me tregun e ndërmarrjes Hoteliere dhe produkteve të reja. Në hyrje të punimit është paraqitur objekti i studimit ndërsa përmes hipotezës përcaktohet arsyea dhe qëllimi i hulumtimit, të punuara me metodat e përdorura gjatë hulumtimit shkencor në analiza dhe përpunimin e të dhënave si dhe kontributi shkencor i pritur. Në pjesën e dytë. Hulumtohet tregu në teorinë ekonomike, kuptimi dhe rëndësia e tregut, faktorët që formojnë tregun, funksionet e tregut dhe klasifikimi i tregut. Në këtë kapitull, rëndësi të posaçme i jipet shpjegimit të tregut duke filluar nga kuptimi dhe kriterët e klasifikimit të tregut, tregu sipas *numrit të Turistave dhe* blerësve, tregu sipas veprimit të ligjit të ofertes dhe të kërkesës, tregu sipas vendit hapësirës gjeografike ku këmbëhet malli.

1.2 Qëllimet e hulumtimit

Qëllimi i këtij punimi qendron në njohjen me tregun e produkteve të reja hoteliera përparësitë dhe vështirësitë që ka patur, i ka dhe do t'i ketë në të ardhmen për t'i arritur qëllimet që kanë bizneset në ekonominë e tregut. Arritje e qëllimeve të ndërmarrjeve hoteliere kërkon që të rritë potencialin e saj Sherbyes duke u bazuar në resurset njerëzore dhe materiale dhe në këtë mënyrë, të shtohen dhe të intensifikohen aftësit konkurruese në treg. Kjo arrihet me zhvillimin e ndërmarrjes duke shfrytëzuar të aritura tekniko-teknologjike për avansimin e sistemeve Sherbyese të cilat do të mundësojnë prodhimin dhe plasimin e produkteve cilësore, konkurruese tregun e brendshëm dhe atë jashtëm

1.3 Metodat e hulumtimit

Në hulumtime shkencor dhe prezantimin e rezultateve të punimit, me kombinime të përshtatëshme përdoren shumë metoda shkencore, nga të cilat më të rëndësishmet janë metoda e analizës dhe sintezës, metoda induktive dhe deduktive, metoda e gjeneralizimit, metoda e argumentimit, metodat komparative, dhe descriptive (përshkruese), metoda matematike dhe statistike si dhe metodat e sistematizimit dhe klasifikimit. Të dhënat për analizë janë marrë nga nismat e Hoteliere MTI- is. Enti statistikorë i Kosovës. Oda ekonomike e Kosovës.

2.0 Synimet e zhvillimit ekonomik ne komunën e Istogut

Shikuar nga aspekti turistik Kosova është një vend në zhvillim. Pas 10 vjet ngecjeje në zhvillim dhe në izolim në periudhën 1989-1999, shkatërrimeve gjatë luftës së viteve 1997-1999, pas luftës vendi duhet të zgjidhte detyra komplekse: oferta e tij duhet të përcjellë zhvillimin ndërkombëtar, përsëri duhet ta definojë pozitën e vet, t'i rritë të hyrat, ta ruajë potencialin dhe resurset. Njëkohësisht duhet ta zbatojë procesin e vështirë të transformimit në të gjithë segmentet e ekonomisë dhe të jetës.

Kjo detyrë vështirësohet, sepse tregjet ndryshojnë. Të gjitha destinacionet në rajon dhe më gjerë i pret një konkurrencë më e forte dhe luftë e ashpër për pjesën e tyre në treg. Kështu e përmirësojnë cilësinë e hoteleve, të shërbimeve dhe të infrastrukturës. Tregjet diversifikohen dhe rishfaqen duke u kapur për trashëgiminë kulturore-historike dhe kujdesen për të. Pozitë Kosovës është e dobët: mungojnë mjetet financiare, produkti i përshtatshëm për tregun dhe personeli profesionalisht i kualifikuar.

Ofertat janë të orientuara gati vetëm në tregun që ka mundësi të vogla pagimi low-Budget). Edhe më tej ky mbetet tregu kryesor, meqë ende mbetet të bëhet shumë punë që të krijohen produkte cilësore. Dobësitë emonostukturës i rrit edhe fakti se hotelet janë ndërtuar sipas kriterëve impersonale të funksionimit. Momentalisht kërkesat turistike në Kosovë janë të lidhura me mysafirëtvendës dhe të huaj. Vendet fqinje, dhe ato nga rajoni që janë në procesin e transformimit, mund të bëhen të rëndësishme në të ardhmen. Grupi më i madh i turistëve me të ardhura të vogla në ato vende momentalisht nuk mund t'i marrim në konsideratë për shkak të infrastrukturës së dobët të rrjetit rrugor dhe udhëtimit të gjatë me automjete. Pakot charter ata me siguri nuk i paguajnë dot. Ata që kanë mundësi më të madhe pagese kërkojnë destinacione më ekskluzive. Numri i shtretërve ka rënë nga 8.000 në rreth 6.000. Nuk ekzistojnë më tregjet e ish-Jugosllavisë.

=====

Kërkesat lidhen vetëm me vizitorë që zyrtarisht vizitojnë Kosovën ose shkojnë nga Kosova. Të ardhurat e ulëta, plotësimi i dobët dhe gjendja që nuk u përgjigjët mysafirëve me kërkesa më të mëdha, janë karakteristikë e hoteleve. Vetëm rreth 1.000 shtretër hotelesh janë të përshtatshëm për ofertë në tregun e jashtëm. Mbi këtë bazë nuk mund të krijohet ekonomia e përparuar turistike, sidomos jo në turizëm modern. Nga atraktiviteti dhe konkurrenca e ekonomisë turistike kosovare varen vendet e punës dhe mirëqenia, jo vetëm e një pjesë të konsiderueshme të popullsisë, por edhe përparimi i fuqisë ekonomike të vendit në përgjithësi. Tani ekonomia turistike e Kosovës gjendet në një situatë tepër të vështirë, sepse: hotelet e sektorit shoqëror që kanë rreth 70% të shtretërve në Kosovë janë të vjetër, në gjendje të keqe dhe të pajisur jo mirë, kanë qenë, por edhe tani janë të orientuar në turizmin transit dhe afarist që ka për bazë çmimet. Është I vogël numri I mysafirëve në hotelet në pronësi shoqërore (objektet për kohën e lirë, alternativat gastronomike etj.), as më heret e as tani Kosova nuk e ka ndërtuar imixhin e saj turistik, shitja efikase vendore është pak ose aspak e pranishme sinstrument marketingu ose Menaxhmenti i hoteleve nuk orientohet as në konkurrencë e as në ekonominë e tregut dhe nuk ka sisteme moderne komunikacioni dhe informacioni.

2.1. Popullsia shikimi I pergjithshem

Sipas regjistrimit të vitit 1981, Istogu kishte 50.011 banorë. Duke u mbështetur në shkallën vjetore të shtimit të popullsisë 2.2% në vit, Komuna e Istogut vlerësohet të ketë 64.342 banorë, me një dendësi të popullsisë 142 banor/km². Struktura e popullsisë sipas moshës:

0 – 14 vjet	22 %
15 – 65 vjet	66 %
mbi 66 vjet	12 %

Në strukturën e popullsisë së Istogut dominon mosha e re me pjesëmarrje 52-55% të grup moshave 0-18 vjet dhe 18- 25 vjet. Madhësia mesatare e familjeve llogaritet të jetë 5 anëtarë. popullsia në moshën e punës, si p.sh. personat e moshës në mes 15 dhe 64 vjeç, që përafërsisht cakton kufijtë e potencialit të fuqisë punëtore në dispozicion. Në Istog , kjo shifër sipas AFP-së të ESK-së të vitit 2007 dhe ishte 63.7%.

Në figurën e mëposhtme keni paraqitur grafikisht strukturën e popullsisë në bazë të grupmoshave

Fig.1. Struktura e popullsisë 2009

Nga grafiku i mësipërm shohim se popullsia e Istogut e karakterizon mosha shumë të re pothuajse një të tretën e popullsisë (29,5 %) nën moshën 15 vjeç dhe 6.8% e popullsisë mbi moshën 65 vjeç dhe me gjithsejt 63.7 përqind, kjo dmth që 63.7 përqindëshi I popullsisë në mes të moshave 15 dhe 64 vjeçare është në dispozicion për të qenë pjesë e tregut të punës

2.2 Analiza politike ekonomike

Në këtë seksion do të diskutojmë për politikat e tregut të punës në komunën e istogut dhe ndikimin e tyre në ndryshimin e gjendjes.,Synimi më i rëndësishëm i politikave ekonomike është që të ulet shkalla e lartë e papranueshme e papunësisë, kjo është një detyrë më urgjente duke pasur parasyh nevojën për të siguruar vende pune për fuqinë tonë punëtore të re . Duke pasur parasysh të kaluarën e, siq ishte sistemi joadekuat arsimor, vitet e represionit, lufta dhe transformimi i ekonomisë, në sferën e punësimit kemi një situatë të mjaft kritike me një shkallë të papunësis që sillet rreth 39 deri 43%. Ndërsa sa I përket strukturës së punëkërkuesve ajo është shqetësuese me një shkallë mbi 60% të pakualifikuar.

Për të analizuar politikat ndikuese në tregun e fuqisë punëtore do të nisemi nga thënja ”Nëse don të i sigurosh dikujt darkën jepi peshk të hajë e nëse dëshiron ta bësh atë të pavarur dhe t’i sigurosh jetën, mësoje të zejë peshk“.Pasi që në shumë mënyra, nocioni i tregut fleksibil të punës që është shenjë dalluese në rritje e shumë ekonomive të zhvilluara të tregut dhe tipar qendror i strategjisë së punësimit të BE-së, veçmas është institucionalizuar. Përderisa ky faktor pritet të japë rezultate në aspektin afatmesëm dhe afatgjatë, kur ndërmarrjet të bëhen më garuese, në aspektin afatshkurtër.

ngarkuar me paga të ulëta dhe sistemin neglizhues të mbrojtjes sociale, sipas ekspertëve, përshkohet më shumë me rrezikshmëri se me fleksibilitet.

Gjithashtu një aspekt I rëndësishëm I politikave për krijimin e tregut fleksibil të punës janë edhe lehtësimet fiskale për ndërmarrjet vendore, pasi që Politika fiskale lidhet me veprimet e qeverisë në ndryshimin e kompozicionit të të hyrave dhe shpenzimeve publike, me qëllim të menaxhimit të kërkesës agregate për të mbajtur rritje të qëndrueshme ekonomike me punësim relativisht të lartë, pa gjenerim të inflacionit, pa rritje të borxhit publik dhe me bilanc të kënaqshëm të pagesave. Qeveria e Kosovës duhet të udhëheq një politikë fiskale ekspansioniste që do të thotë shkurtim i taksave ose rritje e shpenzimeve publike me qëllim të stimulimit të rritjes së konsumit, respektivisht rritjen e kërkesës agregate.

Kështu, me rritjen e shpenzimeve publike dhe shkurtimin e taksave, individëve dhe firmave u lihet një sasi më e madhe parash për t'i shfrytëzuar në shpenzime konsumi ose investime. Kjo ndikon drejtpërdrejtë në rritjen e punësimit dhe shtimin ekonomik. Megjithatë edhe pse janë bërë lehtësime doganore për ndërmarrjet prodhuese vendore të cilat janë gjeneruesi më I madh I vendeve të punës parpseprap shkalla e lartë e tatimeve paraqet penges për zhvelimin e këtyre ndërmarrjeve të cilat kanë ndikim direkt .Pastaj stimulimi i zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Kosovë është njëra ndër politikat ekonomike e cila ka krijuar një ambient të përshtatshëm për themelimin e ndërmarrjeve konkurente .Studimet e bëra nga Ministrisë së punës kanë vënë në pah katër shtylla kryesore të cilat duhet të bëhen prioritet i politikës me qëllim të realizimit të politikës active të punësimit në Kosovë e cila parashihte tregun fleksibil të punës si . çelës në krijimin e vendeve të punës për rritjen e punësimit, Nga e tërë kjo që u tha për karakteristikat ne komunën e Istogut konkludojm se shkalla e lartë e papunësis është rezultat I ekonomisë jo të zhvilluar në të cilën në masë të madhe ndikon mosfrytëzimi I fuqis punëtore të cilën e disponojmë.

Konkluzion

Meqë GDP rritet me rritjen e angazhimit të faktorëve të prodhimit dhe me shfrytëzim më të mirë të tyre, atëherë ndër masat e politikës fiskale në drejtim të nxitjes së shtimit ekonomik mund të numërohen ato që kanë ndikim në rritjen e produktivitetit të punës dhe shfrytëzimin më të mirë të kapitalit, në përparim teknologjik dhe shfrytëzim më të mirë të faktorëve të prodhimit, si:

- Stimulimi i investimeve përmes lehtësive tatimore;
- Subvencionimi i sektorëve të ndryshëm ekonomik;
- Rritja e investimeve të infrastrukturës;
- Nxitja dhe rritja e investimeve në kërkime, edukim dhe trajnim;

=====

- Heqja e rregullimit të tepërt i cili mund të pengoj zgjerimin e bizneseve.

Pastaj ekzistimi i dallimeve të dukshme ndërmjet: (i) GDP-së dhe konsumit, (ii) kursimeve dhe investimeve vendore, (iii) nevojave për investime publike dhe kapacitetit të buxhetit, (iv) eksportit dhe importit, dhe (iv) papunësisë dhe nivelit të investimeve dhe zvoglimi I këtyre dallimeve duhet të bëhen prioritet të politikbërësve. Istogu duhet të krijoj e politika favorizuese për tërheqjen e kapitalit të jashtëm, sepse duke u nisur nga përparësitë që ofron, Istogu ka mundësi që ajo të bëhet treg mjaft atraktiv për investitorët e jashtëm,. Orientimi strategjik i ekonomisë duhet të jetë politika shtetërore e favorizimit të zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla e të mesme, që do të mundësonin rritjen e punësimit të rinjëve. Reformimi I sistemit arsimorë në mënyrë që të prodhonte kuadro të cilat do të ishin konkurent të tregjet regjionale do të ndikonte në mënyrë të dukshme në zvoglimin e shkallës së papunësis duke eksportuar fuqi punëtore jasht vendit.

Kjo është një gjë serioze dhe kërkon që ministrinë përkatëse të merren më seriozisht me zhvillimin e politikave që do t'i profilizojnë të rinjtë, do ta profilizojnë arsimimin e tyre, që do të jetë i përshtatur me ekonominë e vendit dhe me kërkesën momentale.

Normalisht, duhet të ndërmerren politika të posaçme, që në mënyrë më specifike t'i adresojnë të rinjtë dhe papunësimin e të rinjve. Sipas studimit "Towards a Kosovo Development Plan", të përgatitur nga John Bradley dhe Gerald Knaus nga Iniciativa evropiane për stabilitet, çdo person i punësuar në Kosovë, është i obliguar të mbajë gjashtë anëtarë të familjes. Në këto rrethana, kursimet për investimet e biznesit janë jashtëzakonisht të vështira

Përshtatja e sistemit arsimor kërkesave të tregut të punës është një lëmë që duhet elaboruar më tutje nga kompetentët e arsimit. Aktualisht Kosova ka nevojë për shumë profile kuadrosh, por sistemi i arsimit sikur ndjehet i vonuar së tepërmi në krijimin e kuadrave deficitare.

Në mungesë të zhvillimit ekonomik ne komunën e Istogu për kohë të gjatë, në mungesë të punësimit pjesë të konsiderushme të pupullësisë kanë migruar dhe vazhdojnë të migrojnë në vendet e zhvilluara perëndimore. Ata me punë të palodhshme kanë krijuar një kapital të konsiderueshëm dhe posa tu ofrohet shansi, janë të gatshëm të investojnë atë kapital për hapjen e bizneseve të tyre.

Reformimi i politikës fiskale për të mbështetë përmirësimin thelbësorë të qeverisë për stimulimin e konkurrencës, përmes regjimi i taksave me tarifa të ulta dhe një bazë të gjërë duhet të ruhet edhe pse kjo do të vinte një barrë të rëndë në politikën e shpenzimeve publike. Politikat ekonomike duhet të jenë të drejtuara në kontrollimin dhe menagjimin e

=====

buxhetit që është çelës për uljen e shpenzimeve dhe ushqyerjen e krijimit të vendeve të punës në sektorin privat; në këtë kuptim, rrjeti i sigurisë sociale duhet të përqëndrohet vetëm te ata që kanë më së shumti nevojë; dhe punësimi në shërbimin civil të limitohet në atë që nevojitet për plotësimin e funksioneve thelbësore të qeverisë. Do të ishte thelbësore që të rritet produktiviteti nëpërmjet konkurrencës dhe investimeve në sektorin privat, që do të mbështetet me përpjekjet e vazhdueshme për të përmirësuar infrastrukturën fizike nëpërmjet investimeve publike.

3.0 Objektivat e zhvillimit dhe ndikimi ekonomik

Në këtë seksion do të diskutojm gjendjen e të papunëve në komunën e Istogut duke u bazuar në disa karakteristika si dhe në disa faktor dhe kushte të cilat janë specifike për papunësinë. Sipas statistikave të publikuara në raportin e performances të Departamentit për Punë dhe Punësim (DPP) të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenjes Sociale të Qeverisë së Kosovës numri i përgjithshëm i punëkërkuësve të regjistruar si të papunë në zyrat e shërbimeve publike të punësimit në Kosovë është 8534 persona deri në fund të periudhës 06/2009,

Ky numër paraqet një shkallë të regjistrimit të papunësisë mesatarisht rreth 39-41% duke përfaqësuar një ngritje për 0.8% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2008 që ishte 5942 dhe një rritje për 1.2% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2007 kur ky numër ishte 4598. Problemet kryesore gjatë analizimit të karakteristikave të Tregut të punës në komunën e Istogut na paraqitet në diferencat në shifra të cilat na paraqiten nga publikime të ndryshme të institucioneve të cilat merren me analizimin e tregut të punës .

Dallimet në këto publikime do të paraqesim në tabelën e mëposhtme

Burimi		Viti I references	Shkalla e papunësisë
IOM 05/2000	DHS	2000	50%
ESK 03/2004	AFP 2001	2001	57%
UNDP	UNDP KHDR	2001	50-55 %
ESK	LFS 2002	2002	55%
Riinvest 01/2003	AFP	2002	39-49 %

3.1 Aspeti i përgjithshëm i punësimit

Shpërndarja e personave të punësuar sipas aktivitetit ekonomik karakterizon strukturën e ekonomisë dhe ndryshimet e saja në kohë, kjo

=====

shpërndarje mund të tregoj rritjen ose zvogëlimin e gjasave të punësimit dhe zhvillimit..

Fig.2, Përqindja e punësimit në vite

Nga grafiku shohim se niveli i punësimit në Istog raporti me numrin e përgjithshëm të popullsis pas përfundimit të luftës në Kosovë ka shënuar rritje e kjo kryesisht i referohet zhvillimit të sektorit privat.

3.2 Punësimi sipas sektorve

Sipas sektorit të turizmit Sektori (shërbimeve Hoteliere) mban pozicionin e vet dominues ne aspektin e punësimeve duke korresponduar me luhatje sa u përket krijimit të vendeve te lira që bëjnë që të ndryshon struktura e përgjithshme e punësimit në komunën e Istogut

Fig.3. Punësimi sipas sektorëve

=====

Me gjithë moshën e re të popullsisë e cila është mesatarisht 24 vjet papunësia që është kategori administrative që matë numrin e atyre që aktivisht kërkojnë punë por nuk kanë arritur ta gjejnë atë dhe në anën tjetër në vend që të kontribuojnë në shtimin e GDP ata kanë ndikuar që të shtohet presioni mbi fondet sociale, që paraqet barrë për zhvillimin ekonomik të Istogut në shumë aspekte. Këtu kryesisht pritët zhvillimi i turizmit transit dhe afarist e më vonë edhe të turizmit bujtinar në Kopaonik dhe Makna-Gorë. Qendër e rajonit është Mitrovica. 5. Rajoni Turistik i Moravës së Epërme më pak i rëndësishëm për zhvillimin e turizmit në Kosovë, sepse nuk ka vlera të jashtëzakonshme natyrore dhe shoqërore dhe gjendet jashtë rrjedhave kryesore turistike.

3.3 Ndikimi i turizmit ne punsim

Turizmi i kulturës, i aventurës dhe “ekotourizmi” konsiderohen të jenë tregjet me rritje më të shpejtë të turizmit në mbarë botën — 15 deri 20% për vit dhe që përfaqësojnë me shumë se 25% të tregut. Vendet fqinje si Mali i Zi, Shqipëria, Greqia, Turqia dhe Kroacia i kanë fokusuar përpjekjet e tyre në turizmin e diellit dhe të rërës, duke rënduar më tej një treg turizmi tashmë tejet të ngarkuar. Kosova ka një mundësi unike për të diferencuar veten nga fqinjët dhe për të mënjeluar një treg të mbipopulluar me të ardhura dhe përfitime në rënie.

Vlen këtu të apostrofohet se, metoda e subordinimit, si metodë primare është e përfaqësuar në ndërvënien e marrëdhënieve juridike – ekologjike brenda shtetërore. Metoda e koordinimit ndërkaq, aplikohet në procesin e ndërtimit dhe avancimit të rregulativës ndërkombëtare – juridike të së drejtës ekologjike. Kjo duhet bërë në përputhje të plotë me rregullat e konventës së Vjenës për të drejtën kontraktuese nga viti 1972.

Me norma juridike të së drejtës ekologjike, shtetet e ndryshme, parashohin ndërmarrjen e masave të ndryshme financiare dhe ekonomike. Këto masa (sanksione) janë të drejtuara dhe të fokusuara drejtë parandalimit dhe pengimit të ndotjes dhe dëmtimit të mjedisit jetësor. Mbrojtja e mjedisit të shëndosh jetësor, nuk realizohet vetëm me masa preventive e penguese, por edhe me masa represive, me të cilat arrihet efekti i caktuar (i planifikuar dhe dëshiruar më parë); arrihet aplikimi i sanksioneve, kundër personave fizikë e juridikë, të cilët i kanë shkelur dispozitat ligjore, për mbrojtjen e mjedisit jetësor.

3. Parimet bazike të së drejtës ekologjike

3.1. Nocioni dhe domethënia e parimeve në drejtësi

Parimet janë rregulla bazike, udhërrëfyese, direktiva, mendime udhërrëfyese ose prijëse, janë postulate për punët e caktuara, synimet dhe qëllimet e caktuara. Parimet janë kriteriume për të vepruar dhe për të gjykuar. Ato përcaktojnë metodën e qasjes realitetit, fenomeneve dhe problemeve që ndodhin në te e që janë objekt vështrimi dhe shqyrtimi. Parimet themelore e pre determinojnë dhe e determinojnë brendinë dhe veçoritë e një institute, degë të së drejtës, disiplinë shkencore; shkencës në tërësi; por edhe të drejtës në veçanti.

Kësodore edhe parimet thelbësore të së drejtës ekologjike, sit ë tilla, ia japin vulën themelore çdo institucioni të veçantë të së drejtës. Prandaj, njohja e parimeve të së drejtës ekologjike ka rëndësi dominante, sikur për kreatorin e normës juridike, ashtu edhe për zbatuesin e saj.

Ligjvënësi gjatë pregaditjes dhe miratimit të akteve ligjore, duhet të ketë parasysh parimet themelore, sepse ato janë parakusht themelor dhe qenësor, janë determinancë e tërë sistemit juridik të një vendi. Për zbatuesit e normave (rregullave) juridike, parimet themelore, nga ana tjetër janë udhërrëfytes gjatë interpretimit të atyre normave juridike.

Për të drejtën ekologjike, relevante janë ato parime, të cilat burojnë nga kushtetuta si akti më i lartë juridik i një vendi. Mirëpo, edhe parimet gjithëpërfshirëse e të plotfuqishme të shkencave natyrore. Në qarqet relevante doktrimore dhe në literaturë, më së shpeshti përmenden katër (4) parime themelore (primare) të së drejtës ekologjike:

- Parimi i parandalimit (preventivës);
- Parimi i kauzalitetit (veprimit shkak-pasojë);
- Parimi i bashkëpunimit (kooperativitetit); dhe
- Parimi i kompensimit të përgjithshëm (të barrëve të përbashkëta) (ky parim pranohet dhe aplikohet, ani që për nga esenca dhe natyra e tij specifike, ky parim faktikisht paraqet të kundërtën e parimit të kauzalitetit dhe është parimi më i ri).

Po qese parimet e sipër apostrofuara i qëmtojmë dhe detalizojmë analitikisht në perimtësi; mund të kanalizohen dhe kanalizohen nga ta edhe këto parime aksesore, sekondare apo ndihmëse të së drejtës ekologjike:

- Parimi i status quo-së (i cili nënkupton dhe kërkon ruajtjen e gjendjes ekzistuese të mjedisit, ose ndalimin e keqësimit të mëtejme të asaj gjendjeje);
- Parimi i kujdesit ose vigjilencës (precantionary principle) i cili shprehet përmes maksimës latine “in dubio pro securitate”;
- Parimi i mbrojtjes;
- Parimi i përhershmerisë (permanencës) së rregullimit të marrëdhënieve;
- Parimi i ndalimit të shmangies nga rregullat ekologjike;
- Parimi i kontrollimit të përgjegjësisë personale etj.

Shqyrtimet e mëtejme tematike do të përqendrohen në katër (4) parimet kryesore të përmendura paraprakisht.

3.2. Parimi i parandalimit

Zanafillën fuqizuese dhe avancuese, parimi I parandalimit në të drejtën ekologjike e ka nga një raport përkitazi me mjedisin të Parlamentit gjerman të v. 1976. Në këtë raport, nder të tjera thuhej:

“ruajtja e mjedisit nuk kufizohet vetëm në mbrojtjen nga rreziqet kërcënuese dhe kompensimit të dëmeve të shkaktuara. Politika preventive kërkon që të mbrohen themelet e dhantive natyrore. Për këtë janë të nevojshme masat e planifikuara për ardhmëri”. Pas kësaj kohe (viti 1976) parimi i parandalimit ka hyrë edhe në legjislacionet e shteteve të ndryshme.

Esenca e këtij parimi parandalues është të penguarit e paraqitjes ose shkaktimit të dëmeve të reja për mjedisin. Nuk bëhet fjalë për mbrojtje pasive të mjedisit, as për shpërndarjen e thjeshtë të ngarkueshmerisë së mjedisit, por para se gjithash kemi të bëjmë me veprime të planifikuara për ardhmëri. Kjo më tutje do të thotë preventivë para rreziqeve, të papriturave, të padëshiruarave; preventivë ndaj ndotjeve dhe rrezikimeve të burimeve natyrore. Do të thotë parandalim i dëmeve të reja e jo veprim pas dëmeve paraprakisht të shkaktuara. Pikërisht për këtë arsye në të gjitha legjislacionet nacionale, para kërkesave për zvogëlim, detyrimisht përcaktohet ndalesa e emisionit të agjenseve. Andaj, parimi i parandalimit përfshinë largimin kohor dhe hapësinor të rrezikut të rasteve të probabilitetit më të ulët të ndodhjes (shkaktimit të dëmit – deri te dyshimi i ekzistimit të rrezikut. Preventiva në kohën e duhur vepron në interval të gjatë kohor, për gjeneratat e reja. Ajo nuk bënë të jetë e rastit, spontane e pa studiuar dhe e pa planifikuar. Te kufizohet në prezent (në të tashmen), ajo duhet të planifikohet, të reflektohet dhe efektuohet për dhe në të ardhmen. Megjithëkëtë, janë të ndryshme veprimet e shteteve në rast të ekzistimit të probabilitetit (ndoshtashmerisë) të ndodhjes së rrjedhjes së ndaluar, përkatësisht kur ekziston dyshimi i bazuar përkitazi me ndodhjen (shkaktimin) e rrezikut. Shumica e shteteve, me ligjet e tyre, kanë paraparë intervenimin e tyre-qysh në rastet e ekzistimit të dyshimit të bazuar për shkaktimin e rrezikut. Ndërlidhur me këtë, parimi sekondar in dubio pro securitate vjen në shprehje si parim i veçantë, brenda parimit të përgjithshëm të parandalimit.¹⁴³

3.3 Parimi i kauzalitetit (veprimi dhe shkaku-pasojë) ose (parimi i pagesës së shpenzimeve të mospastrimit ose të rrezikimit të mjedisit)

Ky parim në vete ngërthen shumë parime dhe dimensione, ngase shtrihet në disiplina të ndryshme shkencore relevante. Strumbullar kryesor

¹⁴³ Pravo okolisa (pravo zastite okolisa) – Pravna grana I interdisciplinarnski studijski predmet) fq. 21-22.

=====

dhe veçantia më specifike e këtij parimi do të duhej të ishte përgjegjshmëria e sjelljes së subjekteve të caktuara fizike dhe juridike në relacion me ambientin (mjedisin) jetësor, si dhe përgjegjësia e tyre për dëmin e shkaktuar me mospastrimin e mjedisit. Pra edhe me mosveprim. Përgjegjshmëria, kujdesi dhe përgjegjësia e subjekteve fizike dhe psikike ndërlidhur me ruajtjen, rrjedhimisht mosdëmtimin – mos rrezikimin e mjedisit, janë komponentët kryesorë të parimit të kauzalitetit në të drejtën e ekologjike.

Prandaj, esenca e këtij parimi qëndron në bamurinë se kushdo që nuk e pastron ose rrezikon mjedisin, ose edhe shkaktën dëm, duhet të paguaj shpenzimet e mospastrimit, të paguaj tatim ose tjetër formë prestacioni, ose ta paguaj dëmin, në proporcion mospastrimit e shkaktuar.. Sipas këtij parimi shkaktari (mospastrimi i mjedisit është realisht dhe financiarisht përgjegjës. Ai në fakt është i detyruar, që me sanim të pjesërishëm ose me kompensime financiare- ta evitoj mospastrimin (ndotjen) e shkaktuar të mjedisit.

Parimi “mospastruesi paguan” – për herë të parë, në planin ndërkombëtar përmendet në vitin 1972 kur shtetet anëtare të OECD-së janë akorduar se nuk do të subvencionojnë shpenzimet e masave për parandalimin dhe mbikëqyrjen e mospastrimit, por që shpenzimet duhet të bartën nga ana e mospastruesit.

Rrjedhojë pozitive e këtij parimi është se në drejtësi tani më nuk mund të flitet për të ashtuquajturat “ të mira të lira”, gjegjësisht për ato të mira, të cilat do të mund të dëmtoheshin pa sanksione.

3.4. Parimi i kooperimit – (parimi i tërësishmerisë dhe bashkëveprimit të publikut)

Ky parim nënkupton angazhimin e përbashkët, inkorporimin dhe bashkëpunimin e të gjithë subjekteve, aktorëve dhe faktorëve në mbrojtjen e mjedisit. Këto subjekte janë: shteti dhe institucionet e tij, pjesëmarrësisë ekonomike (biznesore) të transaksioneve dhe mbarë shoqëria. Në këtë mënyrë, me angazhimin, kujdesin dhe veprimin permanent dhe immanent të të gjithëve (në të mirën e të gjithëve) ruhet më mirë e më shumë mjedisi respektohet, fuqizohet dhe respektohet maksima e gjithëpranueshme mbi ndarjen e punës dhe mënyrës së veprimit e të drejtimit të shtetit demokratik të së drejtës.

Tërësishmëria dhe bashkëveprimi sipas parimit të kooperimit nënkupton aktivitetet e shumta, të përbashkëta të të gjitha subjekteve kompetente, veçanërisht të institucioneve dhe autoriteteve qendrore e lokale përmes strategjive, programeve, planeve dhe dispozitave për mbrojtjen e

=====

mjedisit; dhënies së lejeve, pëlqimeve; zbatimit të politikave financiare; zbatimit të mbikëqyrjes, si dhe të masave të tjera të mbrojtjes së mjedisit.

Sipas parimit publikueshmerisë ose të pjesëmarrjes së publikut në trajtimin e çështjeve të gjitha organizmat shtetërore – institucional, janë të detyruara që të sigurojnë pjesëmarrjen e të gjithë të interesuarve, qytetarëve etj. Në zgjidhjen institucionale të çështjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit. Shteti me institucionet e tij, për nga definicioni, roli dhe funksioni i tij, duhet të siguroj mekanizma përkatës dhe modalitete adekuate për mbrojtjen e mjedisit, qytetarit dhe të resurseve natyrore dhe vlerore. Ai këtë mbrojtje e rregullon me akte të përgjithshme dhe të veçanta juridike; përmes zhvillimit të shkencës, dijeve profesionale dhe atyre teknike-teknologjike më të avancuara.

Mirëpo, me që problemet ekologjike janë komplekse në këtë mision, pra në mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe në zgjidhjen e problemeve ekologjike, të drejtë dhe detyrime ka edhe qytetari, përkatësisht bashkësia e gjerë shoqërore. Opinioni publik sipas ligjeve tona në fuqi ka të drejtë të informohet dhe duhet të informohet me kohë, saktë dhe drejtë lidhur me gjendjen e mjedisit, shkallën e ndotjes, indikatorët, agjenset, masat që janë ndermarrur, për të evituar ndotjen etj.

3.5.Parimi i përgjegjësisë së përgjithshme – kompensimit

Ky parim bazohet në bamurinë që shteti nuk mund të lirohet nga ato detyrime, të cilat burojnë nga të drejtat kushtetuese për jetë të shëndosh dhe mjedis të pastër. Intervenimi dhe përgjegjësia e shtetit në çështje ekologjike është e nevojshme dhe imperative edhe për shkak të gjendjes së rëndë akute dhe kronike të krijuar me vite, të shtresimeve ndotëse të ambientit. Këto shtresime janë krijuar si rrjedhojë e veprimeve, afarizmit dhe menaxhimit joadekuat të resurseve dhe të mjedisit.

Në funksion të masave parandaluese dhe shëruese, në disa vende janë vu tatime të gjelbra (ekologjike) si p.sh. në Finlandë, Norvegji, Holandë, Danimarkë, Suedi. Në këto shtete autoritetet kompetente kanë instaluar tatime në emisionin e dioksidit në produkte diverse – pesticide, goma të automobilave, ambalazhe etj. Ky parim ndryshe quhet edhe – “parimi i barrës së përbashkët” ose i “Shpenzimeve të njëjta”. Sipas këtij parimi, shpenzimet për mbrojtjen e mjedisit, financohen nga buxheti – taksapaguesit.¹⁴⁴

Konkluzë

¹⁴⁴ Op. cit. fq. 25.

Në këtë punim jam përpjekur të shqyrtoj gjendjen e sistemit ekologjik si dhe efektet e saj në jetën tonë.

Mbrojtja e mjedisit jetësor po bëhet kërkesë gjithnjë e më e madhe për mbijetesën e civilizimit njerëzor. Lëvizjet e reja moderne ekologjike i vështrojnë problemet e mbrojtjes së mjedisit si çështje të lidhura drejtpësdrejt me kualitetin e jetesës.

Përdorimi i parimeve ekologjike krijon mundësi për drejtim më efikas të zhvillimit shoqëror në veçanti të atij ekonomik duke krijuar resurse njerëzore të cilat merren më zgjidhjen e problemeve të avansimit dhe mbrojtjes së mjedisit.

Shembull i mirë për këtë do të shërbente ,qëndrimi i arbitrave në rastin Internacional Joint Commission of the USA and CANADA(1909),në rastin Trail Sfetler, në të cilin rast ata (arbitrat) kanë konkluduar se, sipas parimeve të së drejtës ndërkombëtare , asnjë shtet, nuk ka të drejtë,që të lejojë në territorin e tij aktivitete të tilla të cilat shkaktojnë ndotje në territorin e shtetit tjetër.

Referencat

¹ Drenovak, Mirjana,Ekolosko pravo, strucna grupa- seminar 425. Fq. 7.

¹ Pravo okolisa (pravo zastite okolisa), pravna grana i interdisciplinarni studijski predmet, materiali pa emer e mbiemer të caktuar, fq. 4.

¹ Envirovimental law, http://en.Wikipedia.org/wiki/Environmental_law, fq.

¹ Drenovak, Mirjana,op. cit., fq. 6-9.

¹ Pravo okolisa (pravo zastite okolisa) – Pravna grana I interdisciplinarni studijski predmet) fq. 21-22.

¹ Op. cit. fq. 25.

=====

KUD 574

NDIKIMI I INSTRUMENTEVE TË JASHTME EKONOMIKE NË FUSHËN MBROJTJES EKOLOGJIKE

*MSc. Shqiponja Nallbani Ass.¹⁴⁵
shqiponja.nallbani@uni-pr.edu*

Abstrakt

Punim ka për qëllim të theksojë domosdoshmërinë e ndërhyrjes së shtetit në fushën e rregullimit ekologjik të vendit nëpërmjet zbatimin e instrumenteve të duhura ekonomike. Aktualisht kur efektet e ndryshme dhe të shumta të jashtme të çojë në shpërndarjen jo efikas të burimeve natyrore, zbatimi i instrumenteve të përshtatshme ekonomike siç janë si forma të ndryshme të sanksioneve, taksave, subvencionet dhe lejeve konsiderohen me rëndësi vendimtare. Reduktimi i vëllimit të prodhimit, ndryshime në metodat e prodhimit, ndryshimi i inputeve , futja nën kontroll e ndotjes, janë mënyra të ndryshme për të arritur qëllimin e domosdoshëm në reduktimin e ndotjes së mjedisit. Instrumentet specifike ekonomike janë pasqyruar në faktin se shpenzimet subjektive dhe ndikimi në mjedisit zakonisht janë të miratuara. Prandaj, çështja e zgjedhjes së instrumenteve optimale dhe zbatimi i tyre do të kenë impakt në procesin e rishpërndarjes. Pa marrë parasysh se cila formë e rregullimit do zbatohet, shteti do të ketë një rol dominues gjetjen dhe zbatimin e instrumenteve pozitive ekonomike.

Fjalët kyçe: Ekologji , zhvillimin e qëndrueshëm, efektet e jashtme, instrumenteve ekonomi

Hyrje

Proceset e vazhdueshme të riprodhimit në botën moderne kur njerëzit janë bërë të vetëdijshëm për nivelin e ndotjes së ambientit jetësor domosdo kërkojnë trajtime të përshtatshme të mjedisit natyror. Andaj, krijimi i politikave të përbashkët që realisht respektojnë parimet e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, tregojnë domosdoshmërinë e ndryshimit të mentalitetit biznesor që do reflektojnë në dinamikën e zhvillimit ekonomik, social, mjedisor dhe institucional duke i përfshirë edhe nënsistemet tjera. Në këtë punim, theksi është dhënë për rolin që ka modeli tani më të njohur "Eco – Eko", që përfshinë dhe rregullon lidhjen mes marrëdhënieve ekonomike

¹⁴⁵ Autori është mesimdhënes në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara në Biznes, Universiteti I Prishtinës – Peje

=====

dhe të mjedisit. Në kushtet e zhvillimit të qëndrueshëm, marrëdhëniet në mes të ekonomisë dhe ekologjisë "Eco – Eko", theksi është dhënë në bazë të perceptimeve të mjedisit si një burim i burimeve për aktivitetet ekonomike, si dhe marrësit respektivisht menaxhuesit dhe menaxhimit të mbeturinave. Duke qenë të vetëdijshëm se aktivitetet ekonomike janë heterogjene, në kushtet moderne të prodhimit, në shumicën e rasteve rezultojnë një shumëllojshmëri të mbetjeve nga procesi i prodhimit që kanë efekte serioze të jashtme negative. Andaj, vetvetiu shtrohet pyetja se çfarë duhet bërë? Për fat të keq, një nivel social efektiv i prodhimit është shpesh më i ulët se niveli efikas të prodhimit privat, për faktin se aspektin i efikasitetit social përfshijnë kostot e ndotjes së mjedisit. Në këtë kontekst masat e shtetit në lidhje me mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet instrumenteve të përpunuara ekonomike patjetër të kenë disa efekte pozitive.

Në kushtet aktuale kompleksiteti i tregut shpesh është në gjendje që t'i determinojë ndarjet efikase të resurseve natyrore. Për të ndërhyrë në këtë ndarje, respektivisht për të rregulluar sado pak kjo ndarje, duhet siguruar mjete respektivisht politika e instrumente ekonomike efikase. Botëkuptimet dominuese të teoricienëve fokusohen në faktet se nëpërmjet të mekanizmave të ngjashëm mund të sigurohet një sjelljen e efektshme si në tregun privat ashtu edhe në publik. Detyra e taksave mjedisore dhe mekanizmave të tjerë të ndikimit në treg pasqyrojnë qartë efektin e pa përsosmërisë së tregut, e në anën tjetër zbatimi i tyre efikas ndikon në mënjanimin e akuzave e të ndryshme në mënyrë që realisht të reduktojnë prodhimin dhe konsumin e produkteve ekologjikisht të dëmshme, apo zvogëlimin e ndotjes në nivele që janë konsideruar "të qëndrueshme".

Efektet dhe pasoja e jashtme të aktivitetit ekonomik

Ndotja e mjedisit, kryesisht ajo e ajrit dhe ujit, nga ekonomistët perceptohet si fenomen që prodhon efektet të jashtme. Ato janë rezultat i veprimit të mekanizmit të tregut të papërsosur. Në planin ideal, tregu lejon që ekonomia të jetë "Binom – efikase" por në fakt ajo ka arritur aktualisht të jetë "Binom – optimale." Ekonomia sipas logjikës "binom – efikas" konsiderohet kur dikush të mos jetë në fitim deri sa dikush tjetër të jetë në humbje, që do të thotë se ekonomia duhet që të funksionojë pavarësisht nga kurba të mundësive të prodhimit. Kur bëhet fjalë për shpërndarjen e burimeve (kohës dhe burimeve natyrore), askujt nuk mund që t'i përmirësohet pozicioni duke ua keqësuar gjendjen palës tjetër. Nga ana tjetër, përmes tregut (për shkak të kërkesës dominuese), shpesh në sasi të tepruar mund të prodhohet diçka që rezultojnë në ndotjen e ajrit dhe të ujit.¹⁴⁶

¹⁴⁶ R.H. Coase, „The Problem of Social Cost“, Journal of Law and Economics 3, 1960, pp. 1 – 44.

=====

Aktivitetet e një personi apo të ndonjë kompanie kanë ndikim të drejtpërdrejt ose të tërthorët në persona të tjerë fizikë dhe juridikë. Kjo ndodh kur aktiviteti ekonomik (qëllimi përfundimtar i të cilit është maksimalizimi i fitimit mbi kapitalin e investuar) nuk ka mjete për të kompensuar kostot e imponuara nga një kompani tjetër, ose kur një kompani pa kompensim për dëmin që ia shkakton palët tjetër arrin që të sigurojë përfitime. Një rast konkret është ndotja e ujit dhe ajrit. Për shembull: kur një fabrikë shkarkon materie të kimikateve në një lumë aty pranë, automatikisht ndikon në rritjen e kostove të trajtimit të ujit përgjegjësi kjo e një kompanie të përpunimit të ujit të pijshëm. Këto janë efekte negative të jashtme.¹⁴⁷ Në të kundërt, efektet pozitive të jashtëm konsiderohen aktivitetet e subjekteve që ofrojnë përfitime edhe për të tjerët: p.sh. ndërtimi i një kopshti të pasur mund të jetë një efekt pozitiv për bletarët e një lagje.¹⁴⁸

Në raste të tilla, alokimin e burimeve të cila automatikisht ofrohen në treg nuk do të jetë e mjaftueshme. Duke e pasur parasysh që kostot e efekteve negative të jashtëm të shkaktuara nga aktiviteti i tyre ekonomik nuk matën në mënyrë të plotë, atëherë individët dhe bizneset do të vazhdojnë të zhvillojnë aktivitetin e vetë biznesor në këtë drejtim. Meqë nuk janë të vetmit përfitues të efekteve pozitive të jashtëm, ata janë të gatshëm të ndërmarrin aktivitete që do të shkaktojnë efekte pozitive. Prandaj, pa një formë e ndërhyrjes së shtetit, shkalla e kontaminimit të mjedisit do të jetë shumë e madhe dhe aktiviteti i këtyre subjekteve nuk do të jetë në nivelin e duhur.

Çështje e veçantë konsiderohet problemi i burimeve të përbashkëta, për faktin se këto përfaqësojnë ekosistemin e burimeve të kufizuara me qasje të pakufizuar. Kur toka është pronë e përbashkët të gjithë mund t'i kullojnë bagëtisë. Pasi që askush nuk ka të drejtë të pronësinë mbi tokën, askush nuk ka një nxitje të kujdeset për të shmangur mbingarkesën që mund të ndodh. Në vendet në tranzicion, çështja e pronës e cila nuk ka qenë e përcaktuar, ka çuar në situatën kur popullata nuk ishte e motivuar sa duhet jo vetëm përmirësimin e cilësisë së mjedisit por edhe përmirësimi i faktorit të prodhimit. Në ekonominë e tregut, shfrytëzimi i të mirat të tilla pozitive pasqyrohen vlerë në tregun e pasurive të caktuara apo faktorët tjerë të prodhimit. Nga ana tjetër, që të jemi në gjendje për të kryer çdo transaksion, është e nevojshme siguri dhe zbatimi i kontratave të nënshkruara ose marrëveshjeve të tjera. Nëse nuk arrihet që të rregullohet mbrojtja e pronës private, respektimi i marrëdhënieve kontraktuale, përcaktimi i pronës dhe të drejtat që dalin nga kjo pronë është e vështirë që të funksionojnë ligjet dhe

¹⁴⁷ Raste të tilla ka në një numër të madhe dhe në qytetin e Pejës respektivisht respektivisht përgjatë lumit në regjionin e Rugovës janë ndërtuar një numër i caktuar restorantesh të cilat ujërat e zeza i shkarkojnë në lumin bardh.

¹⁴⁸ Po aty

parimet e një ekonomie të tregut mbi parimet e qëndrueshme. Problemet e efekteve negative të jashtme shpesh mund të kapërcehen duke përcaktuar të drejtat pronësore, sepse aty i mundëson pronarit të drejtën për të kontrolluar shfrytëzimin e burimeve dhe për të mbledhur pagesat për përdorim.

Në disa raste, tregjet private mund të zgjidhin problemin e efekteve të jashtme pa ndërhyrjen e shtetit. Mënyrë optimale për ta bërë këtë është internalizimi i efektet e jashtme. Sipas teoricienit Kousa Teorema¹⁴⁹ i cili është i bazuar në pohimin se, kur ka efekte negative të jashtme palët e prekura mund të organizojnë dhe të bëjë marrëveshje mbi bazën e të cilave do të sigurojë efikasitet dhe efektet e intrernalizimit të jashtëm. Shuma e kompensimit për të shkaktuar efekte të jashtme do të ndikojnë në pasojat shpërndarëse së tyre. Në mënyrë që të reduktohen pasiguritë në lidhje me shumën e kompensimit për ndotjen ose përdorimin e tepruar të burimeve, shteti mund që më saktësi të specifikojë llojin dhe sasinë e shpenzimeve që në këtë rast mund të vendosen por të ardhurat nga këto aktivitete duhet të përdoret për restaurimin e ekosistemeve të rrezikuara. Legjislacioni amerikan (e bazuar në të drejtën zakonore) nuk lejon një palë të dëmtojë palën tjetër në qoftë se nën veprim "dëm" përfshihen një seri kostosh ekonomike të shkaktuara nga një seri aktivitete të imponuara.

Roli dhe rëndësia e instrumenteve ekonomike

Qëllimi për të konkretizuar realizimin e mbrojtjes mjedisore mbi bazën e një zhvillimi të qëndrueshëm në mënyrë të pashmangshme ngre çështjen e përzgjedhjes së instrumenteve specifike ekonomike. Instrumentet e drejtimit të njësisë ekonomike për internalizimin e kostos mjedisore ose koston e përmirësimit të burimeve natyrore, në instancë të fundit duhet të jenë ekonomikisht reale dhe të përshtatshme. Duke i përdorur këto instrumente nuk veprohet drejtpërdrejt në aplikimin e teknologjive të ndryshme ose të standardeve mjedisore, por tentohet që nëpërmjet instrumenteve ekonomike të korrigjohet ose përmirësohet gjendja mjedisore e cila është shkaktuara nga tregjet jo të rregullta dhe shfaqjen e mbetjeve.

Kërkesa pasqyron përfitimet margjinale që një individ merr nga prodhimi marginal për njësi të mallit dhe të ofrojë një refleksion të koston marxhinale të prodhimit të kësaj njësie shtesë. Në kryqëzimin e kurbës së kërkesës dhe kurbës së ofertës, përfitime margjinale janë identike me kostot margjinale të prodhimit. Në rastin e prodhimit të shkaktuar nga ndodhja e efekteve të jashtme, kurba e ofertës nuk do të reflektojnë kostot sociale por shpenzimet përballohen direkt nga prodhuesit. Në vlerësimin e përfitimit së bashku me rritjen e prodhimit është e nevojshme që të merren parasysh edhe

¹⁴⁹www.ied.org/htm, "International Energy, Agency Monthly Oil Report", juni 1998, tab 9

shpenzimet tjera të përgjithshme të tjera.. Për të eliminuar këto pasoja ekonomike që krijojnë efekte anësore, ekzistojnë tri lloje të zgjidhjeve të tregut.¹⁵⁰

- 1) Gjobat dhe Taksat;
- 2) Subvencionet për të ulur nivelin e ndotjes; dhe
- 3) Lejeve të transferueshme;

Gjobat dhe taksat. Kur ka një dallim midis përfitimeve private dhe sociale, atëherë ka një dallim edhe në mes të shpenzimeve private dhe shoqërore. Në këtë rast në mënyrë automatike këto reflektojnë edhe efekte të ndryshme të jashtme. Mënyra më e mirë e rregullimit të efektet e jashtme në treg duhet realizuar nëpërmjet shqiptimit gjobave dhe taksave. Shumën e përcaktuar objektivisht e gjobave ose taksave kanë për qëllim të barazojnë përfitimet private, shoqërore dhe shpenzimet. Taksat kanë funksionin korrigjues për të barazuar koston marxhinale privat me kosto margjinale sociale.¹⁵¹ Në rastin e pagimit të shumës që i korrespondon me koston margjinale të ndotjes, koston margjinale private dhe shoqëror barazohen. Ndryshimi mënyrat e prodhimit qoftë si zvogëlimin apo zmadhim mund të zëvendësohet me gjobë. Në këtë rast, duke ndryshuar metodat e prodhimit apo të inputeve shkaktjnë shfaqjen e kostove të reja të drejtpërdrejta që lidhen me kontrollin e ndotjes sepse ato kanë ndikim në koston margjinale të kontrollit të rritjes së ndotjes. Kjo është esenca e ekzistencës së gjobave dhe taksave.¹⁵²

Subvencionimin e ndotjes. Veprimet e shtetit duhet të jenë aktive dhe subvencionuese në rrugën e reduktimit të ndotjes. Në vend të taksës së ndotjes, shteti është në gjendje për të subvencionuar koston e reduktimit të ndotjes. Nëse nuk do të ketë dobi të drejtpërdrejtë të zvogëlimin e ndotjes, kompania nuk është e motivuar për të investuar në kontrollin e ndotjes dhe reduktimin, në mungesë të dënimit. Nga pikëpamja sociale, investimet me sfond mjedisin janë relativisht të vogla në krahasim me përfitimet më të gjerë sociale.

Në rastin e zgjedhjes, ndotësve preferon për të subvencionuar uljen e ndotjes, por dënimi, sepse subvencionet janë koston që mbulohen nga shteti nga njëra anë, dhe të lejojë ndërmarrjet më të madh fitimi, nga ana tjetër. Duke aplikuar një sistem të dënimeve, normat specifike të prodhimit do të jetë më i lartë dhe do të ndikohet dhe të konsumatorët, sepse shpenzimet indirekte të mjedisit zhvendosur për ta. Tatimpaguesit, nga e cila subvencionet tatimore financiar, do të jenë më të interesuar në sistemin e gjobave. Sipas konceptit të subvencioneve për të ulur nivelin e ndotjes,

¹⁵⁰ Po aty

¹⁵¹ A. S Pigou, "The Economics of Welfare", London, Macmillan, 1918.

¹⁵² Ecological Footprint, Redefining progres,

prodhuesit nuk janë të ballafaquar me kostot reale sociale të prodhimit të tyre, si në rastin kur sistemi dënimi që është rasti.

Lejeve të transferueshme. Ky instrument ekonomike është duke u bërë gjithnjë e më popullore për shkak se lejon që "licencat tregtare" të jetë të transferueshme ndërmjet pjesëmarrës në konkurs. Në këto raste shteti është kryesisht i interesuar në uljen e nivelit të përgjithshëm të ndotjes, por jo nga prodhuesi për të shkaktuar në mënyrë specifike nga aktivitetet e tyre. Nëse për ndonjë arsye, kompania e redukton vëllimin e prodhimit dhe nuk e shpenzojnë "kuotën e tyre të ndotjes" është e mundur për t'i shitur të drejtat e përdorur e tyre të ndotjes nëpërmjet shitjes së lejeve të transferueshme të kompanisë për të zgjeruar prodhimin. Kompanitë do të jenë të interesuar në shitjen e licencave në përputhje me çmimet e tregut. Ndërsa çmimi i tregut të lejeve (dhe mallrave tjera) do të jetë më i madh se kostot marginale në zvogëlimin e ndotjes, atëherë kompanitë do janë të interesuara në shitjen e licencave ndërsa shpenzimet marginale të reduktimit të ndotjes do të jenë më të mëdha se çmimet e tregut të lejeve. Kompanitë do të jenë të interesuar në blerjen e licencës (sepse u lejon atyre për të rritur vëllimin e prodhimit, pavarësisht nga ndotja në rritje). Në praktikë dy çështje janë provuar si të rëndësishme për rregullimin e tregut nëpërmjet lejeve. Problemi i parë ka të bëjë me kapital fillestar për licencim. Kjo është e diskutueshme se çfarë duhet të jetë vendosur si bazë për licencimin:

- *Sasia e prodhimit* (të përdorura për të kontrolluar shiun acid në Los Angeles, 1994).¹⁵³
- *Fondet e investuara në kontroll të ndotjes* (praktika ka vërtetuar se kompani të tilla zakonisht marrin lejet e lëshuara më pak, e cila është tejet dekurajuese);
- *Futjen e teknologjisë moderne* (në këtë rast është zakonisht më e vështirë për të ulur nivelin e ndotjes, që nga futja e teknologjisë do të kërkojë investime masive).¹⁵⁴
- *Një tjetër problem lidhet me vendndodhjen e ndotësve.* Sistemit të transferueshme i lejeve jep rezultate të mira në rastin e ndotësve faqes mungesë lidhjeje. Megjithatë, ndotja e ajrit është një çështje shumë më të ndjeshme në afërsi të qyteteve të mëdha. Futur një herë lejeve të transferueshme për të kontrolluar shiun acid, nuk mjafton të marrin në konsideratë këtë problem. Pamje dominuese e ekonomistëve, është se mekanizmat e ngjashme mund të ofrojnë në treg sjelljen efektive private dhe publike. Për

¹⁵³ T. Panayotou, « Instruments of Change – Motivating and Financing Sustainable Development », UNEP, Earthscan Publication, 2004.

¹⁵⁴ www.ied.org/htm, "International Energy, Agency Monthly Oil Report", juni 1998, tab 9

=====

të korrigjuar këto pasoja, ka disa lloje të zgjidhjeve. Sipas klasifikimit të OECD-së, instrumentet ekonomike janë si më poshtë;¹⁵⁵

- a) *Tarifat dhe taksat për emisionet.* Taksat tregojnë se pagesat direkte në bazë të vlerësimeve apo matjeve reale realizohen në bazë të përqendrimit dhe llojit të emisioneve. Në vendet e Evropës jug – lindore dhe vendeve tjera në tranzicion, zakonisht janë të lidhura me madhësinë dhe numrin e prodhuesve e që është e kombinuar shpesh me dënime.
- b) *Roli i gjobave dhe taksave.* Ky instrument ka karakter lokal. Fondet e mbledhura nga kjo mënyrë duhet të përdoren për financimin e objekteve të veçanta që ndikonin në zvogëlimin e problemeve mjedisore. (p.sh. në mbledhjen dhe deponimin, trajtimin komunal të ujit të pijës dhe ujërave të tjerë, nxjerrën e lëndëve të para, për arsye gjuetie, parqe, pellgje, etj);
- c) *Dënimet.* Taksat dhe dënimet janë mekanizmat më të thjeshtë. Kur prodhimi është duke shkaktuar një efekt negativ dhe kur ka një dallim midis kostove sociale dhe private, ose të korrigjuar, fjalja e taksave nënkupton se prodhuesit janë të ballafaquar me pasojat sociale të biznesit të tyre. Qëllimi i këtij instrumenti është për të barazuar koston private dhe shoqërore dhe përfitimet. Kur pagesa prodhuesi dënimet në shumën e shpenzimeve marginale të ndotjes, kostot marginale private dhe sociale do të barazohen. Prodhues mund të zvogëlojë ndotjen duke ulur vëllimin ose metodat e prodhimit. Ndryshimet në kostot e prodhimit mund të shkaktojnë përkrahje për kontrollin e ndotjes, ose për të ndryshuar input (lëndë e parë).
- d) *Tarifat për produktet.* Produktet që shkaktojnë dëm të mjedisit gjatë prodhimit, konsumit ose në formën të mbeturinave konsiderohen barrë e vlerësuar në kostot sociale. Qëllimi është për të rregulluar çmimet relative të produkteve në mënyrë për të reduktuar kërkesat e tyre dhe shfrytëzimin e burimeve të përdorura nga metoda të modifikuara të financimit të prodhimit të cilat është ekologjikisht miqësore. Taksat për produktet mund të aplikohen për plehrat artificiale, pesticide, shishe plastike, bateri dhe më shumë.

¹⁵⁵ Pyetesori i OECD, Trupi ekzekutiv I EAP-a, «Survey on the Use of Economic Instruments for Pollution Control and Natural Resources Management in the New Independent States», Mimeo, EAP Task Force, 1999

=====

- e) *Garantimin e performancës (obligacionet e performances).* Prodhuesit dhe përdoruesit e burimeve natyrore kanë nevojshme por edhe detyrim që të garantojnë respektimin e kushteve të mjedisit. Nga detyrimet e ekzekutueshme prodhuesit garantojnë produkte të kthehet.
- f) *Dëmet (pagesat përgjegjësia).* Për funksionimin ekonomik të këtij instrumenti është i nevojshme roli i shtetit i cila ka detyrim për të krijuar dhe të garantojë të drejtën për kompensim civil për dëmin e shkaktuar përmes rregulloreve të caktuara si dhe të qeverisur fonde (fondet për ndotjen e ujit, kërcënim për fondet e biodiversitetit, fondet për derdhje të naftës, etj). Mjetet materiale të mbledhura përmes fondeve të mund të përdoret për ata që pësojnë nga ndotjes kronike dhe shtetërore të transmetimit.

Legjislacioni ne vendeve të OECD bën dallimi vërtetë të rreptë ndërmjet termit "tarifat" dhe "taksa" për përdorimin e fondeve të mbledhura nëpërmjet taksave dhe tatimeve. Për shtetin, si instrumente të sjellë të ardhura, por çështja e shpërndarjen e të ardhurave që rrjedhin ndryshe. Çështja i referohet rasteve kur pjesa dominuese e të ardhurave të dedikuara për koston dhe mbrojtjen e mjedisit (për shembull, fondet u ngritën përmes fondeve për mbrojtjen e ujit dhe mbrojtjen e mjedisit). Ardhurat e centralizuar, e cila kryesisht është e angazhuar për mbrojtjen e mjedisit, por edhe rrit taksat lokale dhe shtetërore të ardhurave është.

Legjislacioni vendeve të OECD, dallimi i vërtetë rreptë ndërmjet termit "tarifat" dhe "taksa" për përdorimin e fondeve të mbledhura nëpërmjet taksave dhe tatimeve. Për shtetin, si instrumente të sjellë të ardhura, por çështja e shpërndarjen e të ardhurave që rrjedhin ndryshe. Nadnada referohet rasteve kur pjesa dominuese e të ardhurave të dedikuara për koston dhe mbrojtjen e mjedisit (për shembull, fondet u ngritën përmes fondeve për mbrojtjen e ujit dhe mbrojtjen e mjedisit). Ardhurat e centralizuar, e cila kryesisht është e angazhuar për mbrojtjen e mjedisit, por edhe rrit taksat lokale dhe shtetërore të ardhurave është.

Përfundim

Duke pasur parasysh kompleksitetin e "Eco-Eko" marrëdhënie, çështje të veçanta të mbrojtjes mjedisore duhet trajtuar mirë që një kombinim i instrumenteve ekonomike dhe instrumenteve tjera te kenë efikasitetin e duhur për të arritur qëllimin. Duhet kujdesur që instrumentet ekonomike nuk do tëhuhet që të sjellin izolim por japi rezultate optimale dhe suksesi në zbatimin di të varet nga kombinimi i politikave shoqërues. Megjithatë, instrumenteve ekonomike me elementë të tregut në vetvete janë një shkak i tranzicionit gradual nëpërmjet të politikave mjedisore dhe

=====
 politikave në rritje përmjet përdorimin të instrumenteve ekonomike. Secila prej këtyre instrumenteve ekonomike ka avantazhet dhe disavantazhet e veta që duhet konsideruar. Andaj, ato më shumë ose më pak do të duhej të jenë përshtatshme në aplikim ose të përshtatshme për t'u kombinuar si situatat individuale, të veçanta ose të përgjithshme. Një pjesë relativisht e madhe e ekspertëve thotë se përfitimet nëpërmjet të zbatimit të këtyre politikave dhe instrumenteve mund të arrihen në rast të zvogëlimit të efekteve mjedisore të jashtme. Nëse ka një ndalimin e ndotjes së lumit në një nivel të caktuar, atëherë rezultati përfundimtar është ulja e niveleve të ndotjes. Në rastin e gjobave, niveli i ndotjes do të jetë në varësi nga kostoja e ndotjes dhe do të ketë një ndikim në mjedis. Ekonomistët që mbrojnë sistemin e shqiptimit të një dënimi në të holla, nisen nga botëkuptimi se rritja e gjobave të ndikojë në reduktimin e nivelit të ndotjes në nivelin e dëshiruar. Subvencionet për të reduktuar ndotjen ka të ngjarë të çojë në mbi – prodhimin e produkteve që shkaktojnë ndotjen duke bërë të mundur uljen e ndotjes efektiv. Megjithatë, rregullimit shtetëror lë pak vend për kompanitë vullnetarisht ulur nivelin e ndotjes nën një nivel të caktuar, ose standarde, pa marrë parasysh sa e ulët do të jetë. Implementimi i këtyre instrumenteve do t'i ballafaqojë subjektet me kosto që do të caktuara sepse ka një dallim në mes të nocionit të përfitimeve private dhe shoqërore dhe shpenzimeve. Një gjë del e sigurt se për aq kohë sa përfitimet nga uji i pastër, ajri, biodiversitetit, etj, shihet pa asnjë vlerë ekonomike por si diçka që vjen natyrshëm në situatën aktuale atëherë implementimi i këtyre instrumenteve është i detyrueshëm.

Literatura e shfrytëzuar ose e konsultuar

1. R.H. Coase, „The Problem of Social Cost“, Journal of Law and Economis 3, 1960,.
2. T. Panayotou, « Instruments of Change – Motivating and Financing Sustainable Development», UNEP, Earthscan Publication, 1998.
3. www.ied.org/htm., “International Energy, Agency Monthly Oil Report“, juni 1998
4. Pyetsori I OECD, Trupi ekzekutiv EAP-a, «Survey on the Use of Economic Instruments for Poolution Control and Natural Resources Management in teh New Independent States», Mimeo, EAP Task Force, 1999
5. J. E. Stiglitz, „Ekonomija javnog sektora“, Ekonomski fakultet u Beogradu, Beograd, 2004
6. A. S Pigou, “The Economics of Welfare“, London, Macmillan, 1918.
7. Ecological Footprint, Redefinding progres,

=====

KYD 336.64

STRUKTURA E NDËRMARRJEVE TË REJA TË THEMELUARA NË 3 VJETËT E FUNDIT NË KOMUNËN E PEJËS DHE NDIKIMI I TYRE NË EKONOMI

*Sokol Domniku
sokol.domniku@uni-pr.edu
Mirjeta Domniku
mirjetadomniku@gmail.com*

Abstrakt

Një nga segmentet kryesore që e karakterizojnë Komunën e Pejës, është numri i lartë i firmave të biznesit që veprojnë në të. Tradita nga njëra anë, mirëpo në anën tjetër edhe nevojat dhe iniciativat e ndërmarrësve të rinj për të krijuar biznese të reja ose për ti zgjeruar aktivitetet e tyre afariste, ndikon që Komuna e Pejës dita ditës të e rrisë numrin dhe llojshmërinë e aktiviteteve të biznesit. Punimi do të përshkruajë aspektet teorike të natyrës dhe karakteristikave kryesore të biznesit, duke marrë shembuj konkret për bizneset ekzistuese që operojnë në tregun e Komunës së Pejës. Poashtu përmbajtja e punimit do të ofrojë të dhëna të sakta statistikore, që tregojnë për numrin e saktë të bizneseve të regjistruara gjatë tri viteve të fundit, si dhe identifikimin e strukturës së firmave që i takojnë sektorëve përkatës ekonomik. Konkluzionet që burojnë nga aktualiteti i temës, si dhe rekomandimet që mund të kenë ndikim pozitiv dhe efektiv në aktualen, do të rrumbullakosin qëllimin e këtij punimi.

Fjalët kyçe: Zhvillimi lokal, Biznesi, Sektori tregtar, Komuna e Pejës

JEL Kualifikimi: M13; H70;

Hyrje

Qëndrueshmëria ekonomike e një vendi mbështetet në nivelin e zhvillimit të bizneseve dhe ndikimin tyre të përgjithshëm në faktorët mikro dhe makroekonomik. Ndikimi i bizneseve në shoqërinë e një vendi është shumë i lartë sidomos kur i mendojmë faktorët mikro dhe makro. Për ta vërtetuar këtë pohim është e nevojshme të përmenden disa fakte:

Nga aspekti mikroekonomik, bizneset ndikojnë që të rritet shkalla e investimeve që manifestohet me rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe

=====

përmirësimin e infrastrukturës, pastaj rritjen e shkallës së inovacioneve sidomos atyre teknologjike, zgjerimin e ofertës së tregut, etj.

Për nga aspekti makroekonomik, bizneset luajnë rol kyç, në radhë të parë në rritjen e numrit të të punësuarve, që nënkupton zbutjen e papunësisë, rritjen e masës monetare të tregut dhe në veçanti përmirësimin e bilancit tregtar në nivel kombëtar.

Secili treg i caktuar, e në veçanti tregjet lokale, identifikohen në bazë të traditës biznesore, mirëpo edhe në bazë të mundësive që i ofron tregu, p.sh. tregu lokal i Komunës së Pejës ofron mundësi komunitetit të biznesit dhe ndërmarrësve të rinj, që përpos mundësisë që të hapin biznese në sektorin tregtar ose shërbyes, të shfrytëzohen mundësitë dhe të hapen edhe biznese të llojit që mund të zhvillojnë afarizëm turistik, duke u mbështetur në përparësitë absolute që i posedon Komuna e Pejës.

Vështirësitë dhe problemet e ndryshme që i ka shkaktuar mjedisi i biznesit në Republikën e Kosovës, ku në bazë të dhënave të shumta statistikore vërehet se në vitet e fundit nuk ka pasur ndonjë rritje reale cilësore ekonomike, pastaj norma e inflacionit ka shënuar rritje të moderuar, numri i të papunëve është rritur, etj., ku të gjitha këto ndikojnë që bizneseve tu krijohen vështirësi në aspektin e funksionimit efektiv, e që manifestohet në shumë mënyra të ndryshme, mirëpo një ndër më të rëndësishmet që vlen të përmendet është rënia e sasisë së shitjes së produkteve ose të shërbimeve (rënia e kërkesës). Kriza globale financiare e vitit 2007, ishte goditja më e rëndë për të gjitha institucionet dhe organizatat e vendeve të të gjithë botës, duke e përfshirë këtu edhe Republikën e Kosovës.

Pavarësisht këtyre vështirësive dhe problemeve të natyrës politike dhe veçanërisht asaj ekonomike, në tregun e Komunës së Pejës në 3 vitet e fundit, një numër i konsiderueshëm i bizneseve janë regjistruar duke ndikuar që në një mënyrë të rrisin shkallën e zhvillimit lokal nëpërmes aktiviteteve të tyre afariste.

Komuna e Pejës shquhet për dominimin e sektorit tregtar, ku edhe në bazë të të dhënave që do të ofrohen në vijim të huazuara nga organet përgjegjëse dhe kompetente komunale, do të vërehet se tradita ende vazhdon dhe se rolin kryesor në cilësinë e bartësit të sektorëve afariste ende e ka sektori tregtar. Rëndësia e këtij sektori në Komunën e Pejës është shumë e madhe, pasi që në këtë sektorë, ndërmarrësit janë të familjarizuar dhe kanë afinitet më të lartë për të zhvilluar aktivitetet e tyre në funksionet e ndryshme afariste.

Natyra dhe karakteristikat kryesore të bizneseve në Komunën e Pejës

=====

Natyra e biznesit është që të ofrojë produkte ose shërbime për konsumatorët e mundshëm të një tregu të caktuar, ky nga ky aktivitetet të arrijë të realizojë të hyra të shprehura në para¹⁵⁶. Kur ne si konsumatorë vendosim të blejmë një produkt ose shërbim, përfitimi ynë nga realizimi i këtij aktiviteti është dobia dhe kënaqësia nga produkti ose shërbimi i blerë, p.sh. nëse blejmë një policë të sigurimit për veturën tonë, dobia do të jetë që do të sigurojmë mbulimin e shpenzimeve që shfaqen si rezultat i ndonjë fatkeqësie të mundshme që mund të na shfaqet në komunikacion, ose nëse vendosim të blejmë ushqim në njërin nga restaurantet e qytetit të Pejës, p.sh. në Restaurant “Tirona”, atëherë këtë do ta bëjmë si rezultat i nevojës për ta plotësuar urinë tonë.

Nga pikëpamja e konsumatorit, shfrytëzimi i produktit dhe i shërbimit dallon, por njëkohësisht edhe nga pikëpamja e mënyrës së prodhimit ose të ofrimit të tyre. Një produkt është një e mirë e prekshme ose e trupëzuar p.sh. një veturë, një xhakete, një libër ose një hamburgerë, përderisa shërbimi konsiderohet si një e mirë e paprekshme, p.sh. vizitat dhe kontrollimet mjekësore, policat e sigurimit, Interneti, shërbimet e kontabilitetit, etj. Nga ky aspekt është shumë e rëndësishme të citohet se të gjitha bizneset që ushtrojnë aktivitetin e tyre në një treg të caktuar, bëjnë shitjen e produkteve ose të shërbimeve të caktuara. Pasi që të gjitha bizneset e bëjnë ofrimin e produkteve dhe të shërbimeve, është shumë më rëndësi të sqarohet arsyeja se ku qëndron leverdia për ta bërë një gjë të tillë.

Qëllimi i secilit biznes, pavarësisht veprimtarisë, tipit, apo formës ligjore që i takon, është që nga shitja e produkteve ose shërbimeve të realizojë fitim¹⁵⁷. Fitimi realizohet kur arrihet diferenca pozitive në mes kostos së mallit të shitur dhe të hyrave të realizuara. Nga kjo nënkuptojmë se çdo biznesi i nevojitet që ti ketë të ardhurat më të larta sesa shpenzimet e mallit të shitur, p.sh. një Lap Top është blerë në vlerë prej 500€ dhe është shitur në vlerë prej 700€, në këtë rast fitimi do të jetë 200€. Në mënyrë që bizneset të arrijnë profitin e dëshiruar, kërkohet që organizata drejtuesit e saj të kenë aftësi organizative, aftësi të hartimit të planeve operuese afatshkurtra dhe afatgjata, të kenë aftësi të kontrollojnë dhe udhëheqin aktivitetet e ndërmarrjes, etj.

Secili biznes është i interesuar që të përfitojë sa më shumë konsumatorë dhe të i shes produktet ose shërbimet me çmim sa më të lartë, në mënyrë shitjet të rriten në shkallë sa më të lartë.

Drejtuesit e secilit biznes në mënyrë që të arrijnë këtë objektiv, duhet që aktivitetin e tyre të biznesit të e realizojnë në mbështetje të parimeve të poshtëshënuar:

¹⁵⁶ Domniku Sokol (2011): “Bazat e Biznesit”, page 6

¹⁵⁷ Ferrell O. C., Hirt G., Ferrell L (2008). “*Business Changing the World*”, page. 74

- secili biznes duhet të ofrojë produkte ose shërbime cilësore.
- secili biznes duhet të ofrojë produkte ose shërbime me çmime të volitshme dhe racionale në përputhje me çmimet mesatare të tregut.
- secili biznes duhet të ofrojë produkte ose shërbime në përputhje me kërkesat dhe nevojat e konsumatorëve të tyre, etj.

Disa nga sektorët kryesorë të biznesit

Pavarësisht që të gjitha quhen firma të biznesit, ato dallojnë për nga sektori ekonomik që i takojnë dhe për nga lloji dhe veprimtaria e tyre ekonomike. Sikurse në të gjitha tregjet e ndryshme botërore statistikisht e përbërjes së totalit të bizneseve që ekzistojnë në një treg janë ndër më të ndryshmet, por ne në vijim do të prezantojmë disa nga sektorët më të rëndësishëm që funksionojnë jo vetëm në tregun lokal të Komunës së Pejës, mirëpo edhe në tregun kombëtar të Kosovës.

Disa ndër sektorët më të rëndësishëm:

- a) *Spektori tregtar* përfshinë të gjitha ato biznese që merren me shitblerjen e produkteve ose shërbimeve të gatshme, p.sh. këpucë, enterier, teknologji, etj.
- b) *Spektori tregtar-shërbyes* përfshinë të gjitha ato biznese që merren me shitblerjen e produkteve dhe të shërbimeve mirëpo këtu hyjnë edhe bizneset që ofrojnë vetëm shërbime, p.sh. riparime, konsultime, Internet, hoteleri, etj.
- c) *Spektori prodhues* përfshinë llojin e të gjitha ndërmarrjeve që merren me prodhimin e produkteve ose të shërbime që kryesisht janë të destinuara për firmat e biznesit të tipit komercial, p.sh. në Komunën e Pejës i kemi të tilla Industrinë e qumështit “VITA”, industrinë e birrës “BIRRA PEJA”, industrinë e ujit “Ujë RUGOVE”, etj.

Në kuadër të kësaj ndarjeje është shumë e rëndësishme që të potencohet edhe diferenca në mes bizneseve që zhvillojnë aktivitet komercial dhe atyre që zhvillojnë aktivitet industrial. Bizneset ndahen ose klasifikohen në dy kategori kryesore, të cilat janë¹⁵⁸:

- biznesi industrial.
- biznesi komercial

Biznesi industrial merret me prodhimin e të mirave që shfrytëzohen nga kompanitë e tjera për prodhimin ose shitjen e produkteve/shërbimeve të caktuara. Shembuj të këtyre kompanive janë ndërmarrjet ndërtimore të cilat ndërtojnë objekte të ndryshme tregtare dhe në të cilat hapen qendra të

¹⁵⁸ Burrow, Kleindl, Everard (2006): “*Business Principles and Management*”, page 54

=====

ndryshme biznesi me veprimtari të llojllojshme që i kemi disa nga të tillat në Komunën e Pejës e në veçanti në qytetin e Pejës.

Poashtu fermerët konsiderohen si prodhues industrial sepse rrisin dhe zhvillojnë bagëti dhe se nga këto të mirat që prodhojnë bagëtitë, prodhohen produkte të ndryshme me ç'rast ne ushqehemi me këto të mira, p.sh. produktet e qumështit (p.sh. Industria e qumështit VITA), vezët, mishra (p.sh. Industria e mishit "ABI" në Prizren), etj. Industria e automobilave është një shembull i mirë i biznesit industrial pasi në të kryhet procesi i dizajnit, montimit dhe finalizimit të veturave, etj. *Biznesi komercial* merret me shitjen e produkteve ose të shërbimeve të caktuara, p.sh. shitjen e prodhimeve të mishit që prodhohen në një industri të caktuar, shitjen e shërbimeve të caktuara në një qendër të ndërtuar tregtare, etj. Kryesisht aktivitetet e biznesit komercial mbështeten në funksionin e shitjes dhe atë të financave.

Prezantimi i të dhënave statistikore në lidhje me numrin e saktë të regjistrimit të bizneseve në Komunën e Pejës në 3 vitet e fundit si dhe klasifikimi i tyre për nga lloji dhe veprimtaria ekonomike.

Në Komunën e Pejës gjatë 3 viteve, respektivisht vitit 2008, 2009 dhe 2010, kanë aplikuar një numër i konsiderueshëm i bizneseve të reja. Sipas të dhënave zyrtare të Drejtoratit për Zhvillim Ekonomik pranë Kuvendit Komunal të Pejës numri i saktë i bizneseve të regjistruara kap shifrën 913 firma biznesi të reja¹⁵⁹. Në vijim do i paraqesim disa të dhëna të përafërta statistikore rreth sektorëve kryesorë që e përbëjnë strukturën e ndërmarrjeve të reja të krijuara përgjatë 3 viteve. Në vitin 2008 janë lëshuar gjithsejtë 290 leje pune për firmat e reja të biznesit me ç'rast struktura e ndërmarrjeve për këtë vit është si vijon:

- Rreth 57% janë ndërmarrje tregtare
- Rreth 17% janë ndërmarrje tregtare-shërbyese
- Rreth 26% janë ndërmarrje prodhuese

¹⁵⁹ Drejtorati për Zhvillim Ekonomik, Kuvendi Komunal – Pejë: "Regjistri i lejeve të punës të lëshuara për vitet 2008, 2009 dhe 2010".




Figura 1. Struktura e bizneseve të regjistruara në Komunën e Pejës për vitin 2008

Në vitin 2009 janë lëshuar gjithsejtë 424 leje pune për firmat e reja të biznesit me ç'rast struktura e ndërmarrjeve për këtë vit është si vijon¹⁶⁰:

- Rreth 65% janë ndërmarrje tregtare
- Rreth 25% janë ndërmarrje tregtare-shërbyese
- Rreth 10% janë ndërmarrje prodhuese





Figura 2. Struktura e bizneseve të regjistruara në Komunën e Pejës për vitin 2009

Përderisa në vitin 2010 lëshuar gjithsejtë 192 leje pune për firmat e reja të biznesit me ç'rast struktura e ndërmarrjeve për këtë vit është si vijon¹⁶¹:

- Rreth 85% janë ndërmarrje tregtare
- Rreth 10% janë ndërmarrje tregtare-shërbyese
- Rreth 5% janë ndërmarrje prodhuese



¹⁶⁰ Po aty

¹⁶¹ Po aty

=====

Figura 3. Struktura e bizneseve të regjistruara në Komunën e Pejës për vitin 2009

Në bazë të të dhënave të prezantuara mund të vërejmë një kuantitet të ndryshueshëm sa i përket viteve në të cilat janë regjistruar bizneset, mirëpo edhe një ndryshim sa i përket strukturës së ndërmarrjeve që i takojnë sektorëve të caktuar. Vërehet shumë mirë se sektori tregtar vazhdon të dominojë sa i përket strukturës së bizneseve edhe përgjatë tri viteve të krahasuara, sidomos në 2 vitet e fundit (2009/2010) ku numri i biznese të regjistruara në këtë sektorë është dukshëm i lartë.

Diskutime dhe analizë

Rëndësia e bizneseve të reja të regjistruara në Komunën e Pejës luan një rol shumë të rëndësishëm në stabilitetin dhe zhvillimin lokal të kësaj komune. Numri i bizneseve të regjistruara që kap shifrën prej 912 sosh, dëshmon që në Komunën e Pejës sektori privat po tregon një iniciativë në aspektin e dominimit për kontributin në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe të zhvillimit lokal në përgjithësi.

Në radhë të parë secili biznes i caktuar ka për detyrë që të dëshmohet në ofrimin produkteve ose shërbimeve sa më cilësore për konsumatorët e tij dhe për këtë nuk është një punë e lehtë për asnjërin ndërmarrës. Që një biznes të dëshmohet, ai duhet të sigurojë investime të qëndrueshme kapitale dhe operative, në mënyrë që kapacitetet e saj prodhuese të kanë vlerën dhe standardet bashkëkohore që i përputhen standardeve dhe vlerave ndërkombëtare. Për këtë kërkohen mjete të konsiderueshme financiare në mënyrë që investimet, sidomos investimet në mjete reale të jenë efektive, në kuptimin e posedimit të mjeteve mirëpo në anë tjetër edhe në kuptimin efektivitetit të tyre për të kontribuar në kthimin e investimeve të realizuara. Investimet luajnë rolin kryesor që një biznes i caktuar të arrijë suksesin e dëshiruar, mirëpo me investime, sidomos investimet në mjetet reale, hapësira, etj., i mundësojnë komunitetit shoqëror të një Komune, që ti shfrytëzojë dhe ti përjetojë në mënyrë të kënaqshme të gjitha ofertat që ofrohen nga komuniteti i biznesit, përfshirë mënyrën e shpërndarjes së produkteve, cilësinë e infrastrukturës së tyre, etj.

Punësimi në këto biznese e veçon rëndësinë e regjistrimit dhe zhvillimit të bizneseve në këtë Komunë. Sa më i lartë të jetë numri i firmave të biznesit, aq më i lartë do të jetë edhe numri i të punësuarve në këto firma, të cilave ju shfaqen nevoja të ndryshme për punonjës të profileve të ndryshëm duke filluar nga punonjësit e shërbimit si dhe ata të dijes.

Rritja e ofertës në treg i jap edhe një veçori dhe rëndësi të radhës, pasi që sa më shumë të ketë bizneseve të veprimtarive dhe sektorëve të ndryshëm, aq më e gjerë do të jetë oferta e tregut që automatikisht

=====

nënkupton një zhvillim për këtë lokalitet, pasi që nga ky këndvështrim ruhet dhe mbrohet interesi i qytetarëve të kësaj Komune.

Zhvillimi i bizneseve rëndësi për zhvillimin lokal mund të interpretohet edhe në mënyra dhe forma të ndryshme direkte dhe indirekte, duke filluar nga rritja e të hyrave komunale, rritja e produktivitetit të institucioneve qeverisëse lokale që nënkupton edhe rritjen e punësimit në sektorin publik si rezultat i rritjes së produktivitetit të punës. Nga zhvillimi i bizneseve kanë interes edhe qytetarët në mënyrë të drejtpërdrejtë e sidomos ata që mund të kenë interes bashkëpunimi me këto biznese, si p.sh. të ofrojnë lëndë të parë, shërbime, etj.

Përfundime dhe rekomandime

Sipas përmbajtjes teorike dhe të dhënave empirike të grumbulluara nga qarqet zyrtare ,diskutimit dhe analizës së shkurtër, mund të vijmë deri tek disa përfundime dhe rekomandime:

- Rëndësia e zhvillimit të bizneseve për një ambient lokal ka një rol shumë të rëndësishëm pasi që me zhvillimin e tyre zhvillohen shumë segmente të rëndësishme të cituara më lartë.
- Përkrahja e bizneseve nga ana e qeverisë komunale mirëpo edhe asaj qendrore duhet të jetë shumë konstruktive pasi që firmat e biznesit janë gjeneratori kryesor i zhvillimit ekonomik të një vendi e në veçanti rritjes së punësimit.
- Zhvillimi i biznese ndihmon kategoritë të ndryshme të qytetarëve, duke filluar nga ata që kanë nevojë për punësim, ata të cilët merren me artizanat dhe kanë nevojë që produktet e tyre të shiten diku, ata të cilët merren me kultivimin e pemëve dhe perimeve, ata të cilët merren me punimin e tokës, ata të cilët merren me rritjen e bagëtive, ata të cilët ofrojnë shërbime profesionale, dhe shumë kategori të tjera që jetojnë në një lokalitet të caktuar.
- Zhvillimi i bizneseve ndikon që në bazë të produktivitetit të tyre efektiv të konsumohen të mirat e prodhuara po nga këto biznese që në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikon në përmirësimin e bilancit tregtar por edhe zvogëlimin e GEP-it të lartë deficitar të prodhueshmërisë në vend.
- Zhvillimi i bizneseve e rrit cilësinë e jetesës ë vend, pasi që hapësirat e reja të krijuara që burojnë si rezultat i investimeve të mirëfillta e bëjnë jetën më të mirë dhe lokalitetin më të bukur.
- Komuna e Pejës në veçanti, duhet të planifikojë në politikat e saja zhvillimore, mundësitë e tregut lokal, në mënyrë që ti favorizojë dhe ti lirojë nga obligimet komunale ato biznese që shfrytëzojnë potencialet dhe mundësitë e pashfrytëzuara të Pejës,

=====

- duke i shfrytëzuar dhe duke krijuar biznese të mirëfillta. Rast konkret mund ta përmendim, ofrimin e pronës publike në shfrytëzim pa kompensim, për hapjen e një biznesi sportiv në kodrat (Majën e zezë) e Pejës (Qendra e Motoçiklistëve të Pejës).
- Organizimi i tryezave të rumbullakëta ose seminareve në favor të zhvillimit të bizneseve, është një mundësi dhe një ide shumë e qëlluar në mënyrë që të diskutohet për mundësitë dhe dobësitë e tregut lokal.
 - Bashkëpunimi i komunitetit të biznesit me institucionet e arsimit ë lartë në Komunën e Pejës do të ishte një hap i qëlluar në mënyrë që të ndërlihet teoria dhe praktika dhe si rezultat i kësaj marrëveshjeje përvojat dhe njohuritë e studentëve, të shfrytëzohen dhe të aplikohen në favor të rritjes së efijencës dhe efektivitetit të firmave të biznesit, mirëpo të burojnë edhe ide të reja që do të ndikonin në rritjen e llojshmërisë së bizneseve që veprojnë në tregun lokal të Pejës dhe jo të shkohet vetëm me imitacione.

Literatura

1. Ayyagari, M., Demirguc-Kunt, A., Maksimovic, V., (2005): How well do Institutional Theories Explain Firms' Perceptions of Property Rights? *World Bank Working Paper*.
2. Directorate for Economic Development, Municipal Assembly – Peja: “List of work permits issued throughout the years 2008, 2009, and 2010”.
3. Domniku Sokol (2011): “Principles Of Business”, *F.A.S.B., University of Pristine*
4. Domniku Sokol (2011): “Key Characteristics of SME in Peja Region”, *Journal of Business Administration* 2, 195-205
5. Djankov, S., La Porta, R., Lopez-de-Silanes, Shleifer, A., (2002): The Regulation of Entry, *Quarterly Journal of Economics* 117, 1-37
6. Djankov, S., Martin, F., McLiesh, C., (2004): Property. *Wor*
7. Ministry of Trade and Industry of Kosova: “Trade Politics of Kosova 2009”,
http://www.mti-ks.org/repository/docs/PolitikaTregtare_e_Kosoves_2009.pdf
8. Schneider, F., (2000) : The Size and Development of the Shadow Economies and Shadow Economy Labor Force of 18 Asian and 21 OECD Countries: First Results for the 90s. *Forthcoming*

9. Schneider, F., Enste, D., (1998) : Increasing shadow economies all over the world-fiction or reality: a survey of the global evidence of its size and of its impact from 1970 to 1995,
10. Snodgrass, D., Biggs, T., (1996) : Industrialization and the Small firm. International Center for Economic Growth.
11. Stulz, R., Karolyi, A., Doidge, C. (2004): Why Do Countries Matter So Much for Corporate Governance? *NBER Working Paper No. 10726*.
12. Stulz, R., Williamson, R. (2003) : Culture, Openness and Finance. *Journal of Finance* 70 (3),

KUD 331.105.22

LIDERSHIPI NDËRMARRËS NË BIZNES DHE INFLUENCA NË GRUP

*Msc.Thëllëza Latifi Sadrija, ass
flanzalatifi@hotmail.com*

Abstrakt

Qëllimi i këtij punimi është që të risim aftësite ndërpersonale në grup në mënyrë që të nxisim liderat e ardhshëm të udhëheqin me vizion të qartë në fusha të ndryshme ku operojn . Liderët Ndërmarrës paraqesin faktorin më të rëndësishëm të zhvillimit të biznesit. Nga iniciativa dhe aktiviteti i tyre varet zhvillimi i ndërmarrjes, i ekonomisë dhe i shoqërisë së një vendi. Mënyra e sjelljes së Liderëve ndërmarrës ndaj vartësve për arritjen e objektivave të përcaktuara, apo siç quhet ndryshe stili i lideshipit ndërmarrës, varjon nga njëri lider tek tjetri, si dhe cilin stil e përdorin për arritjen e qëllimeve apo objektivave afatgjate.Mënyra më e mirë për të analizuar aftësitë e liderit ndërmarrës është duke parë procesin e vendim marrjes nga poshtë – lartë. Ajo që ne sygjerojmë është se suksesi i punës në grup influencohet nga mënyra se si organizohen burimet e ndryshme në orgnizatë, përfshirë këtu burimet njerzore. Detyrat e sukseshme realizohet duke pasur një : qëllim të qartë me frym bashkëpunuese, një plan të saktë dhe përgjegjësi të ndara.

Fjalët kyçe: Lidership, ndëmarrës, biznes, organizim,vendimarrje, influencë në grup, kulturë.

Hyrje

Sot në kuadrin e globalizimit, termi lidership ka marrë një rëndësi të veçantë për rolin dhe vendin që zë në shoqëri, sektorin publik, sektorin privat dhe Forcat e Armatosura. Lidershipi mund te përcaktohet thjesht si, “të ndiqesh nga vartësit”, “në drejtimin e punonjësve në arritjen e rezultateve më të mira”, ose në disa raste me specifike “përdorja e autoritetit në proçeset vendim-marrëse”. Lidershipi Ndërmarrës si pjesë përbërëse dhe figurë kryesore në organizatë, duhet të disponojë dhe prezantojë aftësitë dhe cilësitë e kërkuara, përsosshmëri në mënyrën dhe formën e sjelljes, prezantimin e personalitetit, mënyrën e komunikimit dhe rolin në drejtimin e grupit. Duke parë rolin dhe rëndësinë e figurës së lidreshipit, del si domosdoshmëri trajtimi dhe analizimi i temave të tilla në përcaktimin e rolit

=====

dhe vendin e lideshipit ndërmarrës në raport me individët, grupet dhe organizatat. Disa nga idete me tipike që shfaqen në përkufizimin e lidershipit përfshijnë: ushtrimi i influencës/ndikimit, motivimi dhe frymëzimi, ndihma për të tjerët për të realizuar potencialin e tyre, udhëheqja me anë të shembullit personal, përkushtimi ndaj të tjerëve dhe ndryshimi. E thënë më thjeshtë, lideri është dikush që cakton drejtimin dhe influencën njerezit që të ndjekin atë drejtim. Mënyra se si e përcaktojnë drejtimin dhe si arrijnë tendikojnë tek njerezit varen nga një numër faktorësh që do t'i shohim në vazhdim. Për të kuptuar më të vertetë "territorin" e lidershipit, do të shqyrtojmë disa nga teoritë e lidershipit dhe do të shikojmë disa nga vetitë dhe karakteristikat që duhet të kenë liderat.

1. Përshkrimi teorik i lidershipit ndërmarrës

Termi lidership ndërmarrës është trajtuar dhe studiuar nga studiues dhe ekspertë të ndryshëm. Në lidhje me përcaktimet e tyre, nocioni "leadership është një proces në të cilin individët influencojnë grupimet, dëshirat dhe objektivat e organizatës (Hollander, 1985)". Ndërsa autorët Hackman dhe Johnson (1991) e kanë përkufizuar lidershipin si qenie humane komunikuese, e cila bën të mundur modifikimin e qëndrimeve dhe sjelljen e të tjerëve, më qëllim arrijtjen e objektivave dhe nevojave të grupit. Duke parë analizat dhe përfundimet e autorëve të lartpërmenduar arrijmë në konkluzionin se, format dhe mënyra e drejtimit duhet t'u referohet proceseve të ndryshme, por jo individëve të veçantë. Komentet dhe analiza të tilla mundësojnë dhe lehtësojnë trajtimin dhe studimin e figurës dhe rëndësinë e lidershipit ndërmarrës në raport me organizatën.

1.1 Rëndësia e Lidershipit Ndërmarrës

E rëndësishme për liderin ndërmarrës është zotërimi dhe zbatimi i cilësive motivuese, komunikuese dhe roli i tij në përpjekjet për reduktimin e pakënaqësive të punonjësve. Reduktimi i pakënaqësive, arrihet duke njohur ngarkesën dhe përgjegjësitë individuale, performancën, të qenurit i hapur dhe transparent në zgjidhjen e problemeve dhe prezantimin e ideve të reja. Në lidhje me elementët e lartpërmendura, Lordi Sieff ka përkufizuar lidershipin ndërmarrës si më poshtë vijon; "Leadershipi ndërmarrës vitalisht është shumë i rëndësishëm në të gjitha nivelet e një kompanie, që nga bordi kryesor deri tek nivelet më të ulëta. Lidershipi ndërmarrës është aftësia morale dhe intelektuale në parashikimin dhe realizimin e më të mirës, për kompaninë dhe punonjësit e saj ... Gjëja më vitale që lidershipi ndërmarrës ka është krijimi i shpirtit të ekipit rreth tij dhe afër tij, jo në termin e një shkollari, por në termat realistike të pjekurisë

=====

së një të rrituri ... Të jesh një lider efektiv duhet të shikosh, pra, të jesh një figurë aktive në praktik. (1991)” Analizat dhe komentet e Lordit Sieff, konkludojnë se lideri ndërmarrës përbën elementin ose ‘motorin’ bazë në përsosjen e mënyrave dhe formave të punës në grup ‘team working’. Në këtë kontekst, integrimi i individëve dhe grupimeve kalon nëpërmjet dy etapave të rëndësishme; ndryshimeve kulturore në organizatë (Changing Organizational Culture) dhe kultura kombëtare (National Culture). Të dyja këto etapa kanë ndikim thelbësor në motivimin dhe rritjen e cilësive individuale të drejtimit. Këto cilësi ndikojnë në efektivitetin e lidershipit dhe krijimin e një vizioni dhe strategjie të saktë për të nesërmen. Zgjedhja dhe përgatitja e lidershipit ndërmarrës do të krijojë prioritetet e nevojshme për organizatën dhe biznesin ku ai vepron. Lidershipi ndërmarrës, si aktori kryesor në organizatë luan rol vendimtar në ndryshimin e natyrës së punës, duke përdorur procedurë eficiente në menaxhimin e burimeve njerëzore. Natyra e menaxhimit ndikon në arritjen e rezultateve të kërkuara në jetën e biznesit.

Drejtuesi në vetvete duhet të jetë një figurë potenciale, me aftësi të mira drejtuese dhe menaxhuese. Ky lloj lidershipi duhet të ndeshet në organizata, nivele të ndryshme vendimarrëse të politikës, shoqërisë civile, etj. Në dukje, ne duhet të shikojmë një figurë morale pozitive të drejtuesit, ashtu si Arnold dhe Robertson (1998), sugjerojnë; “lidershipi nëmarrës është figurë potente dhe me karakter, por jo figurë shpirtërore. Ndërsa nga ana tjetër, autorët Katz dhe Kahn (1978; p.528) e përcaktojnë lidershipin ndërmarrës, si rritje të influencës mbi pëlqimet mekanike të lidhura këto me rutinën që përfshin organizatën”. Duke parë dhe analizuar punën dhe eksperiencën e autorëve të mësipërm dhe realitetin e zhvillimit të lidershipit nëmarrës në Angli, studjuesi i njohur i kësaj fushe Mullins (1999) do të arrinte në konkluzionin se: e rëndësishmja e një drejtuesi lidhet me motivimin, mënyrën e të sjellurit, si dhe mënyrën dhe format e komunikimit. Komentet dhe analizat e bëra nga studiuesit Arnold dhe Robertson (1998), Katz dhe Kahn (1978; p.528) dhe Mullins (1999) konkludojnë se elementët bazë të cilat ndikojnë në suksesin dhe zhvillimin e lidershipit ndërmarrës janë: kultura kombëtare; ndryshimet kulturore në organizatë; mënyrat/format e sjelljes dhe së fundmi shtetet e drejtimit. Por le t’i marrim dhe t’i diskutojmë një e nga një elementët e mësipërme.

Modeli i një lideri



Ashtu siç është diskutuar, karakteristikat personale të liderit mund të përmbliken në mënyra të ndryshme. Njëri nga këto modele, e dizenuar nga TPL mund të shihet dhe në grafik.

Ky model kombinon karakteristikat e derivuara nga **pasione** individuale të shprehura si dhunti lidereshipi, së bashku me **temperamentin** tonë apo me stilin e sjelljes, e mbështjellë nga **karakteri** i zërit, e shprehur si një pjekuri personale.

2. Lidereshipi si aspekt i komunikimit

Çështja e komunikimit është shumë kritike në çfarëdo analize të lidereshipit. Në praktikë shumë kryetarë të bordeve dhe ekzekutivë duhet të jenë në gjendje të komunikojnë në mënyrë efektive sa herë që kërkohet nga ata. Në fakt lidereshipi në ndërmarrje të mëdha mban në vete implikimet e fjalimeve dhe deklaratave të gjata të cilat duhet të bëhen. Më pastaj kjo bëhet çështje e përditshme e top ekzekutivit në mënyrë që gjithmonë të kenë të gatshme mendime apo fjalime të ndryshme në rast se ata thirren të prezantojnë në ndonjë funksion. Shpesh është thënë se fjalimet e mira gjithmonë janë përgatitur paraprakisht.

Fjalimet publike janë një art ose shkencë që kërkojnë profesionalistët dhe duhet të jenë pjesë e çdo trajnimit për lidereship.

3. Morali dhe motivimi

Në motivimin e punëtorëve menaxheri shpesh influancohet nga konceptet e vetëdijës apo nënvetëdijës që ka ndaj qëndrimeve, që punëtorët e tyre kanë ndaj punës.

Shkencëtari i sjelljes, i ndjeri Douglas McGregor flet për teorinë x dhe y. Ky sugjeron që një punëtor mesatar nuk e pëlqen punën në bazë të teorisë x, ai duhet të kërcënohet në mënyrë që të kryejë punën. Teoria y deklaron se puna është natyrale sikur loja dhe punëtorët mund të marrin përgjegjësi për ta kryer punën me vetëiniciativë.

=====

Stimulimet financiare dhe siguria - Zakonisht shkon e pavërejtur thënia se duhet të ketë një shpërblim për punën e kryer me sukses. Një punëtor zyrtar p.sh. i kënaqur me pagën e tij mund të dekurajohet nëse e kupton se dikush i nivelit më të ultë e merr pagën më të madhe se ai. Kombinuar me pagën mujore zakonisht vë në konsiderim edhe atraksionet tjera monetare si p.sh. e drejta e pensionit, beneficione sëmundjesh, pushime vjetore me pagesë etj.

Kënaqshmëria me punën - Shumica e njerëzve e kryejnë punën e tyre më mirë nëse e pëlqejnë atë dhe njerëzit me të cilët punojnë.

Përderisa shumë punëtorë preferojnë rutinën në vend të dinamikës dhe sigurinë në vend të riskut, ata prapëseprapë dëshirojnë të ndihen të rëndësishëm dhe të falënderuar. Nëse e marrim p.sh. muzikën ku luhen zhanre të ndryshme të muzikave, përderisa punëtorët punojnë, mund të pëlqehet nga shumica, por gjithsesi jo nga të gjithë.

Nevoja për disiplinë - Edhe në lidhshmërinë më të mirë mund të ketë probleme personale të cilat trajtohen në mënyrë të ashpër. Në rastet kur ka përjashtim, ulje në pozitë, apo qortim, kjo duhet të bëhet në mënyrë të ashpër, por senzitive duke pasur parasysh ndjenjat e personit tjetër. Në rastet kur merret ndonjë vendim i ashpër kjo mund të ketë efekt të dëmshëm tek punëtorët tjerë.¹⁶²

3. KULTURA KOMBËTARE

Kultura kombëtare është një nga element kryesorë, e cila ndikon në sjelljen e lidhshmërisë ndërmarrës dhe format e komunikimit. Në lidhje me këtë koncept McGregor (1987) ka konkluduar se, kushtet sociale, ekonomike dhe politike së bashku me qëndrimin dhe nevojat e vartësve, ndikojnë në marrëdhëniet me lidhshmërinë ndërmarrës. Kultura kombëtare luan rol parësor dhe influencon në mënyrën dhe sjelljen e lidhshmërisë ndërmarrës në lidhje me ambientin ku ai vepron. Për shembull faktorët si: shoqëria civile, ekonomia, politika, traditat, zakonet, marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve të veçanta apo grupimeve të caktuara, ndikojnë në marrëdhëniet e lidhshmërisë ndërmarrës me masën e gjerë të ndjekësve.

3.1 Ndryshimet kulturore në organizatë

Studimet dhe shkrimet e ndryshme e kanë konsideruar lidhshmërinë pjesë kryesore dhe integrale e strukturave sociale dhe kulturore të organizatës. Lidhshmëria ndërmarrës si pjesë e rëndësishme e organizatës, duhet të reflektojë dhe prezantojë cilësitë me të mira drejtuese në arritjen e

¹⁶² Ramosaj, Berim, Menaxhmenti Kreativ&Lidership, Prishtinë 2006

=====

suksesit nëpërmjet komunikimit me njerëzit, influencimin në mënyrën dhe veprimet e tyre, inkurajimin në drejtimin dhe realizimin e detyrave në grup etj. Të gjitha së bashku ndihmojnë në mbështetje të ndryshimeve kulturore të organizatës dhe zhvillimin e mëtejshëm të leadershipit. Zbatimi dhe përvetësimi i këtyre cilësive mundëson krijimin e liderit të përgatitur, me vizion të qartë për të tashmen dhe të ardhmen.

Lidershipi dhe ndikimi tek të tjerët

Nje lider eshte nje person i cili beson ne nje qellim te caktuar dhe qe ka nje vizion te caktuar. Lideret e mire, te cilet ndikojne shume lehte tek te tjeret, jane ata te cilet besojne shume ne vizionin e tyre. Kjo do te thote se nese ti nuk beson shume ne ate vizion apo ne arritjen e atij qellimi, ti nuk do te jesh kurre ne gjendje te ndikosh tek te tjeret, te besh qe ata ti perkushtohen atij vizioni apo qellimi.

Ajo qe eshte zbuluar eshte se njerzit nuk ndikohen nga nje lider prej fjaleve te tij, por ndikohen prej energjise me te cilen jane te shoqeruara ato fjale.

Ti mund te jesh shume here me bindes kur flet me siguri, dhe kur ti beson shume fort ne arritjen e nje vizioni, atehere ti ndjen gjithë sigurine e kesaj bote kur flet per arritjen e tij, duke u bere keshtu shume here me bindes.

Sa me shume qe lideri te besoje ne vizionin e tij, do te jete me ne gjendje te ndikojte te tjeret dhe gjithashtu ti beje ata te besojne ne vizionin e tij.

C'mund te beje tjeter nje lider per te ndikuar te tjeret?

Nje lider mund te perdore gjithashtu teorine e konceptit te identitetit per te ndikuar tek te tjeret. Pra duke tejcuar nje identitet te caktuar tek dikush, ai mund te ndikohet per ta kthyer këtë identitet në realitet.


Psh nje nga menytrat me te mira me te cilen nje lider mund te ndikojte dike eshte ti thoje atij dicka si: "E di qe nje dite ti do te besh dicka te madhe dhe te jashtezakonshme". Kur lideri ia thote personit kete sugjestion me shume siguri, subkoshienca e personit do ta absorboje kete mendim dhe te gjitha veprimet e tij do te ndikohen nga ky sugjestion, deri sa ta kthejne ate ne realitet.

Lideret gjithashtu duhet te ndikojne tek te tjeret duke perdorur stile te ndryshme motivimi, stilin i cili i pershtatet me mire personave real me te cilet kane te bejne. Disa njerez ndikohen me shume nga shperblimet kurse disa te tjere ndikohen me shume nga deshira per te evituar denimet.

Nje lider i mire duhet te percaktoje stilin e duhur motivues qe duhet te perdore per cdo person ne menyre qe te kete ndikimin me te forte te mundshem mbi ta.

Dhe ne fund, qe nje lider te ndikojte tek te tjeret ai duhet te jete nje shembull i mire per ta, jo vetem dikush qe jep vec urdhra. Duhet qe ato gjera qe urdheron ti kete bere vete me pare, qe te tjeret ta ndjekin. Nje lider duhet te drejtoje nepermjet shembullit vetjak ne menyre qe te ndikojte tek te tjeret, perndryshe njerzit nuk do te kene besim tek ai.¹⁶³

Dinamika e Grupit



Diagrami 1. Dinamika e Grupit (Performanca e Grupit)

Rezultatet

- Të krijojm një ide të përgjithshme rreth lidershpit në ditët e sotme
- Të risim vëmëndjen e sjelljeve personale dhe cilat janë pasojat kur punojme në grup (komunikimi, procesi i vendim-marrjes & lidershpi)
- Të nxisim aftesit ndërpersonale për të forcuar pozitat tona në grup dhe si të infulencojmë në procesin e vendim-marrjes
- Si të drejtojmë detyra delikate në punë të ndryshme
- Si të drejtojmë mbledhjet

¹⁶³ Shkencashkences.wordpress.com, “Si ndikon një Lider tek të tjerët”

- Si të drejtojmë konfliktet e ndryshme në grup¹⁶⁴

Konkluzion

Lidershipi ekipor është një proces me anë të të cilit lideri ka mundësi që të maksimizojë angazhimin e talentit individual në mënyrë që objektivat e përcaktuara janë arritur përmes angazhimit ekipor. Një gjë e tillë kërkon disa shkathtësi kritike të menaxhmentit dhe lidershipit nga ana e liderit të ekipit:

- Njohuria për talentin ekzistues;
- Aftësitë që të sjellë në sipërfaqe talentin e tillë dhe të angazhojë në mënyrë të duhur;
- Kapaciteti të menaxhojë ndërlidhjen në mes njerëzve të ndryshëm që kanë talent;
- Aftësia për të sfiduar njerëzit dhe t'i bënë ata të zhvillohen;
- Kuptimi i dinamikës së ekipit.

Është me rëndësi të veçantë të theksohet një përqindje shumë e vogël e talentit që ekziston në ekipe është i njohur, i angazhuar dhe i zhvilluar.

Mjedisi kosovar nuk dallon shumë nga mjedisi i vendeve të tjera të regjionit sa i përket sfidave të zhvillimit. Për ndryshim nga vendet tjera, në Kosovë proceset janë në tranzicion, si në aspektin e transformimeve organizative strukturore të bizneseve, po ashtu edhe në aspektin e transformimit të pronësisë (titullarit). Periudhën e tanishme e karakterizon sistemi i një ekonomie të tregut të lirë dhe demokraci parlamentare.

Referencat

1. Ramosaj, Berim, “Menaxhmenti Kreativ&Lidership”, Prishtinë 2006
2. Shkencashkences.wordpress.com, “Si ndikon një Lider tek të tjerët”
3. Rexhepi, Pleurat BA, “Lidershipi&Influenca ne grup”, Janar 2008

¹⁶⁴ Rexhepi, Pleurat BA, “Lidershipi&Influenca ne grup”, Janar 2008

Mbrojtja e mjedisit si faktor i rëndësishëm i zhvillimit të turizmit

*Ass. Merita Begolli Dauti
merita_dauti@hotmail.com*

Abstrakt

Në punim është trajtuar mbrojtja e mjedisit si faktor i rëndësishëm për zhvillimin e turizmit si veprimtari ekonomike me vlera të rëndësishme. Mbrojtja e mjedisit jetësor bëhet kërkesë gjithnjë e më e madhe për mbijetimin e civilizimit njerëzor.

Shumë herët u bë e qartë se një prej shkaqeve kryesore për degradim të mjedisit jetësor është mënyra e papërshtatshme e sjedhjes së njeriut, si dhe edukimi jo i mjaftueshëm për përdorim racional të resurseve të disponueshme.

Prej aty, nga periudha e kaluar e vërehet ngritjen graduale të vetëdijes, si në nivel global ashtu edhe në atë kombëtar e lokal për rolin e edukimit në të kuptuarit e mbrojtjes të mjedisit. I cili njëherit ndikon edhe në zhvillimin e turizmit.

Fjalët kyçe: mjedis, turizëm, zhvillim ekonomik, vlerë

JEL kualifikimi : Z,Z0,Z13,Z19

Hyrje

Duke pasur parasysh rëndësinë e turizmit si veprimtari ekonomike dhe shoqërore është më e rëndësishme për të dhënë përkufizimin e plotë rreth tij, i cili në vete përmban shumë aspekte të studimit të tij dhe i cili kontribuon në ngritjen e standardit jetësor dhe njëherit është i lidhur ngusht me mjedisin jetësor. Në Kosovë mjedisit paraqet problem të veçantë, i cili realisht duhet përmirësuar dhe ndërmarrë një sërë masash, në mënyrë që potencialet tona turistike t'i vëmë në dispozicion të ofertës turistike. Në duhet gjithmonë të kemi parasysh dhe të jemi të kujdesshëm në ruajtjen e mjedisit. I cili do të jetë një nga indikatorët më të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik në vendin tonë. Kosova, ka trashëguar një numër të madh problemesh mjedisore, të akumuluar me dekada si pasojë e shfrytëzimit të pakontrolluar të resurseve natyrore dhe minierave, prodhimit industrial shoqëruar me një shkallë të lartë të ndotjes, dhe me mungesë të madhe politikash, ligjesh dhe institucionesh relevante për të trajtuar dhe zgjidhur këto probleme. Kjo ka sjellë një degradim të dukshëm dhe në raste të pariparueshëm të mjedisit dhe me këtë një ndikim direkt në shëndetin e popullatës. Në duhet gjithmonë të kemi parasysh dhe të jemi të kujdesshëm në ruajtjen e mjedisit. I cili do të

jetë një nga indikatorët më të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik në vendin tonë.

Vlerat themelore turistike të Kosovës

Vlerat turistike të Kosovës përbëjnë numër relativisht të madh të motiveve, si për nga heterogjeniteti po ashtu edhe nga prejardhja. Për nga motivet atraktive, Kosova prin para shumëvendeve të ish- Jugosllavisë. Koncentrimi i motiveve të shumta turistike, natyrore dhe antropogjene ka rrjedhur nga specifikat natyrore dhe kushtet shoqërore- historike në të kaluarën, por edhe në vazhdim. Motivet e pasura turistike dhe pozita adekuate e tyre në mënyrë lineare dhe grupore dëshmojnë së territori i Kosovës paraqet motive specifike turistike në ish- Jugosllavi, e cila përbëhet prej ultësirës së Kosovës, Rrafshit të Dukagjinit dhe Maleve të Sharrit, Bjeshkëve të Nemuna (Alpeve Shqiptare) dhe Bjeshkëve të Kopaonikut. Në pjesë të tilla janë koncentruar numër i madh i motiveve antropogjene, motive kulturore dhe historike, vendbanime të vjetra dhe motive etnografike-etnologjike me specifikat e tyre.

Të gjitha e përbëjnë të kaluarën specifike dhe historike të kësaj hapësire.⁵⁶ Kosova është e pasur me fondin e vlerave turistike, të cilat përmbajnë shkallë të gjerë të motiveve natyrore dhe antropogjene dhe si të tilla ndahen në:

a) Motivet natyrore

1. Motivet morfologjike
2. Motivet hidrografike
3. Motivet biogeografike

b) Motivet antropogjene

1. Motivet ambientale siç janë: qytetet, vendbanimet dhe objektet tjera.
2. Përmendoret historike dhe muzetë.
3. Motivet etnografike- etnologjike.

Radhitja e dendësisë së motiveve turistike në hapësirën e Kosovës është tregues në radhitjen enumerit të motiveve turistike në këtë hapësirë. Radhitja si element hapësinor i qarkullimit turistiktregon ndërlidhshmërinë e hapësirës në raport me motivet. Dendësia e motiveve turistike në këtë hapësirë është relativisht e madhe dhe kjo mund të tregohet me mundësinë e valorizimit. Në sipërfaqen prej 10887 km² janë të pranishme mbi 370 motive dhe objekte turistike, të cilat mund të iniciohen në shkallë të lartë të mundësisë relative të valorizimit, duke marrë për bazë si pjesë të fondit të motiveve të tilla, që mund të paraqesin motive të përbashkëta dhe të pavarura. Prej numrit të motiveve dhe objekteve turistike, pjesa me numër më të madh i përket objekteve kulturore dhe monumenteve historike mbi

=====

160, të atyre me motive natyrore 40, në lokalitetet evjetra dhe arkeologjike 44, monumente nga Lufta e Dytë Botërore 68, si dhe numër i madh i përmendoreve dhe monumenteve të luftës së fundit.¹⁶⁵

Lidhja e turizmit më mjedisin

Mjedisi natyror është gjithqka që ekziston në natyrë: toka ,topografia,gjeologjia,elementet ujore,flora,fauna dhe sistemet ekologjike.Ndërsa mjedisi I ndërtuar është I përbërë nga elementet fizike të ndërtuara nga njeriu,kryesish të gjithë tipat e ndërtesave,strukturat tjera dhe zhvillimi infrastrukturor,po aq sa edhe qendrat historike dhe ato arkeologjike.Në analizat bashkëkohore të ndikimeve mjedisore,faktorët socialkulturore dhe ekonomike të mjedisit janë marrë gjithnjë në konsiderate dhe shpesh ndarja e komponenteve socialekonomikë dhe fizikë të mjedisit.është jo vetëm e veshtirë, por edhe joefektive. Janë përcaktuar tri aspekte kryesore të lidhjes turizëm-mjedisi:

- Shumë elemente të mjedisit fizik janë tëheqëse atraksione për turistët.

- Lehtësirat në përdorim nga turistët dhe infrastruktura përbëjnë një aspekt të mjedisit të ndërtuar.

- Zhvillimi I turizmit dhe përdorimi nga turitët e një zone të caktuar gjenerojnëndikime mjedisore

Për shkak së turizmi zhvillohet shpesh në zona delikate ,si ishujt e vegjël,bregdete, male,zona alpine etj.apo qendra historike dhe arkeologjike,ndikimet mjedisore përbëjnë probleme potenciale,sepse këta tipa vendesh ofrojnë burime të rëndësishme apo tërheqje për turistët.Tipet dhe shtrirja ndikimit mjedisor,po aq sa edhe ndikimet socialekonomike,janë të lidhura ngushtë më tipin dhe intensitetin e zhvillimit të turizmit të ndërmarrë.

Shumë autorë apo organizata të ndryshme turistike kanë paraqitur disa ide për maksimizimin e shëndetit të mjedisit të zonave përkatëse,duke I parë këto në këndvështrimin e perspektivave tëzhvillimit.Kështu mund të thuhet se:

- Mjedisi është burim I turizmit.Ajo çka industria turistike promovon dhe shet është mjedisi apo kënaqësia dhe përvoja që turisti merr prej tij.

- Shpesh metoda më e mirë për të siguruar një ruajtje të mjedisit lidhet më kuptimin e plot të turizmit dhe realizimin e tij në afate të gjata kohore dhe të qëndrueshme.

- Turizmi përbënë një element kritik në mbijetesën ekonomike të zonës përkatëse.

¹⁶⁵Dr. Sc. Reçica Fetah & Mr. Sc. Millaku Bedri,Ekonomia e turizmit,Prishtinë,2011

=====

- Afatet e gjata kohore ,të nevojshme për ndërtimin e industris turistike,për të siguruar njëplanifikim të kujdeshëm dhe të nevojshem për minimizimin e efekteve negative mjedisore,kanë munguar në fazat e hershme të zhvillimit të turizmit.

- Është e nevojshme të vlerësohen kostot dhe përfitimet e zhvillimit të turizmit.

Prej vitesh,lidhja e turizmit më natyrën ka qene objekt debatesh për shumë ambientalistë,politikian dhe studiues të diciplinave të ndryshme,të shqetësuar për mbrojtjen e mjedisit natyror. Brenda kufijve të ekologjisë turistike moderne,që ka si qëllim studimin në mënyrë specifike të raporteve midis turizmit dhe natyrës,dallohen dy qëndrime kundërta:

Individualist ose konzervator,në kuptimin teknik,kulturor dhe politik të fjalës,dhe social,që bazohet në mundësin e shfrytëzimit të vlerave të mjedisit natyror nga ana e një numri të madh të mundshëm qytetarësh.

Turizmi nuk mendohet të jetë gjithmonë dhe kurdoherë faktorë I degradimit,si një përbindësh I paracaktuar të grabërojë burimet nga ku ai ka edhe vet origjinën.

Në të vërtetë,duke u trajtuar si veprimati e nje konsumi të mirfilltë,nga njëra anë ai sjell modifikime modeste të mjedisit natyror dhe, nga ana tjetër,duke qenë fryt I aspiratave natyralistike të njeriut,ai kontribon në ruajtjen e mjedisit natyror.¹⁶⁶

Si ndikon turizmi në mënyrë pozitive në mjedis

Turizmi ,nëse planifikohet mirë dhe kontrollohet ,mund të ndihmojë,të mbajë dhe të përmirsojë mjedisin në mënyra të ndryshme.Turizmi mund të ndihmojë në ruajtjen dhe zhvillimin e parqeve natyrore duke përfshirë krijimin e parqeve rajonale dhe kombtare si atraksione për turistët.Pa turizëm zona të tilla natyrore mund të zhvillohen drejtë përdorimeve të tjera ose mund të shkatërohen nga pikpamja e trashëgimisë ekologjike. Turizmi siguron vazhdimësin,ndihmon ruajtjen e qendrave historike dhe arkeologjike(si tërheqëse për turistët) që shpesh priren drejt shkatërimit ose zhdukjes së tyre,duke rezultuar kështu në humbjen e trashëgimisë kulturore të zonave përkatëse. Turizmi shpesh ndihmon në sigurimin e vazhdimsisë për pastrim të mjedisit perms kontrollit të ajrit,ujit apo ndotjes si pasojë e zhurmave dhe problemeve të reja mjedisore,apo të përmirësimit të estetikës mjedisore,Përmes programeve dhe projekteve përkatëse të ndërtimeve dhe kontrollit rreth ndotjes së deteve apo oqeaneve. Ruajtja e mjedisit është e lidhur ngushtë edhe me përfitimet ekonomike,infrastruktura lokale e aeroporteve,rrugët,uji,energjia elektrike,sisitemi I telekumunikacionit,të cilët mund të përmirësohen përmes

¹⁶⁶ Koja Vita & Gorica Klodiana,Bazat e turizmit,Tiranë,2004

zhvillimit të turizmit, ndikojnë në zvoglimin e problemeve që kanë të bëjnë me ndotjen si dhe zgjerimin e cilësisë mjedisore të rajonit.¹⁶⁷

Mjedisi i ruajtur është një përparësi e madhe për shëndetin dhe rekreacionin. Faktori njerëzor dhestili i tij jetësor tani po ushtron ndikim në transformimet, evoluimin dhe modifikimin e faktorëve primar natyror, sa që këto në shumë vise janë degraduar në shkallë të madhe, sidomos disa zona në bregdetet e Mesdheut, Karaibeve dhe zonat malore në Alpe dhe Pirineje.

Përfundimi

Turizmit po i ipet një rëndësi gjithnjë e më e madhe. Duhet të theksoj që turizmi është një nga sektorët më të rinj në ekonominë tonë, Edhe pse Kosova është hapësirë e vogël gjeografike, me motivet natyrore dhe njerëzore që ka, ofron mundësi të mira për zhvillimin e disa llojeve të turizmit vendës, rajonal, ndërkombëtar, stacionar dhe transit. Kosova ka vende turistike që mund të shfrytëzohen nga popullsia e vet për ekskursione, për sport, rekreacion, pushim, kulturë, për arsim e edukim. Mirëpo, ky lloj turizmi nuk ka qenë dhe ende ka mbetur i pazhvilluar sa duhet. Deri në vitet e shtatëdhjeta në mungesë të rrugëve të mira, në Kosovë kishte pak lëvizje turistike edhe pse Kosova ka pozitë të mirë gjeografike. Pas viteve të shtatëdhjeta me ndërtimin dhe modernizimin e rrjetit rrugor automobilistik dhe përmirsimin e gjendjes ekonomike, fillojnë lëvizjet turistike të shtohen. Qarkullimet turistike lokale, individuale, familjare e grupore me qëllim pushimi e rekreacioni bëhen sidomos gjatë verës për t'u freskuar pranë baseneve, lumenjëve, liqeneve, ose gjatë stinës së dimrit në qendrat e skijimit ([Brezovicë](#) e [Rugovë](#)) e gjetkë. Në periudhën pas luftës në Kosovë është ndërtuar numër i madh i pishinave, të cilat tërheqin numër të madh të klientelës së re turistike.

Referencat

1. Dr. Sc. Reçica Fetah & Mr. Sc. Millaku Bedri, *Ekonomia e turizmit*, Prishtinë, 2011
2. <http://mmph.rks-gov.net>
3. Ismaili Murtezan & Durmishi Bujar, *Shoqëria dhe menaxhimi I mbrojtjes së mjedisit*, Tetovë, 2006
4. Koja Vita & Gorica Klodiana, *Bazat e turizmit*, Tiranë, 2004
5. Potera, Ismet, *Mbrojtja e mjedisit jetësor*, Prishtinë, 2008
6. www.google.com
7. www.wikipedia.org

¹⁶⁷ Koja Vita & Gorica Klodiana, *Bazat e turizmit*, Tiranë, 2004